



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 278 Akti

Nr.199 Vendimi

Tiranë, më 11.10.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Alma Faskaj (Vokopola)	Kryesuese
Brunilda Bekteshi	Relatore
Roland Ilia	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin, në datën 7.10.2019, ora 14:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Ndini Tavani**, me detyrë prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuar personalisht.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Paragrafi 5, i nenit 179/ b, dhe paragrafi 1, i nenit Ç, dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Brunilda Bekteshi, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Ndini Tavani, me funksion prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, referuar pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit, *ex officio*, me përparësi nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni), duke qenë kandidat për SPAK.

2. Referuar neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).

3. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin nr. 1, datë 21.03.2019, të trupit gjykues nr. 3, pas studimit të raporteve të vlerësimit të sipërpërmendura, hartuar nga institucionet shtetërore, vendosi: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, për të tria kriteret, bazuar në pikën 1, të nenit 4, të po këtij ligji, përkatësisht: vlerësimin e pasurisë; kontrollin e figurës; dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Me mirëkuptim u caktua kryesuesi i trupit gjykues komisionere Alma Faskaj (Vokopola). Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

4. Në datën 18.4.2019 subjekti i rivlerësimit u njoh me përbërjen e trupit gjykues, për të cilin, po në këtë datë, deklaroi përmes postës elektronike se nuk ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit.

5. Në datën 18.9.2019, Komisioni, me vendimin nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Ndini Tavani, për të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimin e pasurisë; kontrollin e figurës; dhe vlerësimin e aftësive profesionale, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, që të paraqesë pretendimet e tij, brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit me postë elektronike, për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016, nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

6. Në datën 19.9.2019, subjektit iu njoftuan rezultatet e hetimit, dhe po në këtë datë, konfirmoi në rrugë elektronike njohjen me rezultatet e hetimit kryesisht për rivlerësimin e tij.

7. Në datën 27.10.2019, subjekti i rivlerësimit, për arsye objektive të argumentuara, si angazhimi i tij në marrëdhënien e punës, njohja dhe studimi i materialit voluminoz të dërguar nga Komisioni, gjendja psikoemocionale e krijuar në familje si pasojë e rënies së tërmetit në vend, kërkoi në rrugë elektronike shtyrjen e afatit përtej datës 30.10.2019, për depozitimin e prapësimeve dhe dokumentacionit mbështetës. Po në këtë datë trupi gjykues i mbledhur në dhomë këshillimi ka vendosur shtyrjen e afatit të depozitimit të prapësimeve, sipas kërkesës së subjektit të rivlerësimit me pesë ditë, duke e njoftuar njëkohësisht edhe subjektin në mënyrë elektronike.

8. Në datën 1.10.2019, subjekti i rivlerësimit konfirmoi me anë të *e-mail-it*, por edhe në rrugë zyrtare dërgimin e prapësimeve dhe dokumentacionin referues nr. *** prot., datë 1.10.2019.

9. Në datën 3.10.2019, trupi gjykues, me vendimin nr. 3, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Ndini Tavani, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016. Subjekti u njoftua me anë të postës elektronike se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 7.10.2019, ora 11:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

10. Në datën 7.10. 2019, u zhvillua seanca dëgjimore ku subjekti i rivlerësimit ishte prezent.

II. SEANCA DËGJIMORE

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Ndini Tavani, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatini. Gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit, iu përgjigj pyetjeve të drejtuara nga anëtarët e trupit gjykues, shprehu qëndrimin e tij lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni. Në përfundim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, kërkoi konfirmimin në detyrë.

Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Ndini Tavani. Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore të datës 7.10. 2019, për të rifilluar në datën 11.10.2019 për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Z. Ndini Tavani ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas afatit të përcaktuar, sipas nenit 48, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj tij.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu një hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) raportin mbi kontrollin e figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (d) provat shkresore/dokumentet të/e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (e) deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit të bëra me anë të komunikimit elektronik; (f) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, pas njoftimeve të mbylljes së hetimeve administrative, si dhe argumentimeve me gojë në seancë dëgjimore – për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

ILDKPKI-ja ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për dosjen nr. ***, me shkresën nr. *** prot., datë 15.3.2018, në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, si për subjektin e rivlerësimit, ashtu edhe për personin e lidhur për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, sipas neneve 30 – 33, të ligjit nr. 84/2016, ku konstatohet se:

- deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

Nga verifikimi i datës së dorëzimit të deklaratës së pasurisë “Vetting”, në zbatim të nenit 31/1¹, rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Ndini Tavani, e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në datën 28.01.2017 (duke përfshirë personin e lidhur), në bazë të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe ky fakt konfirmohet nga ILDKPKI-ja nëpërmjet vërtetimit të lëshuar. Për sa më sipër, subjekti e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30 ditor nga hyrja e tij në fuqi.

Gjithashtu, në referencë të nenit 32/5², të ligjit nr. 84/2016, dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, vërehet se subjekti i rivlerësimit, z. Ndini Tavani, është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2006, me numër indeksi ***.

A/2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016. Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë konsistoi në: verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; në verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; në evidentimin e ndonjë fshehje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; në evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

Pasuritë e deklaruara në deklaratën “Vetting”, sipas formularit (shtojca 2) të datës 28.1.2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, janë si më poshtë vijon:

1. Për deklarimin në lidhje me pasurinë, apartament banimi, ndodhur në Rr. “****”, p. “****”, kati i II, ap. ***, Q., pranë restorant Fresku, sipas kontratës së premtim-shitje nr. ***, datë 4.12.2015, në vlerën 4 500 000 lekë, paguar deri ditën e paraqitjes së deklaratës, shuma prej 3 000 000 lekë.

Burimi i të ardhurave për shumën e paguar: nga pagat e deklaruesit dhe të bashkëshortes, si dhe të ardhurat nga avokatia para fillimit të detyrës si prokuror. Diferenca e shumës prej 1 500 000 lekësh do të paguhet ditën e nënshkrimit të kontratës përfundimtare të shitjes, sipas

¹ Subjekti i rivlerësimit ka detyrimin të plotësojë deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon atë pranë ILDKPKI-së.

² Deklarimet e interesave privatë dhe pasurore, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja, mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelit.

parashikimit në kontratë. Paguar vlera: 3 000 000 lekë. Pjesa takuese: 100 %. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente³.

1.1 Faktet e konstatuara gjatë hetimit administrativ

1.2 ILDKPKI-ja në Raportin e përcjellë ka konstatuar: deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar, si dhe me përgjigjet e ZVRPP-së Tiranë dhe të DPPPP-së. Për apartamentin nuk është nënshkruar kontrata përfundimtare e shitjes dhe nuk është i regjistruar në ZVRPP-në Tiranë⁴.

1.3 Komisionit gjatë hetimit administrativ i rezultoi se kjo pasuri është deklaruar në deklaratën për vitin 2015 në rubrikën e detyrimeve financiare, me përshkrim *“kontratë premtim-shitje apartamenti, datë 4.12.2015, me subjektin “***” sh.p.k., për të cilën është paguar 1 500 000 lekë në datat 22.12.2015 dhe 28.12.2015, mbetur për t’u paguar shuma 3 000 000 lekë”*.

1.4 Komisionit, në deklaratën për vitin 2015, i rezultoi se për pagesën e këtij kësti nga subjekti ishin deklaruar pakësime të llogarive, të djalit të tij, E. T., në shumën 500 000 lekë, të vajzës K. T. në shumën 450 000 lekë dhe të bashkëshortes së tij në shumën 550 000 lekë, shuma të cilat së bashku kapin vlerën 1 500 000 lekë. Këto shuma janë deklaruar nga subjekti se kanë kaluar në llogarinë e tij për pagesën e apartamentit.

1.4.1 Nga hetimi i lëvizjeve të llogarive bankare u konstatua se dy llogaritë bankare të fëmijëve të subjektit ishin krijuar nga të ardhurat nga paga e subjektit dhe e bashkëshortes së tij.

1.5 Subjekti ka deklaruar se kjo shumë ka kaluar në favor të shoqërisë ndërtimore, palë kontraktore në kontratën premtim-shitje, *“***” sh.p.k.*, nëpërmjet *“Raiffeisen Bank”*. Këto transaksione konfirmohen nga sistemi bankar.

1.6 Komisionit nga korrespondenca e mbajtur me UKT-në⁵ nuk iu konfirmua kontratë furnizimi me ujë, në emër dhe për llogari të subjektit të rivlerësimit apo të bashkëshortes së tij. Komisioni ka pyetur subjektin e rivlerësimit për shkak të pasjes dhe përdorimit të kësaj pasurie dhe për këtë, subjekti ka depozituar librezën përkatëse, si dhe përgjigjen nr. *****prot., datë 10.7.2019, të UKT-së, sipas të cilës kontrata me nr. ***** është e regjistruar në *SMI* në emër të subjektit të rivlerësimit prej vitit 2016 e në vijim.

1.7 Komisionit, edhe nga korrespondenca e mbajtur me OSHEE-në⁶, nuk iu konfirmua kontratë furnizimi me energji elektrike në emër dhe për llogari të subjektit të rivlerësimit apo të bashkëshortes së tij.

Edhe mbi këtë konstatim, subjekti ka depozituar librezën përkatëse, si dhe vërtetimin e OSHEE-së, datë 10.7.2019, sipas të cilit konfirmohej se kontrata është në emër të shoqërisë ndërtimore dhe se shoqëria nuk rezulton debitore pranë këtij institucioni.

1.8 Subjekti, në deklaratën për vitin 2016, ka deklaruar se ka paguar këstin e dytë në shumën 1 500 000 lekë, sipas kontratës premtim-shitje nr. *****, datë 4.12.2005, me burim krijimi nga

³ Kontratë premtim-shitje nr. *****, datë 4.12.2015; njoftim debitimi në *“Raiffeisen Bank”*, transfertë të shumës 500 000 lekë, datë 22.12.2015, dhe të shumës 1 000 000 lekë, datë 28.12.2015. Njoftim debitimi në *“Raiffeisen Bank”*, të shumës prej 500 000 lekë, datë 28.12.2015; njoftim debitimi në *“Raiffeisen Bank”*, të shumës 450 000 lekë, datë 28.12.2015; mandatdepozitimi pranë *“Raiffeisen Bank”* të shumës 500 000 lekë, datë 27.10.2016; urdhërshirim në *“Credins Bank”*, datë 22.12.2016; mandatdepozitimi të shumës 900 000 lekë, datë 27.12.2016; mandattransferimi të shumës 1 000 000 lekë, datë 27.12.2016; mandatdepozitimi të shumës 450 000 lekë, datë 29.12.2016; nxjerrje e llogarisë nr. *****, në emër të z. Ndini Tavani pranë *“Raiffeisen Bank”* (aneks nr. 4/1, në dosjen e ILDKPKI-së).

⁴ Referojuni aneksit nr. 27, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁵ Referojuni shkrësës nr. ***** prot., datë 28.5.2019, në dosjen e Komisionit.

⁶ Referojuni shkrësës nr. ***** prot., datë 7.5.2019, në dosjen e Komisionit.

kursimet në vite dhe paga e bashkëshortes. Këto transaksione konfirmohen nga sistemi bankar (shihni më poshtë në mënyrë të detajuar/pika 1.10).

1.9 Nga verifikimi i kontratës premtim-shitje nr***, datë 4.12.2015, me vlerë të cilësuar 4 500 000 lekë, Komisioni vërejti se mënyra e pagesës për këtë pasuri ishte parashikuar, si më poshtë:

- shuma prej 1 500 000 lekësh do të likuidohej 10 ditë pas nënshkrimit të kontratës;
- kësti i dytë prej 1 500 000 lekësh do të likuidohej brenda 90 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës;
- diferenca prej 1 500 000 lekësh do të paguhej në momentin e nënshkrimit të kontratës.

1.10 Në tërësi, Komisionit i rezultoi se për këtë kontratë subjekti ka shlyer 3 000 000 lekë sipas mandateve si më poshtë vijon:

- në datën 22.12.2015 ka paguar shumën 500 000 lekë, me transfertë bankare nga llogaria e tij në “Raiffeisen Bank” për llogari të firmës ndërtuese “****” sh.p.k.;
- në datën 28.12.2015 ka paguar shumën 1 000 000 lekë, me transfertë bankare nga llogaria e tij në “Raiffeisen Bank” për llogari të firmës ndërtuese “****” sh.p.k.;
- në datën 27.10.2016 është likuiduar shuma 500 000 lekë, depozitim *cash* për llogari të firmës ndërtuese “****” sh.p.k.;
- në datën 27.12.2016 ka paguar shumën 1 000 000 lekë me transfertë bankare nga llogaria e tij në “Credins Bank” për llogari të firmës ndërtuese “****” sh.p.k.

1.11 Subjekti për këtë pasuri deklaroi si burim të ardhurat nga paga e tij dhe e bashkëshortes, si dhe të ardhurat nga avokatia përpara fillimit të detyrës.

1.12 Komisioni kreu analizën financiare për vitet 2015-2016, sipas deklarimit të subjektit kur është kryer investimi për këtë pasuri të paluajtshme për të parë mundësinë financiare.

1.12.1 Nga analiza financiare ka rezultuar se subjekti ka pasur mundësi financiare për të shlyer dy këstet e blerjes së kësaj pasuri.

1.12.2 Në vijim, Komisioni hetoi në lidhje me burimin e ligjshëm të “*të ardhurave të përfituara nga ushtrimi i profesionit të avokatit në shumën 2 500 000 lekë*”, si një ndër burimet e deklaruar të përdorura për blerjen e kësaj pasurie, shumë të cilën subjekti e ka deklaruar si gjendje *cash* në deklaratën para fillimit të detyrës.

1.13 Komisioni konstatoi se në dokumentacionin e dosjes së ILDKPKI-së ishte administruar formulari “*tabela e llogaritjes për taksën vendore mbi biznesin e vogël dhe tatimit të thjeshtuar mbi fitimin*” për vitet 2003 dhe 2004. Në këtë formular qarkullimi i deklaruar nga subjekti ishte në vlerën 375 000 lekë për vitin 2003 dhe në vlerën 1 200 000 lekë për vitin 2004. Si rrjedhim, qarkullimi total për vitet 2003-2004 përllogaritej në shumën 1 575 000 lekë.

1.14 Komisioni, pas këtij konstatimi, ka pyetur⁷ subjektin në lidhje me burimin e ligjshëm të shumës 2 500 000 lekë, për të cilën ai ka deklaruar se qarkullimi për vitet 2003 dhe 2004 deklaruar në formularin “*tabela e llogaritjes për taksën vendore mbi biznesin e vogël dhe tatimit të thjeshtuar mbi fitimin*” i vishet qarkullimit 2 000 000 lekë, pra, shumat përkatëse të deklaruar janë mbi qarkullimin 2 000 000 lekë.

1.14.1 Subjekti ka depozituar dokumentacionin⁸ justifikues sipas të cilit provohej se kishte paguar tatim dhe taksa sipas deklarimit të qarkullimit të bërë në formularin “*tabela e llogaritjes*

⁷ Referojuni pyetësorit nr. 4, datë 24.6.2019, në dosjen e Komisionit.

⁸ Dokumentacioni i depozituar në pyetësorin nr. 4, datë 24.6.2019.

për taksën vendore mbi biznesin e vogël dhe tatimit të thjeshtuar mbi fitimin” për vitet 2003 dhe 2004.

1.15 Komisioni e shtriu hetimin administrativ duke mbajtur korrespondencë me Drejtorinë Rajonale Tatimore Berat⁹, e cila në informacionin e saj konfirmonte se qarkullimi për vitin 2003 është në shumën 2 375 000 lekë dhe për vitin 2004 në shumën 3 200 000 lekë. Sikurse deklaroi subjekti edhe kjo drejtori mban të njëjtën linjë qëndrimi se shumat e deklaruara janë mbi fashën 2 000 000 lekë, por shton se për këtë qarkullim faktik të deklaruar dhe të depozituar nuk disponon dokumentacion.

1.16 Komisioni, në të tilla kushte, në analizë të:

- qarkullimit të deklaruar në formularë nga vetë subjekti, për vitin 2003 në shumën 375 000 lekë dhe për vitin 2004 në shumën 1 200 000 lekë;
 - detyrimeve tatimore të paguara mbi këto shuma, sipas përlllogaritjeve të kryera nga zyra e tatim taksave për qarkullimin e deklaruar në formularë për vitin 2003-2004, sipas legjislacionit të kohës;
 - përgjigjes së dhënë nga subjekti se qarkullimi i deklaruar është mbi fashën 2 000 000 lekë;
 - mungesës së dokumentacionit provues për këtë qarkullim dhe për pagesat e tatimeve për shumat totale të deklaruara dhe të pretenduara se i vishen fashës mbi 2 000 000 lekë;
 - informacionit të dhënë nga DRT-ja Berat; si dhe
 - konfirmimit të kësaj të fundit për mungesë dokumentacioni, lidhur me provueshmërinë e deklarimeve, për një hetim sa më objektiv,
- i kërkoi interpretim Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve¹⁰, duke i vënë në dispozicion formularët e plotësuar nga subjekti për vitet 2003-2004.

1.16.1 Me shkresën nr. ***prot., datë 6.8.2019, DPT-ja ka konfirmuar se qarkullimi i deklaruar në formular është qarkullimi total i subjektit dhe jo një diferencë mbi fashën e arritur.

1.16.2 Pas këtij konfirmimi zyrtar nga DPT-ja, në analizën e kryer nga Komisioni për fitimin e realizuar nga ky profesion është marrë në konsideratë vetëm qarkullimi i deklaruar në formular, përkatësisht shuma 375 000 lekë për vitin 2003 dhe shuma 1 200 000 lekë për vitin 2004.

1.17 Komisioni, nisur nga eksperiencia me subjekte të tjera¹¹, i ndodhur para faktit të mungesës së fitimit për ushtrimin e profesionit të avokatit, ka aplikuar një *marzhë* fitimi 80 %, pasi nga qarkullimi duhet të zbriten tatimet dhe taksat e paguara, detyrimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, si dhe shpenzimet për ushtrimin e aktivitetit si, qira, shërbimet utilitare dhe shpenzime të tjera të nevojshme.

Tabela nr. 1

Viti	Qarkullim	Fitimi i mundshëm 80 %
2003	375 000	300 000
2004	1 200 000	960 000
Total	1 575 000	1 260 000

⁹ Shkresë, nr. ***prot., datë 8.7.2019 dhe nr. *** prot., datë 18.7.2019, nga DRT-ja Berat.

¹⁰ Shkresë nr. ***prot., datë 31.7.2019, e Komisionit.

¹¹ Referuar vendimit nr***datë 21.3.2019, të Komisionit.

1.18 Gjithashtu, sipas dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit, rezulton se ka përfituar të ardhura nga ushtrimi i profesionit:

- si avokat pranë Dhomës së Avokatisë Berat nga pjesëmarrja në gjykimet penale në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat; si dhe
- shërbime avokatie në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat.

Tabela nr. 2

Viti	Gjykata Berat	Prokuroria Berat	Total
2003	67 000	10 000	77 000
2004	158 000	39 000	197 000
Total	225 000	49 000	274 000

1.19 Nën arsyetimin sa më sipër, nga përlllogaritjet, duke aplikuar *marzhën* e fitimit prej 80 %, fitimi neto për vitet 2003 dhe 2004 rezultoi në shumën 1 260 000 lekë. Të ardhurat nga gjykata dhe prokuroria Berat rezultuan në shumën 274 000 lekë dhe në total të ardhurat nga ushtrimi i profesionit të avokatit për vitet 2003-2004 rezultuan në shumën 1 534 000 lekë.

1.20 Komisioni, duke marrë në konsideratë faktin se subjekti përdor si burim për blerjen e kësaj pasurie të ardhurat që ka pasur *cash* nga ushtrimi i profesionit të avokatit, që nga analiza e mësipërme rezultuan në shumën 1 534 000 lekë, si dhe gjendjen *cash* të deklaruar ndër vite, kreu analizën financiare mbi mundësinë e blerjes së kësaj pasurie, treguesit e të cilës pasqyrohen në tabelën më poshtë.

Tabela nr. 3

Viti	Përshkrimi	Vlera	Gjendja në fund të vitit, akumulative
1.11.2006	Gjendje <i>cash</i> në banesë, të padepozituara, të ardhura nga paga si avokat 2003 – 2004	1 534 000	1 534 000
2006	Gjendje <i>cash</i> e krijuar nga paga + shpërblimet	90 000	1 624 000
2007	Nuk deklaroi <i>cash</i>	-	1 624 000
2008	Nuk deklaroi <i>cash</i>	-	1 624 000
2009	Nuk deklaroi <i>cash</i>	-	1 624 000
2010	Nuk deklaroi <i>cash</i>	-	1 624 000
2011	Shtim i gjendjes <i>cash</i> me vlerën e depozitës së mbyllur në “Raiffeisen Bank”	753 735	2 377 735
2012	Gjendje <i>cash</i> nga të ardhurat nga paga e deklaruesit dhe bashkëshortes	600 000	2 977 735
2013	Nuk deklaroi <i>cash</i>	-	2 977 735
2014	Pakësim i gjendjes <i>cash</i> , udhëtim me bashkëshorten më 9.5.2014 – 12.5.2014	150 000	2 827 735
2015	Pakësim i gjendjes <i>cash</i> për mobilim banese	1 412 950	1 414 785

2016	Pakësim i gjendjes <i>cash</i> të përdorura për pagesën e këstit të dytë të banesës, blerjen e makinës dhe udhëtim jashtë vendit, Itali, Mal i Zi	2 088 175	- 673 390
-------------	---	-----------	------------------

1.21 Komisioni, nga analizimi i fakteve dhe rrethanave të përshkruara më sipër për hetimin e kësaj pasurie, si dhe pas kryerjes së përlllogaritjeve financiare, pasqyruar në tabelat nr. 1, 2 dhe 3 më lart, konstatoi dhe për rrjedhojë i kaloi subjektit barrën¹² e provës, pasi:

- i. dukej se kishte mungesë të dokumentacionit justifikues ligjor lidhur me krijimin e shumës prej 2 500 000 lekësh e deklaruar nga subjekti në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës, si të ardhura të krijuara nga avokatia, pasi këto të ardhura rezultuan në shumën 1 534 000 lekë;
- ii. rezultoi se në vitin 2016 subjekti nuk kishte pasur mundësi të paguante këstin e dytë për blerjen e apartamentit; blerjen e makinës; të shpenzonte për pushime në shumën 673 390 lekë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

1.22 Në tërësi në parashtrimet e tij subjekti ka kundërshtuar konstatimet e Komisionit. Më konkretisht subjekti është shprehur se:

- i. *Në lidhje me burimin e ligjshëm për mundësinë e blerjes së këtij apartamenti në deklaratën “Vetting” kam deklaruar si burim “të ardhura nga paga ime dhe e bashkëshortes, si dhe të ardhura nga avokatia përpara fillimit të detyrës”.*
- ii. *Dyshimi i ngritur, për të cilin më është ngarkuar barrë prove në pamundësinë për të justifikuar me të ardhura të ligjshme një diferencë në vlerën 1 534 000 lekë është i gabuar. Kjo për faktin e thjeshtë se i jeni referuar deklaratës përpara fillimit të detyrës në vitin 2006, kur në fakt Kushtetuta dhe ligji imponon referimin në deklaratën “Vetting”.*
- iii. *Po në deklaratën “Vetting” në rubrikën: “angazhime në veprimtari private dhe/ose publike dhe të ardhurat e krijuara prej tyre” (faqe 6 e deklaratës “Vetting”) kam reflektuar me saktësi dhe deklaruar si “të ardhura nga avokatia për periudhën 2003 –2 004 shumën 1 839 000 lekë”. Pra, kjo përbën dhe shumën e burimit që duhet analizuar për qëllime të procesit të rivlerësimit. Analiza duhet të fillojë gjithnjë nga deklaratimet që subjektet e rivlerësimit kanë bërë në deklaratën “Vetting” sipas kërkesës së vet Kushtetutës. Nuk mund të anashkalohet ky deklaram duke ju referuar vetëm atij të reflektuar në deklaratën e bërë përpara ushtrimit të detyrës.*
- iv. *E ardhura e deklaruar në deklaratën “Vetting” nuk gjen pasqyrim në raportin e rezultateve të hetimit administrativ të Komisionit.*
- v. *Ky deklaram është bërë në kuptim të procesit të rivlerësimit, pra, në kuptim të konceptit të ‘burimit të ligjshëm’ si kërkesë detyruese e vet procesit dhe në harmoni me udhëzimet e dhëna nga ILDKPKI-ja për këtë çështje, koncept ky që nuk ka ekzistuar më përpara, në deklaratën përpara fillimit të detyrës dorëzuar nga unë në nëntor 2006. Në detyrë jam emëruar në tetor 2006.*

¹² Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016 dhe në paragrafët 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, refero rezultatet për specifikimet në detaje.

vi. Nëse shkojmë në vitin 2016 dhe gjurmë të lëvizjet në llogarinë bankare konstatohet kreditimi i saj me shumën 1 850 000 lekë, shumë kjo e cila së bashku edhe me shumën 550 000 lekë nga llogaria e bashkëshortes sime nga të ardhurat e pagës, ka shërbyer për ekzekutimin e pagesës së këstit të dytë të apartamentit dhe të blerjes së makinës po në të njëjtin vit, pra, në vitin 2016.

1.23 Subjekti në lidhje me pretendimet e tij është shprehur dhe ka analizuar:

- të ardhura, në shumën 1.839.000 lekë, nga avokatia (ka një gabim material pasi kjo shumë e deklaruar nga ana ime konsiston në 375 000 lekë (viti 2003) + 1 200 000 lekë (viti 2004) + 225 000 lekë (gjkata e Beratit) + 49 000 lekë (prokuroria Berat) është e barabarte me totalin 1 849 000 lekë);
- të ardhura, në shumën 897 315 lekë, nga Shkolla e Magjistraturës.

Në kuptim të sa më sipër në referim të dokumentacionit të disponuar nga ana ime për periudhën që kam ushtruar profesionin e avokatit, formularëve të pagesave, urdhërpagesave dhe mandatpagesave, kam deklaruar si të ardhura të cilat i janë nënshtruar tatimeve përkatësisht:

- shumën 375 000 lekë, si e ardhur për vitin 2003, për të cilën janë paguar tatimet;
- shumën 1 200 000 lekë, si e ardhur për vitin 2004, për të cilën janë paguar tatimet;
- shumën prej 225 000 lekësh, si e ardhur për vitet 2003– 2004, si avokat kryesisht i caktuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, për të cilat janë paguar tatimet (tatimi mbi burim mbahet nga vete institucioni gjykata); si dhe
- shumën prej 49 000 lekësh, si e ardhur për vitet 2003 – 2004, si avokat kryesisht nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Berat, për të cilat janë paguar tatimet (tatimi mbi burim mbahet nga vete institucioni prokuroria).

Në total kam deklaruar shumën 1 839 000 lekë (duhet të kisha deklaruar shumën 1 849 000 lekë), si të ardhura të realizuara nga avokatia për vitet 2003 – 2004, të ardhura për të cilat janë paguar tatimet në referim të fjalisë 2, të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (e ardhur e ligjshme është e ardhura për të cilat janë paguar tatimet). Si të ardhura nga Shkolla e Magjistraturës, si rezulton dhe nga dokumentacioni i paraqitur kam realizuar të ardhura të ligjshme në shumën 897 315 lekë.

1.24 Subjekti ka depozituar së bashku me parashtrimet e tij edhe analizën ekonomike-ligjore, nga ku në përfundim i ka rezultuar se ka pasur mundësi të krijojë shumat e të ardhurave të ligjshme të deklaruara në deklaratën “Vetting”.

1.25 Ndërsa në lidhje me deklarimin e të ardhurave nga avokatia në shumën 2 500 000 lekë, para fillimit të detyrës, në vitin 2006, subjekti ndër të tjera ka parashtruar se për këtë shumë ka sqaruar dhe ka pranuar se në këtë deklaratë ka pasur në vëmendje të gjitha të ardhurat e realizuara dhe të akumuluar deri në këtë moment, pra, duke filluar nga momenti i parë që ka punuar dhe është paguar dhe deri në ditën e deklarimit, viti 2006. Kjo shumë, ka deklaruar subjekti, përbëhet nga të ardhurat e realizuara si, asistent avokat, avokat dhe nga Shkolla e Magjistraturës, përkatësisht për periudhën 2002 – 2006, konkretisht, në vlerën reale dhe faktike prej 2 500 000 lekësh, si të ardhura të realizuara nga aktiviteti si avokat (ku përfshihen edhe të ardhurat e realizuara si asistent avokat)¹³ dhe shumën prej 900 000 lekë të ardhura nga Shkolla e Magjistraturës (me një gabim material në vlerë të vogël). Këto të ardhura në total janë në

¹³ Për të cilat nuk disponoj dokumentacion të plotë justifikues ligjor në kuptim të ligjit “Vetting”, por që kanë qenë të ardhura reale të përfituara nga puna si asistent dhe në deklaratën fillestare është deklaruar me vërtetësi shuma totale e të ardhurave nga aktiviteti i avokatisë për vitet 2002 – 2004.

shumën 3 400 000 lekë. Nga kjo shumë totale të ardhurash faktike për vitet 2002-2006 është kursyer shuma 2 500 000 lekë, pasqyruar si pasuri në deklaratën para fillimit të detyrës.

1.26 Subjekti, për të provuar të ardhurat si asistent avokat ka depozituar: vendime gjyqësore ku rezulton si përfaqësues ligjor; deklaratën noteriale nr. ***, datë 14.4.2019, të shtetasit Sh. S., avokat i Dhomës së Avokatisë Berat ku ka kryer punën si asistent avokat dhe ka qëndruar përgjatë gjithë periudhës në ambientet e zyrës së avokatisë (2002 – 2004), pa paguar asnjë detyrim qiraje apo detyrime të tjera; vërtetimin e Dhomës Kombëtare të Avokatisë Tiranë, datë 3.2.2019, që vërteton faktin se subjekti ka qenë asistent avokat pranë avokatit Sh. S., për vitin 2002; vërtetimin e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Berat, datë 21.02.2019, sipas të cilit avokati Sh. S. ka paguar detyrimet për vitin 2002 në organet tatimore.

1.27 Subjekti, në parashtrimet e tij, ka kërkuar që në kushtet kur rezulton e provuar se përgjatë vitit 2002 ka punuar si asistent avokat, Komisioni të këtë një qasje më elastike për këtë situatë në analizën financiare të tij për mundësinë e krijimit të likuiditeteve *cash* në shumën 2 500 000 lekë në tetor të vitit 2006 (deklarata para fillimit të detyrës), ku minimalisht duhet të vlerësohet se të ardhurat e përfituara nga aktiviteti si asistent avokat kanë mbuluar plotësisht të gjitha shpenzimet jetike për periudhën përkatëse (2002 – 2006 para fillimit të detyrës).

1.28 Në këtë kuptim, si dhe të marrjes në konsideratë të faktit se në vitin 2006, deklarata para fillimit të detyrës ishte deklaratë e plotësuar për herë të parë, duhet marrë në konsideratë çdo pasaktësi e mundshme në plotësimin e saj.

1.29 Subjekti sqaron se rezulton e qartë nëse krahasohet nga Komisioni pjesa e deklaruar e gjendjes *cash* në fletën 3 të deklaratës para fillimit të detyrës të vitit 2006 e lexuar dhe interpretuar lidhur ngushtë me faqen 4 të kësaj deklarate, pikërisht në këtë faqe të kësaj deklarate është bërë përshkrimi i të ardhurave para fillimit të detyrës, përkatësisht në vlerën 2.500.000 lekë nga avokatia (këtu përfshirë dhe të ardhurat si asistent avokat) dhe vlera 900 000 lekë (897 315 lekë) nga Shkolla e Magjistraturës. Pra, pavarësisht të ardhurave më të larta të krijuara nga avokatia, si asistent avokat dhe nga Shkolla e Magjistraturës, pasi në deklaratën para fillimit të detyrës ka deklaruar për të ardhurat në vlerën 2 500 000 lekë dhe 900 000 lekë, si gjendje *cash* të krijuar nga të tri burimet e ligjshme të cituara më sipër shumën 2 500 000 lekë, referenca (e ardhur nga avokatia në shumën 2 500 000 lekë), në faqen 4 të deklaratës para fillimit të detyrës, i përket të ardhurave nga avokatia dhe si asistent avokat. Në këtë kuptim duket qartë pasaktësia në deklarimin e shumës *cash* të vlerës 2 500 000 lekë vetëm nga avokatia, pasi e njëjta vlerë është e vendosur nga subjekti edhe si e ardhur në të njëjtën deklaratë. Komisioni (ka parashtruar subjekti) duhet të mbajë në konsideratë se deklarimi për shumën 2 500 000 lekë gjendje *cash*, para fillimit të detyrës, i përgjigjet gjendjes reale dhe faktike të likuiditeteve *cash* të cilat subjekti i ka disponuar në atë moment.

1.30 Subjekti ndër të tjera ka prezantuar analizë ligjore-ekonomike të të ardhurave të përfituara nga aktiviteti i avokatisë për të cilat pretendon se të ardhurat neto të realizuara nga aktiviteti i avokatisë janë në total në vlerën 1 394 675 lekë.

1.31 Në analizë të fundit të ardhurat totale të realizuara, për të cilat disponohet dokumentacion i plotë justifikues ligjor, për periudhën deri në tetor të vitit 2006, janë:

- në shumën 1 394 675 lekë, të ardhura nga aktiviteti i avokatisë (i regjistruar);
- në shumën 274 000 lekë, të ardhura si avokat kryesisht (gjykatë/prokurori);
- në shumën 897 315 lekë, të ardhura nga Shkolla e Magjistraturës.

Totali i të ardhurave neto në shumën 2 565 990 lekë¹⁴.

1.32 Të ardhurat neto në shumën 2 565 990 lekë dhe të ardhurat nga puna si asistent avokat kanë shërbyer për krijimin e shumës 2 500 000 lekë, deklaruar si gjendje *cash* në deklaratën fillestare të vitit 2006.

Vlerësimi i Komisionit

1.33 Trupi gjykues, nga analiza e parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit, ka konstatuar se subjekti ka kundërshtuar arsyetimin e Komisionit të bërë për gjendjen *cash* deklaruar në shumën 2 500 000 lekë në deklaratën përpara fillimit të detyrës për vitin 2006, ndërsa ka pretenduar se analiza për qëllim të procesit të rivlerësimit duhej bërë për deklarimin “*të ardhura nga avokatia për periudhën 2003 – 2004, në shumën 1 839 000 lekë*”, bërë me saktësi në rubrikën përkatëse në deklaratën “Vetting”.

1.34 Trupi gjykues ka konstatuar se subjekti e ka shtruar këtë pretendim vetëm pasi është njohur me rezultatet e hetimit.

1.35 Trupi gjykues nisur nga faktet se burimi i pasurisë së deklaruar në deklaratën “Vetting”,¹⁵ “*të ardhura nga avokatia*” derivonte dhe ndërthurej me vite të mëparshme kalendarike, në pikënisje që me deklarimin e tij në deklaratën periodike për vitin 2006, ka verifikuar deklaratën periodike, për faktin se kontrolli i deklaratës së pasurisë për procesin e rivlerësimit dhe krahasimi i saj me deklaratimet e mëparshme, i shërbeu Komisionit për të ndjekur ecurinë dhe vërtetësinë e deklarimeve të subjektit, në lidhje me pasurinë e deklaruar dhe për të nxjerrë konkluzionet mbi ligjshmërinë e pasurisë së subjektit apo mjaftueshmërinë e deklarimeve të tij. Po në këtë drejtim trupi gjykues ka vlerësuar se procesi i rivlerësimit kryhet nga Komisioni pas një procesi hetimi të bazuar në prova, të cilat sipas pikës 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, mund të jenë edhe deklaratimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitur më parë tek ILDKPKI-ja.

1.36 Duke qëndruar në arsyetimin e burimit të krijimit të kësaj pasurie të deklaruar në deklaratën “Vetting” “*të ardhura nga avokatia*”, të ardhura të deklaruara si gjendje *cash* në shumën 2 500 000 lekë në deklaratën përpara fillimit të detyrës, trupi gjykues, në konsideratë të fakteve se:

- i. subjekti ka deklaruar ekzaktësisht gjendje, “*lekë cash në banesë, të padepozituara, të ardhura nga paga si avokat 2003 – 2004*”, në shumën 2 500 000 lekë;
- ii. kjo shumë është pasqyruar në kohë reale në vitin përkatës (2006);
- iii. kjo gjendje ishte deklaruar edhe në faqen nr. 4 të deklaratës periodike të vitit 2006 si e ardhur po në të njëjtën shumë;
- iv. kjo shumë sikurse është deklaruar disponohej në atë kohë, në mënyrë krejtësisht të vullnetshme pa u ndikuar nga asnjë rrethanë, por me vërtetësi dhe saktësi;
- v. kjo shumë është mbajtur e qëndrueshme dhe e pandryshuar ndër vite, siç dhe pasqyrohet më tepër në tabelën nr. 3, madje është synuar që sa herë ajo të jetë prekur të plotësohet, siç edhe ka ndodhur në vitin 2009 kur vetë subjekti ka deklaruar në deklaratimet e tij në pyetësor¹⁶, se kredinë e përfituar në këtë vit e ka përdorur për të plotësuar gjendjen *cash* që kishte prekur me qëllim blerjen e pasurisë automjet në këtë vit;

¹⁴ Këto të ardhura janë deklaruar saktësisht në deklaratën “Vetting”.

¹⁵ Vendimet, nr. 13, datë 20.6.2019, nr. 6, datë 28.2.2019, nr. 9, datë 18.4.2019, nr. 5, datë 18.2.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

¹⁶ Pyetësorit nr. 2, datë 19.4.2019, në dosjen e Komisionit.

- vi. Komisioni, për qarkullimin e këtyre të ardhurave, administronte dy formularë “*tabela e llogaritjes për taksën vendore mbi biznesin e vogël dhe tatimit të thjeshtuar mbi fitimin*” të cilat lehtësisht dukeshin se nuk përkonin me këtë shumë, por me shumën e qarkullimit të deklaruar 1 575 000 lekë, përkatësisht në shumën 375 000 lekë për vitin 2003, dhe në shumën 1 200 000 lekë, për vitin 2004.
- vii. mungonte dokumentacion tjetër ligjor për të provuar shumën e deklaruar prej 2 500 000 lekësh,

konstatoi se në ndryshim nga qarkullimi i deklaruar nga subjekti në formularët tatimorë për vitet 2003-2004, në pyetësor deklaroi se shumata, në të vërtetë nuk ishin ato, por i visheshin shumës 2 000 000 lekë, çka nënkuptonte se qarkullimi total sipas këtij deklarimi nuk ishte në shumën 1 575 000 lekë, por në shumën 5 575 000 lekë.

1.37 Trupi gjykues i ndodhur përpara këtij fakti të deklaruar, por që dukshëm bënte një diferencë jo vetëm në vlerat e deklaruara, por edhe në mënyrën se si ato duheshin perceptuar, vlerësoi të kërkojë informacion zyrtar nga institucioni përkatës i fushës tatimore, si zbatuesi i legjislacionit që mbulon këtë sektor.

1.38 Në këto kushte, Komisioni mbajti korrespondencë me Drejtorinë Rajonale Tatimore Berat të cilës i vuri në dispozicion edhe dy formularët tatimorë të plotësuar nga subjekti për vitet 2003 dhe 2004, nga ku u informua se qëndrimi i mbajtur nga kjo drejtori ishte në koherencë me deklarin e subjektit se shumata e qarkullimit të deklaruara si të ardhura nga ushtrimi i profesionit të avokatit për vitet 2003 dhe 2004 përlllogaritëshin mbi vlerën 2 000 000 lekë.

1.39 Por fakti që ky organ pohonte se nuk administronte dokumentacionin përkatës, bëri që Komisioni t’i drejtohej Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të cilës, gjithashtu, i vuri në dispozicion dy formularët tatimorë të plotësuar nga subjekti për vitet 2003 dhe 2004, për të pasur opinionin e saj të plotë nëse vërtet mund të ndodhte që një shumë e deklaruar në formularët tatimorë të deklarohej mbi një tjetër vlerë të nënkuptuar (2 000 000 lekë).

1.40 Në ndryshim nga Drejtoria Rajonale Tatimore Berat, organi më i lartë i kësaj të fundit, në informacionin e dhënë përjashton çdo lloj mundësie që një deklarim i bërë në formularët tatimorë mbi qarkullimin e realizuar nga ushtrimi i një aktiviteti të mund të jetë një vlerë e cila i vishet (e nënkuptuar) shumës 2 000 000 lekë, duke konfirmuar kështu se shumata e qarkullimit të deklaruar është ajo e shkruar në formularë.

1.41 Pas këtyre korrespondencave ndërinstucionale, lehtësisht u vërejt mosrakordim në mënyrën e deklarimit të subjektit të rivlerësimit mbi qarkullimin e realizuar me informacionin e dhënë nga organi zyrtar.

1.42 Në vijim, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit pas njohjes me rezultatet e hetimit dhe me informacionet e dhëna nga institucionet zyrtare, ka ndryshuar qëndrimin e tij dhe ka pranuar se qarkullimi është ai i deklaruar në formular (1 575 000 lekë), veprim i cili pa dyshim ka vendosur subjektin në pozitë të drejtë dhe në koherencë me deklarin e bërë në formularët tatimorë, por nga ana tjetër ka imponuar subjektin të qartësojë në vijim burimin e krijimit të gjendjes *cash* të deklaruar në vitin 2006 në shumën 2 500 000 lekë.

1.43 Më konkretisht, në qoftë se subjekti gjatë hetimit administrativ pranonte se qarkullimi në shumën 5 575 000 lekë ishte i mjaftueshëm për të krijuar gjendjen *cash* prej 2 500 000 lekësh, pas ndryshimit të qëndrimit, këtë shumë përpiqet ta provojë më të ardhurat nga Shkolla e Magjistraturës, si dhe nga ushtrimi i profesionit të asistent avokat.

1.44 Trupi gjykues çmon se pretendimi i subjektit lidhur me vërtetësinë dhe saktësinë e burimit të ligjshëm të krijimit të gjendjes *cash*, nis dhe duhet të vlerësohet sipas deklarimit të bërë në deklaratën “Vetting”, nuk qëndron edhe për shkak të kontradiktoritetit të subjektit në këto deklarime:

- i. Subjekti në deklaratën “Vetting” në rubrikën e të ardhurave deklaron të ardhura në shumën 897 315 lekë nga Shkolla e Magjistraturës dhe të ardhura në shumën 1 839 000 lekë nga avokatia. Pra, në total deklaron të ardhura në shumën 2 736 315 lekë.
- ii. Subjekti në deklaratën para fillimit të detyrës për vitin 2006 në rubrikën e të ardhurave kishte deklaruar të ardhura në shumën 900 000 lekë nga Shkolla e Magjistraturës dhe të ardhura në shumën 2 500 000 lekë nga avokatia. Pra, në total deklaronte të ardhura në shumën 3 400 000 lekë.
- iii. Subjekti pretendon se shuma e deklaruar e të ardhurave nga avokatia në vitin 2006 ka pasur të përfshirë edhe të ardhurat e ushtrimit të profesionit si asistent avokat.

1.45 Trupi gjykues konstaton se subjekti në të njëjtën rubrikë (të ardhurat), të vitit 2006 dhe në deklaratën “Vetting” ka deklaruar dy vlera të ndryshme me të njëjtin burim, përkatësisht në vitin 2006 shumën 2 500 000 lekë dhe në deklaratën “Vetting” shumën 1 839 000 lekë. Trupi gjykues konstaton se edhe në deklaratën “Vetting” subjekti nuk ka saktësuar vërtetësinë e diferencës të padeklaruar nga shuma 2 500 000 lekë në 1 839 000 lekë.

1.46 Trupi gjykues konstaton se subjekti në ndryshim nga mënyra se si deklaron në deklaratën periodike dhe në deklaratën “Vetting”, kërkon që Komisioni t’i marrë të mirëqena të ardhurat e ushtrimit të profesionit si asistent avokat, megjithëse ai nuk i ka deklaruar ato në deklaratën “Vetting”, thënë ndryshe e ka shmangur deklarimin e tyre, pra, diferencën e arsyetuar më sipër, për faktin se në çdo rast mundësia për të provuar burimin e ligjshëm të tyre duket të jetë e pakët, madje e pamundur.

1.47 Trupi gjykues, në lidhje me të ardhurat e pretenduara nga ushtrimi i profesionit si asistent avokat nuk konteston faktin e përfaqësimit të subjektit në procese të ndryshme gjyqësore, penale dhe civile, apo faktin që ai ka punuar pranë një avokati të licencuar, ka përpiluar kërkesëpadi, ankime, rekurse etj., por bazuar në kërkesat e ligjit nr. 84/2016, si dhe të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, se ligjshmëria e çdo të ardhure të përfituar bazohet në derdhjen e detyrimeve tatimore, konkludon se subjekti nuk provoi me dokumentacion ligjor shumën e përfituar nga ushtrimi i këtij profesioni dhe për pasojë nuk provoi burimin e ligjshëm të tyre. Në të tilla kushte pretendimi i subjektit që Komisioni të jetë më elastik në njohjen e këtyre të ardhurave dhe t’i neutralizojë ato me shpenzimet e jetesës, për sa kohë ato nuk ekzistojnë, nuk mbështetet në asnjë bazë ligjore dhe për pasojë nuk mund të merren në konsideratë.

1.48 Gjithashtu, mbi dokumentacionin e depozituar nga subjekti për të provuar burimin e ligjshëm të ushtrimit të profesionit si asistent avokat, të tilla si, deklarata noteriale nr. ***, datë 14.4.2019, dhënë nga shtetasi Sh. S., avokat i Dhomës së Avokatisë Berat; vërtetimi i Dhomës Kombëtare të Avokatisë Tiranë, datë 3.2.2019; vërtetimi i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Berat, datë 21.2.2019 – Komisioni konstaton nga analiza e dokumentacionit për të provuar ligjshmërinë e të ardhurave, është i pamjaftueshëm dhe jo në përputhje me kërkesat ligjore të parashikuara në nenin D të Kushtetutës.

1.49 Nga ana tjetër, përveç sa sipër arsyetuar por edhe fakti që subjekti ndryshoi qëndrim në deklaratimet e tij pas njohjes me rezultatet e hetimit, bën të pabesueshëm nivelin e

provueshmërisë së shumës 2 500 000 lekë, gjendje *cash*, me burim krijimi të ardhurat nga Shkolla e Magjistraturës dhe nga avokatia.

1.50 Trupi gjykues, në analizë të fakteve dhe rrethanave sa më sipër arsyetuar, në raport me prapësimet e subjektit në rezultatet e hetimit administrativ, mban në vëmendje përmbushjen në mënyre kumulative të elementeve ligjor në kuptim të ligjit nr. 84/2016: (a) vërtetësinë e deklarimeve; (b) burimin e ligjshëm të mbështetur në dokumentacion provues, për të cilat pas përlllogaritjeve financiare të pasqyruara në tabelën nr. 3, subjekti rezultoi në pamjaftueshmëri financiare të burimit të ligjshëm për këtë pasuri dhe për këtë shkak, çmon se:

- i. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin të pamjaftueshëm lidhur me burimin e krijimit të shumës 2 500 000 lekë, të pretenduar me burim krijimi të ardhura nga avokatia për vitet 2003-2004.
- ii. Subjekti ka bërë deklarin të pamjaftueshëm lidhur me diferencën e konstatuar në deklaratën “Vetting” dhe atë para fillimit të detyrës për vitin 2006, për shumën e deklaruar në rubrikën “të ardhurat”, me burim të ardhura nga avokatia.
- iii. Subjekti është në mungesë burimesh financiare në shumën 673 390 lekë¹⁷ për të paguar këstin e dytë të kësaj pasurie në vitin 2016, blerjen e automjetin po në këtë vit, si dhe për të kryer shpenzimet e tjera familjare.

2. Për deklarin në lidhje me automjet, tip “Citroen C5”, blerë sipas kontratës nr. *, datë 18.10.2016, në vlerën 900.000 lekë. Burimi i të ardhurave nga pagat e subjektit dhe të bashkëshortes në vite. Pjesa takuese: 100 %. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës këto dokumente¹⁸**

2.1 ILDKPKI-ja në Raportin e përcjellë ka konstatuar: deklarin i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar. Subjekti ka deklaruar në rubrikën “të dhëna konfidenciale” se ky automjet nuk rezulton në emër të tij pasi është ende në proces të ndryshimit të pronësinë dhe për këtë arsye nuk konfirmohet nga DPSHTRR-ja.

Faktet e rezultuara gjatë hetimit administrativ

2.2 Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar konstatohet se subjekti e deklaroi blerjen e këtij automjeti në vitin 2016, me burim krijimi kursime në vite dhe paga e bashkëshortes.

2.3 Kjo pasuri është blerë me kontratën e shitjes, nr. ***, datë 18.10.2016, në vlerën 900 000 lekë, me palë shitëse shtetasen L.T., nëna e subjektit të rivlerësimit.

2.4 Me shkresën nr***prot., datë 2.5.2019, DPSHTRR-ja ka konfirmuar automjetin me targa ***, në pronësi të subjektit të rivlerësimit.

2.5 Rezultoi e provuar se subjekti nga gjendja *cash* e akumuluar ndër vite, në datën 27.12.2016 ka kryer një derdhje në shumën 900 000 lekë dhe në datën 29.12.2016 shumën 450 000 lekë në

¹⁷ Edhe nëse përlllogaritja për fitimin neto nga ushtrimi i aktivitetit të avokatit, do të kryhej duke zbritur nga qarkullimi total vetëm shpenzimet e dokumentuara (pagesat për sigurimet shoqërore, taksat vendore dhe detyrimet tatimore, pa përfshirë shpenzimet e mundshme për utilitete) subjekti do të gjendej përsëri në mungesë burimesh financiare nga shuma 673 390 lekë në shumën 540 478 lekë.

¹⁸Kontratë shitblerje automjeti nr. ***, datë 18.10.2016; vërtetim nr. *** prot., datë 18.10.2016, nga DPSHTRR; certifikata e pronësisë së automjetit me targa ***; dokumentacioni i zhdoganimit të automjetit në datën 5.8.2015; transaksionet bankare në “Credins Bank” (aneks nr. 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së).

llogarinë e tij personale në “Credins Bank”. Në datën 29.12.2016, rezulton se subjekti ka kryer transaksionin bankar drejt shtetasës L.T. (nëna e subjektit), duke paguar shumën 900 000 lekë, për blerjen e automjetit.

2.6 Komisioni kreu analizën financiare mbi mundësinë e blerjes së këtij automjeti, në të njëjtin vit në të cilin është realizuar edhe blerja e apartamentit (2016) nga ku rezultoi se subjekti nuk ka pasur mundësi financiare të paguaj këstin e dytë për blerjen e apartamentit, për blerjen e makinës, si dhe të shpenzoj për pushimet, në shumën 673 390 lekë.

Vlerësimi i Komisionit

2.7 Duke qenë se vlerësimi i bërë në pasurinë nr. 2, por edhe konstatimi final i rezultuar është rrjedhojë e rezultatit të hetimit administrativ dhe e analizës financiare pasqyruar në pasurinë nr. 1, për shkak se investimet në të dy pasuritë i përkasin të njëjtit vit, arsyetimi i trupit gjykues i cituar në pasurinë nr.1, nuk çmohet të ripërsëritet në këtë pasuri, por ai merr të njëjtën vlerë edhe për këtë pasuri.

2.8 Trupi gjykues veç sa sipër, vë theksin se në arsyetimin e bërë për pasurinë nr.1, ka argumentuar gjerësisht mbi ligjshmërinë e shumës 2 500 000 lekës, *cash*, shumë kjo e cila ka ndikuar në analizën financiare për vitin 2016, kohë në të cilën është investuar edhe për këtë pasuri të luajtshme.

2.9 Duke qenë se kjo shumë është shtuar dhe pakësuar ndër vite (siç pasqyrohet *cash*-i faktik i provuar me burime të ligjshme, në tabelën nr. 3), por edhe ka shërbyer si burim krijimi për këtë pasuri, pamjaftueshmëria e subjektit për blerjen e kësaj pasurie, ashtu siç është shpjeguar edhe më sipër, sipas analizës financiare mbetet e pandryshueshme, në shumën 673 390 lekë.

- Në konkluzion për këtë pasuri, trupi gjykues në analizë të fakteve dhe rrethanave sa më sipër arsyetuar, në raport me prapësimet e subjektit në rezultatet e hetimit administrativ, çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka burime financiare të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie.

3. Për deklarinin në lidhje me llogari page në “Credins Bank”, në emër të z. Ndini Tavani, me balancë në datën 26.1.2017 (nr. llogarie *), në vlerën 174 lekë. Pjesa takuese: 100 %.**

3.1 Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës, lëvizjet e llogarisë nr. ***, në emër të z. Ndini Tavani, në “Credins Bank”, për periudhën 6.1.2017 – 26.1.2017. Balanca është në vlerën 174 67 lekë.

3.2 ILDKPKI-ja në Raportin e përcjellë ka konstatuar: deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e “Credins Bank”.

Faktet e rezultuara gjatë hetimit administrativ

3.3 Nga dokumentacioni i administruar në dosjen e hetimit administrativ ka rezultuar se me shkresën nr*** prot., datë 30.5.2019, “Credins Bank” ka konfirmuar llogarinë e pagës në emër të z. Ndini Tavani, me gjendje 174 lekë. Në të tilla kushte:

- Trupi gjykues konstaton se deklarimi i subjektit përputhet me përgjigjen e “Credins Bank”.

4. Për deklarinin në lidhje me llogari page në “Credins Bank” në emër të znj. B. T., me balancë në datën 23.1.2017 (nr. llogarie *), në vlerën 67 758 lekë. Pjesa takuese: 100 %.**

4.1 Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës lëvizjet e llogarisë nr. ***, në emër të znj. B. T., në “Credins Bank”, për periudhën 3.10.2016 - 23.1.2017. Balanca është në vlerën 67 758,21 lekë.

4.2 ILDKPKI-ja në Raportin e përcjellë ka konstatuar: deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar. Ndryshimi ka ndodhur për shkak të paraqitjes së gjendjes në dy data të ndryshme.

- Faktet e rezultuara gjatë hetimit administrativ

4.3 Nga dokumentacioni i administruar në dosjen e hetimit administrativ ka rezultuar se me shkresën nr. *** prot., datë 30.5.2019, “Credins Bank” ka konfirmuar llogarinë e pagës në emër të znj. B. T. me gjendje 67 758 lekë. Në kushte të tilla:

- Trupi gjykues konstaton se deklarimi i subjektit përputhet me përgjigjen e “Credins Bank”.

5. Për deklarimin në lidhje me llogari kursimi në emër të E. T., në “Raiffeisen Bank” me balancë (nr. * llog.) në vlerën 52 399 lekë, në datën 23.1.2017**

5.1 Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës nxjerrje të llogarisë nr***, në emër të E.T., në “Raiffeisen Bank”, për periudhën 1.12.2016 – 23.1.2017. Balanca është në vlerën 52 399 lekë.

5.2 ILDKPKI-ja në Raportin e përcjellë ka konstatuar: deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e “Raiffeisen Bank”.

- Faktet e rezultuara gjatë hetimit administrativ

5.3 Nga dokumentacioni i administruar në dosjen e hetimit administrativ ka rezultuar se me shkresën nr. *** prot, datë 2.5.2019, “Raiffeisen Bank” ka konfirmuar llogarinë e kursimit në emër të E.T., në vlerën 52 399 lekë. Në kushte të tilla:

- Trupi gjykues konstaton se deklarimi i subjektit përputhet me përgjigjen e “Raiffeisen Bank”.

6. Për deklarimin në lidhje me llogari kursimi në emër të K. T., në “Raiffeisen Bank”, me balancë (nr. llog. *) në vlerën 143.306 lekë, në datën 23.1.2017**

6.1 Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës nxjerrje të llogarisë nr. ***, në emër të K. T., në “Raiffeisen Bank”, për periudhën 1.12.2016 – 23.1.2017. Balanca është në vlerën 143 306,29 lekë.

6.2 ILDKPKI-ja në Raportin e përcjellë ka konstatuar: deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e “Raiffeisen Bank”.

- Faktet e rezultuara gjatë hetimit administrativ

6.3 Nga dokumentacioni i administruar në dosjen e hetimit administrativ ka rezultuar se me shkresën nr. ***prot., datë 2.5.2019, “Raiffeisen Bank” konfirmon llogarinë e kursimit në emër të K. T., me gjendje 143 306 lekë. Në kushte të tilla:

- Trupi gjykues konstaton se deklarimi i subjektit përputhet me përgjigjen e “Raiffeisen Bank”.

7. Për deklarimin në lidhje me automjetin tip “Mercedes-Benz” prodhim i vitit 2000, blerë në vitin 2009, me targa *, në vlerën 7 000 euro. Burimi i krijimit të ardhurat nga paga e**

subjektit dhe e bashkëshortes. Shitur sipas kontratës nr. ***, datë 18.10.2016, në shumën 100.000 lekë.

7.1 Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën kontratën e shitblerjes së automjetit¹⁹.

7.2 ILDKPKI-ja në Raportin e përcjellë ka konstatuar: deklarimi i subjekti përputhet me dokumentacionin e dorëzuar. Subjekti ka deklaruar në rubrikën e “*të dhënave konfidenciale*” se ky automjet rezulton ende në emër të tij pasi blerësi nuk ka ndryshuar pronësinë dhe për këtë arsye rikonfirmohet nga DPSHTRR-ja

- Faktet e rezultuara gjatë hetimit administrativ

7.3 Subjekti e deklaroi për herë të parë këtë pasuri në deklaratën periodike të vitit 2009. Ky automjet është blerë në bazë të kontratës nr***, datë 27.7.2009, në shumën 7 000 euro. Pala shitëse është shoqëria “****” sh.p.k., dhe blerës shtetasi Ndini Tavani. Në këtë kontratë blerësi deklaroi se e ka dorëzuar tërësisht shumën e mësipërme.

7.4 Komisioni e ka pyetur²⁰ subjektin në lidhje me burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie (automjet), për të cilën ai ka deklaruar se: “*Burimi i ligjshëm i blerjes së këtij automjeti janë të ardhurat nga pagat e vitit 2009, kursimet në vite dhe përdorimi i kredisë së akorduar në këtë vit për kompensimin e gjendjes cash në fund të vitit 2009*”.

7.5 Nga hetimi rezultoi se kredia është marrë në datën 8.10.2009, në shumën 600 000 lekë, në “Raiffeisen Bank”.

7.6 Në deklaratën periodike të vitit 2009, në lidhje me këtë kredi të marrë në “Raiffeisen Bank”, subjekti ka deklaruar se kjo kredi është marrë për blerjen e pajisjeve shtëpiake, ndërsa në pyetësor ka deklaruar se është marrë për të kompensuar gjendjen e *cash-it* në vitin 2009.

7.7 Subjekti është pyetur²¹ dhe në përgjigje të tij ka deklaruar se nga kredia e marrë në shumën 600 000 lekë, vetëm 100 000 lekë janë shpenzuar për blerje të pajisjeve shtëpiake të cilat ishin të përdorura. Për këto të fundit subjekti ka deklaruar se nuk dispononte fatura, *për vetë natyrën dhe llojin e sendeve të blera dhe për shkak të kalimit të një periudhe shumë të gjatë kohore*, ndërsa për shumën e mbetur prej 500 000 lekësh subjekti ka deklaruar se e ka përdorur për të zëvendësuar gjendjen e *cash-it* që ai kishte një vit më përpara. Si rezultat i këtyre veprimeve financiare gjendja e *cash-it* për vitin 2009 ka mbetur e pandryshuar.

Duke qenë se në vitin 2009 subjekti nuk ka pasur ndryshime në gjendjen e *cash-it*, pasi atë që ka shpenzuar për blerjen e automjetit e ka kompensuar me kredinë e marrë në “Raiffeisen Bank”, nuk ka deklaruar shtesa dhe pakësime në vitin 2009.

7.8 Nga deklarimi i subjektit në deklaratën periodike të vitit 2016, si dhe në deklaratën “Vetting”, rezultoi se kjo pasuri është shitur në vitin 2016 sipas kontratës së shitjes nr. ***, datë 18.10.2016, në shumën 100 000 lekë. Në këtë kontratë pasqyrohet si palë shitëse z. Ndini Tavani dhe palë blerëse znj. F. M. .

7.9 Edhe nga hetimi i Komisionit, sipas informacionit të DPSHTRR²², rezultoi se ky automjet me targa ***është shitur dhe nuk është në pronësi të subjektit apo personave të lidhur me të.

¹⁹ Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 18.10.2016. Bashkëngjitur kontratës së shitjes së automjetit, ka bashkëlidhur kontratën e blerjes së tij në vlerën 7 000 euro, datë 27.7.2009, shoqëruar me dokumentacionin ligjor të mjetit në pronësi të z. Ndini Tavani (aneks nr. 4/7 në dosjen e ILDKPKI-së).

²⁰ Pyetësori nr. 2, datë 19.4.2019, në dosjen e Komisionit.

²¹ Referojuni kërkimit me tekst të *e-mail* datë 2.7.2019, në dosjen e Komisionit.

²² Referojuni shkresës nr. *** prot., datë 2.5.2019, të DPSHTRR-së dhe dokumentacionit bashkëlidhur në dosjen e Komisionit.

7.10 Komisioni kreu analizën mbi mundësitë financiare të subjektit për blerjen e kësaj pasurie, me të dhënat e pasqyruara në tabelën nr. 4.

Tabela nr. 4

Nr.	Përshkrimi	2009
1	TË ARDHURA	1,486,493
	Paga subjekti + bashkëshortja	1,486,493
2	SHPENZIME	207,621
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	409,860
	Shpenzime qiraje	48,000
	Shpenzime <i>TIMS</i>	82,793
	Shpenzimi kredia 260 000 lekë (principal+interes)	113,242
	Shpenzimi kredia 600 000 lekë (principal +interes)	(546,273)
	Shpenzime pajisje shtëpiake (blerë me kredinë)	100,000
3	PASURI	1,889,915
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme	
	Blerje automjeti tip, “Mercedes-Benz”, me targa ***, datë 27.7.2009	960,190
	Ndryshim likuiditeti	929,725
	DIFERENCA (1-2-3)	-611,044

7.11 Komisioni, nga analizimi i fakteve dhe i rrethanave të përshkruara më sipër për hetimin e kësaj pasurie, si dhe pas kryerjes së përlogaritjeve financiare, pasqyruar në tabelën nr. 4 më lart, konstatoi dhe për rrjedhojë i kaloi subjektit barrën²³ e provës, pasi:

- i. dukej se subjekti nuk kishte pasur mundësi financiare në shumën 611 044 lekë për blerjen e kësaj pasurie të luajtshme, si dhe të përballonte shpenzimet e tjera familjare.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

7.12 Subjekti, ndër të tjera është shprehur se nga verifikimi i analizës financiare të vitit 2009, vlerëson faktin që Komisioni ka pasur qasje të drejtë mbi të ardhurat që ai ka përdorur për blerjen e makinës, me burim krijimi kredinë (e cila ka kompensuar ne momentin pas blerjes, gjendjen e *cash-it* te krijuar nder vite) dhe kursimet nga të ardhurat e vitit 2009, ashtu sikurse ai ka shpjeguar në mënyrë të detajuar në përgjigje të pyetësorëve.

7.13 Ndërsa subjekti pretendon se ka vërejtur që në rubrikën “*ndryshim likuiditeti*” është pasqyruar me të drejtë në kuptim të analizës vjetore të vitit 2009, depozita në shumën 5 200 euro krijuar në janar të vitit 2009, por sqaron se kjo depozitë faktikisht ka qenë krijuar me të ardhurat e kursyera gjatë vitit 2008.

²³ Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, dhe paragrafit 3 dhe 5, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, refero rezultatet për specifikimet në detaje.

7.14 Subjekti ka sqaruar se më parë nuk është pyetur nga Komisioni lidhur me këtë fakt dhe për pasojë ka parashtruar se krijimi i depozitës prej 5 200 euro në janar të vitit 2009 ka pasur si burim të ardhurat familjare nga kursimet e vitit 2008. Ky fakt është pasqyruar edhe në deklaratën periodike të vitit 2009, konkretisht në faqen 3 dhe 10 të saj, në deklarinimin e tij si subjekt dhe atë të personit të lidhur. Vetë data e krijimit të kësaj depozite krijon bindjen për origjinën e kësaj depozite.

7.15 Për këto arsye, subjekti ka kërkuar që në analizën financiare të vitit 2009 të zbritet si zë ndryshim (shtesa) likuiditeti në vlerën prej 5 200 euro, duke pretenduar që analiza financiare e vitit 2009 rezulton në balancë pozitive.

Vlerësimi i Komisionit

7.16 Trupi gjykues çmon se pretendimi i subjektit nuk qëndron, për faktin se:

- i. Në deklarinimin periodik vjetor të vitit 2009 subjekti nuk ka deklaruar ndryshim të gjendjes *cash*, shtesa apo pakësime. Kjo nënkupton që gjendja *cash* e vitit 2008 është mbartur edhe në vitin pasardhës.
- ii. Dukshëm konstatohet se subjekti e ka pasur të qartë, pra, ka qenë i mirënjohur me mënyrën e deklarinimit të gjendjes *cash* me shtesat dhe pakësimet përkatëse, përkatësisht në deklaratat periodike të viteve 2011, 2012, 2014, 2015, 2016 dhe për pasojë në të njëjtën linjë do të kishte deklaruar pakësimin e gjendjes *cash* në vitin 2008 për shkak të krijimit të kësaj depozite.
- iii. Subjekti në pyetësorë ka ndryshuar burimin e krijimit për blerjen e automjetit, duke deklaruar pakësimin e gjendjes *cash* dhe kompensimin e kësaj të fundit me kredinë e përfituar në këtë vit, që gjithashtu e kishte marrë me qëllim mobilimi, ndërsa në pyetësorë e deklaroi se me të kompensoi *cash-in* e prekur.

7.17 Megjithë sa sipër, trupi gjykues, për një hetim objektiv dhe të paanshëm, duke i qëndruar pretendimit të subjektit se shuma prej 5 200 euro e depozituar në bankë është si rezultat i pakësimit të gjendjes *cash* të vitit 2008, konstaton se në rastin më të mirë, kjo shumë, vërtet nga njëra anë do të mund të sistemonte rezultatin financiar të vitit 2009, duke e kaluar subjektin në balancë pozitive, por nga ana tjetër ky pakësim i gjendjes *cash* të vitit 2009 prej 5 200 euro, do të reflektohej në shumën *cash* e mbledhur deri në vitin 2016, kohë në të cilën subjekti do të rezultonte me më pak gjendje *cash* në dispozicion (5 200 euro më pak) për të investuar në këstin e dytë të pasurisë nr. 1 dhe në blerjen e automjetit dhe për pasojë do të rezultonte në balancë negative në një shumë disa herë më të lartë nga ajo e pasqyruar në tabelën nr. 4. Më konkretisht balanca negative do të rezultonte nga 673 390 lekë në 1 324 326 lekë²⁴.

7.18 Trupi gjykues, për të gjithë arsyet e lartpërmendura, në përfundim të të gjithë analizës së mësipërm, çmon se:

- subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarinim të pasaktë lidhur me pakësimin e gjendjes *cash* në vitin 2009; dhe për pasojë
- subjekti rezulton në balancë negative në shumën 611 044 lekë për blerjen e kësaj pasurie të luajtshme, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare.

7.19 Trupi gjykues, edhe në variantin pretendues të subjektit sa më sipër arsyetuar, çmon se:

²⁴ Shtuar balanca negative me 5 200 euro, të konvertuara me kursin mesatar të muajit janar të vitit 2009 sipas Bankës së Shqipërisë (1 euro = 125.18 lekë).

- subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë në deklaratën për vitin 2009, pasi nuk ka deklaruar pakësimin e gjendjes *cash* në shumën 5 200 euro; dhe për pasojë
- sipas analizës financiare për vitin 2009, subjekti do të rezultojë me bilanc pozitiv, por ky pakësim i gjendjes *cash* do të ndikojë në analizën financiare të vitit 2016, ku subjekti do të rezultojë me balancë negative në vlerën 1 324 326 lekë.

8. Për deklarimin në lidhje me gjendje *cash* (para në dorë) jashtë sistemit bankar. Vlera: 100 000 lekë. Burimi i të ardhurave shitja e automjetit, tip “Mercedes-Benz”, sipas kontratës nr. ***, datë 18.10.2016. Pjesa takuese: 100 %.

8.1 ILDKPKI-ja në Raportin e përcjellë ka konstatuar: të ardhurat familjare janë të mjaftueshme dhe justifikojnë gjendjen *cash* të deklaruar.

Faktet e rezultuara gjatë hetimit administrativ

8.2 Komisionit i ka rezultuar se subjekti e deklaroi shitjen e kësaj pasurie në deklaratën periodike të vitit 2016, sipas kontratës nr. ***, datë 18.10.2016, në shumën 100 000 lekë. Gjithashtu, nga dokumentacioni i administruar konfirmohet shitja e këtij automjeti sipas kontratës së sipër cituar në po të njëjtën shumë.

Konstatohet se e njëjta shumë mbartet edhe në deklarimin në deklaratën “Vetting”. Në të tilla kushte:

- Komisioni nuk ka vërejtur problematika në deklarimin e subjektit.

GJETJE TË TJERA

9. Komisioni gjatë hetimit administrativ konstatoi se subjekti kishte deklaruar në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës, *apartament banimi me sip. 65 m², me adresë: Lagjja “***” i cili është në ndërtim, i pahipotekuar...* apartamenti është ndërtuar me të ardhurat e prindërve dhe nga puna e subjektit. Vlera: 35 000 euro. Pjesa takuese: 1/3.

9.1 Nga dokumentacioni i administruar në dosjen e ILDKPKI-së, nga hetimi i kryer nga Komisioni, si edhe nga përgjigjet në pyetësorë, rezulton se ky apartament është blerë me kontratën nr. ***, datë 13.1.2005, me palë shitëse shoqërinë “***” sh.p.k., dhe palë blerëse znj. L. T., nëna e subjektit. Vlera e apartamentit sipas kontratës është 32 600 euro.

9.2 Komisioni e ka pyetur subjektin në lidhje me kontributin e dhënë në vlerë monetare në këtë pasuri, për të cilin përveçse ka pranuar këtë kontribut, nuk ka deklaruar se sa saktësisht është vlera e kontribuar prej tij.

9.3 Komisioni nisur nga:

- deklarimi i kësaj pasurie nga subjekti në deklaratën për vitin 2006 (para fillimit të detyrës), në 1/3 pjesë takuese;
- përgjigja e dhënë në pyetësor²⁵, *se kontributi i tij në këtë pronë është vetëm në vlerë monetare si e deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2006, si kontribut për prindërit e tij dhe pa shprehur në asnjë rast pretendime mbi pasurinë...*,

ka kryer analizën financiare lidhur me mundësinë e tij për të kontribuar në 1/3 pjesë takuese në pagesat e kryera për blerjen e kësaj pasurie.

²⁵ Referojuni përgjigjeve të dhëna në pyetësorin nr. 2, në dosjen e Komisionit.

9.4 Në këtë analizë të ardhurat nga ushtrimi i profesionit të avokatit janë përllogaritur në masën 80 % të qarkullimit të deklaruar.

9.5 Në bazë të të dhënave të administruara analiza financiare për këtë pasuri pasqyrohet në tabelën nr. 5.

Tabela nr. 5

Nr.	Përshkrimi	Para 2006
1	TË ARDHURA	2,076,850
	Paga subjekti (avokatia + magjistratura)	2,076,850
2	SHPENZIME	349,496
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	297,285
	Shpenzime TIMS	52,211
3	PASURI	3,917,869
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme	
	Apartament, sip. 65 m ² , Lagja “***”	1,378,871
	Ndryshim likuiditeti	2,538,998
	DIFERENCA (1-2-3)	-2,190,516

9.6 Komisioni nga analizimi i fakteve dhe rrethanave të përshkruara më sipër për hetimin e kësaj pasurie, si dhe pas kryerjes së përllogaritjeve financiare, pasqyruar në tabelën nr. 5 më lart, konstatoi dhe për rrjedhojë i kaloi subjektit barrën²⁶ e provës, pasi:

- i. dukej se subjekti nuk kishte pasur mundësi të paguante shumën 2 190 516 lekë, për 1/3 pjesë takuese për këtë pasuri dhe të përballonte shpenzimet e tjera familjare, si edhe duke përllogaritur 1/3 pjesë takuese të kësteve të paguara për këtë pasuri, subjekti rezultonte në pamundësi financiare në shumën 2 038 248 lekë;
- ii. dukej se subjekti kishte kryer deklaram pasaktë, pasi nuk e kishte deklaruar në deklaratën “Vetting”, kontributin e tij në pjesën takuese sipas deklaramit për vitin 2006;
- iii. dukej se subjekti kishte kryer deklaram të pasaktë në lidhje me vlerën e kontratës së këtij apartamenti, pasi në deklaratën para fillimit të detyrës e kishte deklaruar 35 000 euro, ndërkohë nga kontrata rezulton se vlera e apartamentit është në shumën 32 600 euro.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

9.7 Subjekti ndër të tjera në prapësimet e tij por edhe në seancë dëgjimore ka deklaruar se *apartamenti është apartament i prindërve të tij si ligjërisht dhe faktikisht. Ka deklaruar se deklarimi para fillimit të detyrës ka pasur gjithmonë, jo vetëm për të, por dhe për subjekte të tjera pasaktësi dhe paqartësi në mënyrën e përpilimit. Ka shpjeguar se kontributi ka qenë vetëm kontribut moral dhe kontribut modest në respekt të familjes dhe në falënderim të gjithë mundit*

²⁶ Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafit 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, refero rezultatet për specifikimet në detaje.

dhe sakrificës së tyre për shkollimin dhe rritjen si bir të tyre. Gjithashtu ka cituar se: “Referuar dispozitave të Kodit Civil, referuar gjithë gjetjeve të Komisionit, referuar faktit se kontrata është lidhur në emër të nënës sime, referuar pagesave që ju i keni administruar nga ana ime dhe subjekti ndërtues, të gjitha pagesat janë kryer deri në janar 2006 dhe janë kryer po nga nëna ime. Ata atje banojnë sot dhe kësaj dite, referuar dhe provave të tjera që janë kontratat e ujit dhe të OSHEE-së të cilat u kam vënë në dispozicion, nuk ka asnjë gjetje nga ana e Komisionit dhe nuk ka asnjë fakt që të më lidhi mua me atë pasuri. Në këtë kuptim dhe përgjigjet e mia lidhur me kontributin janë të vërteta dhe duhet të kem qasjen pozitive të Komisionit, pasi ky kontribut nuk mund të përkthehet vetëm me vendosjen e thyesës 1/3, që unë e kam kuptuar si 3 veta nga një familje që do të jetonim aty dhe të konsideruar të banesës së prindërve si shtëpia e të tërëve, të më faturohet vlera fikse e 1/3-tës vlerës së apartamentit e paguar deri në momentin që po flasim pasi siç ju kam vënë në dijeni e kanë akoma, është akoma edhe një vlerë prej 3 600 euro për tu paguar deri në shlyerjen e plotë të detyrimeve. Në vijim ndër të tjera ka parashtruar se: “Para së gjithash duhet evidentuar se bazuar në ligjin nr. 84/2016, kam përmbushur të gjitha detyrimet e mia lidhur me deklarimin e plotë dhe të saktë të të gjitha pasurive që disponoj, përfshirë edhe atë të familjareve të mi (bashkëshortja dhe fëmijët). Përveç sa kam deklaruar në deklaratën “Vetting”, unë nuk disponoj asnjë pasuri tjetër, duke nënkuptuar me këtë term çdo të drejtë personale apo reale.

Unë nuk kam asnjë të drejtë ligjore mbi këtë pasuri, nuk gëzoj asnjë të drejtë reale dhe, rrjedhimisht, nuk kam asnjë pretendim mbi këtë pasuri. Apartamenti me kontrate porosie është lidhur nga mamaja ime dhe sot gëzohet qetësisht, bashkërisht, nga të dy prindërit e mi. Duke konsideruar që detyrimi ligjor sipas ligjit nr. 84/2016, ishte detyrim që kishte epërsi edhe mbi gabimet që mund të ishin kryer në deklaratat e mëparshme kam vlerësuar drejtë dhe saktë në deklaratën “Vetting” vetëm ato pasuri që më përkasin mua dhe që janë vendosur me burimet e mia të ligjshme. Përveç atyre pasurive dhe të ardhurave nuk disponoj asnjë pasuri tjetër duke konkluduar se kontributi për familjen, për shtëpinë e prindërve, është ai kontribut në ndihmë të familjes, në kontribut ndoshta të përditshëm të blerjes së një diçkaje, të blerjes së një sendi të luajtshëm për familjen e cila kurrsesi nuk mund të përkthehet në 1/3-tën vlerë të apartamentit.... Unë jam biri i prindërve të mi dhe pavarësisht se që prej vitit 1998 jam ndarë nga familja prindërore, lidhjet familjare (prind-fëmijë) janë të tilla që do të mbajnë kurdoherë mes nesh lidhjen e përrjetshme, për shkak të dashurisë natyrore. Në këtë kontekst, dëshira e prindërve për të blerë një apartament, sikurse edhe vendime të tjera që merreshin prej tyre, është konsultuar edhe me mua si biri i vetëm. Në këto kushte, duke qenë i përfshirë shpirtërisht në këtë marrëdhënie, për shkak edhe të kontributit tim modest, si dhe duke mos qenë tërësisht i qartë në deklarimin e parë të pasurisë, kam vendosur thyesën 1/3”.

9.8 Gjithashtu, subjekti ka kërkuar që të bëhen zbritje në zërin shpenzime TIMS, përpara fillimit të detyrës, në shumën 52 211 lekë, për arsye sepse lëvizja/udhëtimi nga data 18.10.2005 deri 22.10.2005, në Itali ishte organizuar nga Këshilli i Evropës dhe Shkolla e Magjistraturës. Subjekti depozitoi informacionin e përcjellë nga Shkolla e Magjistraturës me e-mail.

Vlerësimi i Komisionit

9.9 Trupi gjykues çmon në konsideratë të fakteve se:

- i. kjo pasuri si porosites dhe pages të drejtpërdrejtë ka pasur nënën e subjektit të rivlerësimit dhe jo këtë të fundit;
- ii. kjo pasuri nuk rezultoi e regjistruar në ZVRPP;

- iii. vetëm deklarimi 1/3 pjesë takuese, i bërë nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën para fillimit të detyrës nuk konkurron në raport me dy faktet e mësipërme dhe për pasojë nuk imponon që pjesës takuese ti vishet domosdoshmërisht përlllogaritja në vlerë monetare;
- iv. për kontributin e 1/3 pjesë takuese subjekti i rivlerësimit nuk e përjashtoi veten nga dhënia e një kontributi financiar ndaj familjes së tij, edhe pse nuk deklaroi asnjë vlerë, si gjatë hetimit administrativ por edhe në prapësimet e tij;

9.9.1 Nga njëra anë nuk mund të krijohet një perceptim i qartë mbi qëndrueshmërinë e balancës negative të reflektuar në tabelën nr. 5, por nga ana tjetër:

- i. referuar deklarimit të subjektit për kontributin e dhënë, sado të ketë qenë ai, sikurse subjekti ka deklaruar ekzaktësisht në deklaratën para fillimit të detyrës për vitin 2006 ... *apartamenti është ndërtuar me të ardhurat e prindërve të mi dhe të mijat nga puna;*
 - ii. pa anashkaluar deklarimin përgjatë hetimit administrativ ...*se kontributi i tij në këtë pronë është vetëm në vlerë monetare si e deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2006...*;
 - iii. pa shkëputur vëmendjen nga konstatimi se subjekti me deklarimet e tij nuk është tërhequr nga ky kontribut;
 - iv. se gjatë hetimit ka deklaruar se e ka përdorur këtë pasuri për dy vjet 2011-2013, arrin në konkluzion se:
 - Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të paplotë në koherencë me faktet e konstatuara, mbi marrëdhënien e tij në raport me këtë pasuri, si dhe me kontributin e dhënë për të, duke mos provuar vërtetësinë e deklarimeve të tij për masën e kontributit, për të ribërë analizën e mëtejshme financiare²⁷.
- ➔ Gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se prindërit e subjektit të rivlerësimit në disa vite kalendarike kanë depozituar në llogaritë e tyre personale hera-herës shuma të konsiderueshme.

10. Referuar treguesve financiarë në tabelën nr. 6 konstatohen lehtësisht rritje të shumave nga njëri vit në tjetrin. Më konkretisht referuar kësaj tablele dhe viteve të pasqyruara në të vërehet se shumata në llogarinë bankare, në mënyrë konsistente rriten ndjeshëm, p.sh. nga viti 2008 në vitin 2009 me vlerën 2 000 000 lekë; nga viti 2009 në vitin 2010 me vlerën 1 900 000 lekë; nga viti 2011 në vitin 2012 me vlerën 970 000 lekë; si dhe nga viti 2015 në 2016 me vlerën 911 000 lekë, ku gjendja në bankë në vitin 2016 e të dy prindërve të subjektit është në vlerën 13 816 873 lekë.

10.1 Komisioni nisur nga faktet e pasqyruara në pikën 9.3 më sipër, por edhe nga marrëdhënia kontraktore e shitblerjes së automjetit të pasqyruar në pikën 2 më sipër, e krijuar midis subjektit dhe me nënën e tij, pasi ngriti dyshime nisur nga raporti familjar; deklarimi i subjektit në pyetësor²⁸ se nga viti 2006 (kohë e fillimit të detyrës) deri rreth fillimit të vitit 2008 ka banuar në banesën e prindërve të ndodhur në Rr. “****”, p. “****”, Tiranë, dhe për periudhën 2011 deri në muajin shtator të vitit 2013, për shkak të punës në Prokurorinë e Rrethit Tiranë; ka vlerësuar të përfshijë në rrethin e personave të tjerë të lidhur prindërit e subjektit, sipas parashikimit ligjor të bërë në pikën 14, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer në vijim analizën financiare lidhur me mundësinë e tyre për të krijuar të ardhura të pasqyruara në transaksione bankare.

²⁷ Është marrë në konsideratë zbritja e shpenzimeve të udhëtimit për vitin 2005; balanca negative në tabelën nr. 5 nga shuma 2 190 516 lekë shkon në 2 138 305 lekë.

²⁸ Referojuni përgjigjes dhënë në tekst të e-mailit, datë 06.09.2019, në dosjen e Komisionit

10.2 Komisioni ka mbajtur korrespondencë me institucionet publike për të provuar mbi punësimet e prindërve, ushtrimin e ndonjë aktiviteti privat, si dhe ka pyetur subjektin e rivlerësimit.

10.3 Nga aktet e administruara ka rezultuar informacion jo i plotë mbi të ardhurat e përfituara nga ushtrimi i aktivitetit privat të babait të subjektit (farmaci veterinarë).

10.4 Subjekti është pyetur²⁹ mbi burimin e ligjshëm të këtyre transaksioneve, nga ku ndër të tjera ka deklaruar se: *“...nuk kam qenë në dijeni të investimeve në ankand, të shumave të parave të prindërve të mi Ll. dhe L. T.. Pas ardhjes në dijeni të pyetjes kam pyetur prindërit e mi të cilët janë treguar të rezervuar në shpjegime të hollësishme lidhur me gjendjen e llogarive të tyre bankare. Nisur nga mosha e tyre dhe gjendja jo e mirë shëndetësore, nuk kam insistuar në kërkimin e historikut të depozitimit dhe investimit të këtyre shumave. Megjithatë, prindërit më kanë sqaruar se shuma prej 9 000 000 lekë është derivat i shumës prej 8 400 000 lekë duke shtuar interesat bankare. Për sa i përket burimit të këtyre shumave jam vënë në dijeni se shumata e parave që ndodhen në bankat e nivelit të dytë janë shuma që kanë si origjinë dhe burim aktivitetin tregtar të babait tim të ushtruar që nga mesi i viteve `90 deri në vitin 2016 kur është çregjistruar në organet tatimore, me objekt veprimtarie ‘Farmaci Veterinarë’, punës së tij prej vitesh si veteriner në ente publike, punës së nënës me profesion ekonomiste, dietave dhe shpërblimeve nga puna e tyre dhe të ardhurat nga interesat bankare (maturimet e depozitave)”*.

Subjekti ka depozituar:

- ekstrakt të QKB-së për personin fizik “Ll. T.”;
- kontratë nr. ***, datë 13.1.2005;
- leje tregtimi për shitjen e materialeve për përdorim veterinarë nr. ***, datë 20.8.1993, për z. Ll. T.;
- librezë e dritave sipas kontratës nr. ***, datë 13.1.2005, që i përket shtetases L. T.;
- librezë pensioni, datë 1.1.2006, e z. Ll. T.;
- librezë pensioni, datë 7.7.2009, e z. Ll.T.;
- librezë pensioni, datë 18.9.2013, e znj. L.T.;
- librezë uji, sipas kontratës nr. ***, datë 13.1.2005, në emër të znj. L. T.;
- vërtetim sipas kontratës nr***, datë 13.1.2005, nga subjekti ndërtues “****” sh.p.k. për shtëpinë;
- mandatpagesa të vëna në dispozicion nga subjekti “****” sh.p.k. për shtëpinë sipas kontratës nr. ***, datë 13.1.2005;
- mandatpagesa të disponuara nga znj. L. T., sipas kontratës nr. ***, datë 13.1.2005, për shtëpinë;
- vërtetim, datë 29.4.2019, i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave, Bashkia Berat, person fizik “Ll. T.”;
- vërtetim page për periudhën 1994 – 1999 dhe librezë e punës për z. LL.T.;
- vërtetim page për periudhën 1994 – 2013 dhe librezë e punës për znj. L. T.;
- vërtetim, datë 12.10.2016, i Bashkisë Berat, Lagjja nr. ***, për shkëputjen nga trangu familjar sipas vendimit me nr. ***, datë 27.5.1998, të Këshillit Bashkiak Berat.

10.5 Komisioni kreu analizën financiare lidhur me mundësinë e krijimit të këtyre të ardhurave, të dhënat e të cilës janë pasqyruar në tabelën nr. 6.

²⁹ Referojuni përgjigjeve të dhëna në pyetësorin 3, në dosjen e Komisionit.

Tabela nr. 6

Mundësia për të kursyer						
Viti	Total të ardhura	Interesa bankare	Shpenzime jetese	Investime	Balanca akumulative	Gjendja në bankë
1994	121,389		72,833		48,555	
1995	167,413		100,448		115,521	
1996	155,659		93,395		177,784	
1997	245,268		147,161		275,892	
1998	290,231		180,000		386,123	
1999	532,850		180,000		738,973	
2000	473,824		180,000		1,032,797	
2001	492,604		180,000		1,345,401	
2002	513,774		120,000		1,739,175	
2003	587,263		187,728		2,138,710	
2004	552,953	37,892	187,728		2,541,827	2,393,403
2005	609,912	523,920	219,114	2,205,720	1,250,825	3,794,045
2006	1,139,399	217,350	219,114	164,937	2,223,522	4,200,561
2007	1,247,076	217,307	273,240		3,414,665	4,436,348
2008	1,307,105	168,478	273,240	2,974,857	1,642,151	4,867,225
2009	1,472,357	426,762	273,240		3,268,030	7,332,302
2010	1,524,060	-4,449	273,240	1,041,075	3,473,325	9,235,128
2011	1,541,712	394,722	273,240		5,136,520	9,839,157
2012	1,566,338	953,512	282,048		7,374,322	11,762,336
2013	1,441,465	316,903	282,048		8,850,642	12,012,616
2014	713,746	812,746	439,996		9,937,138	12,692,832
2015	1,053,403	54,033	448,552	1,353,191	9,242,831	12,577,230
2016	1,540,350	327,726	470,184		10,640,723	13,816,873
	19,290,152	4,446,901	5,356,549	7,739,781	10,640,723	13,816,873

10.6 Në tabelën e mësipërme janë evidentuar me të kuqe vitet ku prindërit e subjektit janë bërë palë e lidhur (në cilësinë e personave të tjerë të lidhur) me subjektin. Përkatësisht në vitin 2005 kur është blerë apartamenti në Tiranë ku subjekti ka qenë kontribuues në blerjen e tij dhe në vitin 2016 ku subjekti ka blerë automjetin nënës së tij, znj. L.T. .

10.6.1 Siç vihet re mundësia e prindërve të subjektit për të kursyer deri në vitin 2005 ka qenë në shumën 1 250 825 lekë, ndërsa gjendja në bankë e tyre rezulton në shumën 3 794 045 lekë. Pra, rezulton një balancë negative në shumën 2 543 220 lekë.

10.6.2 Ndërsa deri në vitin 2016 mundësia e prindërve të subjektit për të kursyer ka qenë në shumën 10 640 723 lekë, ndërsa gjendja në bankë është 13 816 873 lekë. Pra, rezulton një balancë negative në shumën 3 176 151 lekë.

10.7 Komisioni, nga analizim i fakteve dhe rrethanave të përshkruara më sipër për hetimin e kësaj pasurie, si dhe pas kryerjes së përlllogaritjeve financiare, pasqyruar në tabelën nr. 6 më lart, konstatoi dhe për rrjedhojë i kërkoi shpjegime subjektit

– mbi situatën e pasqyruar në lidhje me provueshmërinë e burimit të ligjshëm të balancave negative ndër vite, të pasqyruara në tabelën nr. 6 dhe kryesisht për vitin 2005 dhe vitin 2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

10.8 Subjekti në parashtrimet e tij por edhe në seancë dëgjimore, ndër të tjera lidhur me të ardhurat e prindërve të tij ka pretenduar se prindërit e tij, sidomos babai, nuk duhet të konsideroheshin nga Komisioni si persona të tjerë të lidhur. Ai ka cituar se: *“...në kuadrin e të qenurit bashkëpunues nga fillimi i këtij procesi deri në fund, proces të cilit unë iu bëra pjesë me vullnetin tim të plotë për të qenë pjesë e Prokurorisë së Posaçme. Ju kam vënë në dispozicion analizën time me dokumentacionet që kam mundur të gjej dhe që nga ana e Komisionit janë vënë në dispozicion, mbi të ardhurat dhe mbi fitimin e mundshëm në mungesë të qarkullimit faktik dhe të dokumentacionit të plotë për prindërit e mi...referuar dhe dokumentacionit të organeve tatimore, se babai im nuk është çregjistruar dhe çregjistrimi është i lidhur ngushtësisht me mungesën e detyrimeve tatimore, kjo dhe nga vërtetimi i Bashkisë së Beratit se babai im nuk ka pasur momente çregjistrimi dhe detyrime të prapambetura...rrjedhimisht për periudhën 2007–2013, rezulton e provuar se tatimet janë paguar për qarkullimin deri 2.000.000 lekë...në referim të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, dhe të mungesës të dokumentacionit të plotë për qarkullimin faktik dhe të marzhës së fitimit, siç pranohet me të drejtë nga Komisioni në raport”*. Subjekti ka kërkuar të vlerësohet pozitivisht objeksioni i tij duke vendosur si qarkullim, atë për të cilin janë paguar tatimet për vitet 2007–2013 në shumën 2 000 000 lekë. Subjekti, në parashtrimet e tij, ka vijuar: *“... se i njëjti arsyetim vlen për periudhën 1999 – 2000, pa pasur objeksione për vitin 2003–2007, që siç u njoha nga dosja e Komisionit ka pasur dokumentacion lidhur dhe me qarkullimin faktik”*.

10.9 Subjekti ka kërkuar të konsiderohet ushtrimi i aktivitetit tregtar të babait të tij prej fillimit të vitit 1993, për të cilin është pajisur me leje për shitblerjen e materialeve për shërbim veterinar. Në parashtrimet e tij subjekti ka qartësuar mbi këtë aktivitet, duke i ndarë periudhat përkatësisht nga viti 1993 – 1999, 1999 – 2016, si dhe ka shpjeguar me analizë ligjore të ardhurat e ligjshme nga aktiviteti tregtar i babait të tij për periudhat 1999 – 2002 dhe 2002 – 2016. Subjekti ka referuar legjislacionin e kohës për tatimin mbi biznesin e vogël, ka referuar pagesat sipas fletë njoftimeve tatimore, ka qartësuar mbi pagesat e detyrimeve tatimore nga babai i tij në ushtrim të aktivitetit tregtar. Subjekti ka parashtruar se: *“... në analizë të gjithë të dhënave..., ligjërisht rezulton e provuar se babai im ka paguar detyrimet tatimore për vitin 1999 për qarkullimin prej rreth 833,000 lekësh dhe për vitet 2000 – 2002 për qarkullimin prej 2 000 000 lekësh për çdo vit.”*

10.10 Subjekti ka kërkuar: *“... në favor të situatës financiare të babait tim të vlerësohen si vlera të ligjshme për të cilat janë paguar tatimet për periudhat 1999 – 2002 dhe 2006 – 2013, qarkullimi në vlerën 2 milionë lekë”* (përjashtim bën vetëm viti 1999, paguar tatim si biznes i vogël 0 - 2 milionë për 5 muaj). Subjekti ka kërkuar sistemimin e tabelës së qarkullimit dhe fitimit për babain e tij Ll. T. . Subjekti nuk ka ngritur pretendime lidhur me vlerësimin e Komisionit për marzhën e fitimit nga ushtrimi i biznesit të babait të tij, por ka theksuar se: *... të ardhurat e përfituara nga babai nga aktiviteti tregtar dhe të ardhurat nga pagat e prindërve të tij ndër vite kanë qenë të konsiderueshme dhe mundësojnë plotësisht pasuritë e krijuara e*

nga ana e tyre. Gjithashtu, subjekti ka pretenduar për përfshirje në analizën financiare të disa shumave për llogari të nënës së tij, si dhe ka kërkuar të vlerësohet pozitivisht analiza financiare nisur nga të dhënat e administruara, ligji i zbatueshëm i kohës, si dhe situata faktike. Po ashtu, ka kërkuar që në vlerësim të të gjithë të dhënave që ka pasqyruar në prapësime, të arsyetimit ligjor dhe atij logjik (të bërë edhe në mungesë të pjesshme të dokumentacionit), si dhe në harmoni me të gjitha provat e administruara nga Komisioni në kuadër të këtij procesi, në analizën financiare të prindërve të tij, të reflektojë ndryshimet, përkatësisht:

1. Për periudhën 1993 – 1999, në mungesë të dokumentacionit për të ardhurat e fituara nga aktiviteti tregtar, të zbriten të gjitha shpenzimet jetike.
2. Për periudhat 1999 – 2002 dhe 2007 – 2013, të shtohen shumat e të ardhurave të fituara nga aktiviteti tregtar i babait të subjektit.
3. Të shtohen si të ardhura, të ardhurat e përfituara nga nëna e subjektit në formën e shpërblimeve ndër vite dhe ndryshimet në vlerat e pagës sipas të dhënave nga llogaria bankare.
4. Të zbriten si shpenzime të ardhurat e përfituara si dieta nga nëna e subjektit ndër vite.

Vlerësimi i Komisionit

10.11 Trupi gjykues, në vlerësim të fakteve dhe të rrethanave të cilësuar në rezultatet e hetimit, si dhe duke analizuar prapësimet, kontestimet dhe kërkimet e subjektit, konstaton fillimisht se duke mbajtur në vëmendje faktet që subjekti i rivlerësimit:

- i. deklaronte në deklaratën para fillimit të detyrës për vitin 2006, pjesën takuese 1/3 në pasurinë e porositur nga nëna e tij në vitin 2005, për të cilën është arsyetuar dhe konkluduar më sipër;
- ii. për kontributin e 1/3 pjesë takuese subjekti i rivlerësimit nuk e përjashtoi veten nga dhënia e një kontributi financiar ndaj familjes së tij, edhe pse nuk deklaroi asnjë vlerë, si gjatë hetimit administrativ por edhe në prapësimet e tij;
- iii. deklaronte përdorimin e kësaj pasurie, në mënyrë konsistente nga viti 2011 deri në vitin 2013 për shkak të ushtrimit të profesionit të prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë,

si dhe të drejtën dhe kompetencën që i njeh ligji për të hetuar gjerësisht, me paanësi dhe pa paragjykuar në çdo rast, ka kryer hetim të plotë dhe objektiv, të nevojshëm për të konkluduar mbi nivelin e provueshmërisë së burimit të ligjshëm të transaksioneve bankare të prindërve të tij.

10.12 Trupi gjykues, përtej çdo kontestimi të subjektit, ka vlerësuar që subjekti të jepte shpjegime kryesisht për dy vite, ku njëri prej tyre pasqyrore lidhjen e tij me prindërit mbi përdorimin e banesës dhe kontributit të dhënë nga subjekti sipas deklarimeve të tij gjatë hetimit administrativ *...se kontributi i tij në këtë pronë është vetëm në vlerë monetare si e deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2006...*

10.13 Por, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit, megjithëse kërkon rishikim të analizës financiare, duke përfshirë disa shuma në favor të nënës së tij, por edhe sistemim të qarkullimit të deklaruar dhe fitimit të të ardhurave të krijuara nga ushtrimi i aktivitetit tregtar të babait të tij, nuk depozitoi dokumentacion justifikues ligjor, si dhe nuk provoi as plotësimin e kushteve të pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues konstaton se shpjegimet kanë mbetur në nivel deklarativ dhe, për pasojë, niveli i provueshmërisë së balancave negative të rezultuara mbetet i pandryshuar.

10.14 Nën këtë arsyetim,

- ✓ Trupi gjykues, në lidhje me këtë çështje, çmon se subjekti ka bërë deklaram të paplotë, në kuptim të pikës 1 të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

B. KONTROLLI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Ndini Tavani, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim DSIK-ja, në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar raportin nr. ***prot., datë 27.10.2017, mbi kontrollin e figurës, me të cilin Grupi i Punës, pas shqyrtimit të deklaratës së plotësuar për kontrollin e figurës nga subjekti i rivlerësimit dhe informacionit të ardhur nga institucionet e verifikimit, ka konfirmuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Ndini Tavani.

Hetimi i Komisionit

1. Me shkresën nr. ***prot., datë 16.7.2019, është kërkuar përditësimi i këtij raporti, si dhe fillimi i procedurave për deklasifikimin e tij.
2. Me shkresën nr. ***prot., datë 11.9.2019, DSIK-ja ka dërguar raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Ndini Tavani, të deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. ***, datë 11.9.2019, të KDZH-së, ku ka konstatuar se:

Në vijim të informacioneve të ardhura nga institucionet e verifikimit, në kohështrirje gjatë periudhës së rivlerësimit, rezulton se:

- Për subjektin e rivlerësimit, z. Ndini Tavani, administrohen informacione nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, kryesisht atë të “shpërdorimit të detyrës”, për shkak të detyrës së tij funksionale.
 - Në informacionet përcjellë tek instancat përgjegjëse, ndër të tjera, thuhet se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit, mund të jetë përfshirë në veprimtari të kundërligjshme në formën e “shpërdorimit të detyrës”, në lidhje me shtetasit, pjesë e një skeme, për përfitim të paligjshëm.
3. Në vlerësimin e të dhënave të ardhura pas konstatimit fillestar mbi subjektin e rivlerësimit, DSIK-ja është shprehur se gjykon se:
 - Bazuar në informacionet e ardhura merret në konsideratë dhe vlerësohet aktualiteti i të dhënave dhe fakti se mbi veprimtarinë e dyshuar të kundërligjshme të këtij prokurori janë informuar instancat përgjegjëse për trajtimin dhe shqyrtimin e rasteve të tilla.
 - Në vlerësim të të dhënave që disponohen për subjektin e rivlerësimit për përfshirjen në veprimtari të dyshuar të kundërligjshme në formën e “shpërdorimit të detyrës” për shkak të detyrës së tij funksionale, si dhe kërkesave që parashtron qëllimi dhe fryma e ligjit për një proces rivlerësimi tërësor të figurës së prokurorëve dhe gjyqtarëve, gjykon se subjekti i rivlerësimit ka tendencë për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme dhe mund të vihet nën presion nga strukturat kriminale, në përputhje me kriteret e përcaktuara në germet “b” dhe “c”, të nenit 37, të ligjit nr. 84/2016.

- Edhe pse veprimtaria e dyshuar e kundërligjshme e këtij subjekti rivlerësimi nuk gjen pasqyrim të drejtpërdrejtë në përcaktimet dhe parashikimet e ligjit nr. 84/2016, për “kontakte të papërshtatshme” me person/persona të përfshirë në krimin e organizuar, bën që kontrolli i figurës për këtë subjekt rivlerësimi, të fokusohet te vlerësimi në tërësi i integritetit të subjektit.
- Në përfundim, Grupi i Punës, nisur prej informacioneve të siguruar nga autoritetet verifikuese, ndryshon konstatimin fillestar për subjektin e rivlerësimit, z. Ndini Tavani, nga *përshtatshmëri* në *papërshtatshmëri* për vijimin e ushtrimit të detyrës.

4. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, lexoi raportin e plotë të DSIK-së pranë këtij institucioni.

5. Në vijim, Komisioni i kërkoi³⁰ Prokurorisë së Përgjithshme informacion mbi statusin aktual të procedimit penal/procedimeve penale në ngarkim të disa shtetasve të dyshuar “për krijimin e skemave mashtruese lidhur me tatimin mbi vlerën e shtuar”.

6. Prokuroria e Përgjithshme³¹ në informacionin e saj ka konfirmuar çështjet e hetuara nga subjekti i rivlerësimit dhe kërkimin e tij në përfundim të kryerjes së hetimeve.

7. Prokuroria³² pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës referon se ka regjistruar kallëzimin penal nr. ***, datë 31.5.2019, për veprën penale “zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete”, të parashikuar nga neni 295/a/3 i Kodit Penal dhe se në datën 28.6.2019, ndaj këtij kallëzimi penal është vendosur “mosfillimi i çështjes penale”. Gjithashtu, ky institucion bën me dije se ndaj këtij vendimi nuk është ushtruar ankim. Nga aktet rezulton se Prokuroria e Përgjithshme është njoftuar në datën 4.7.2019 lidhur me vendimin e mosfillimit të çështjes penale.

8. Komisioni, në analizë të dokumentacionit të administruar nga organet ligjzbatuese për të provuar vërtetësinë dhe saktësinë e konstatimit të DSIK-së, i kërkoi subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e tij, ndër të tjera, ka pretenduar se konkluzioni i Grupit të Punës është plotësisht i pavërtetë, i pabazë dhe jo ligjor.

Subjekti ka sqaruar se raporti i parë është ai i përgatitur nga i njëjti grup pune dhe me informacionet e marra nga të njëjtat autoritete ndihmuese dhe mbështetëse, në kuptim të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, raport ky i cili ka konfirmuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës. Në raportin e dytë, nr. *** prot., datë 11.9.2019, DSIK-ja konstaton “*papërshtatshmërinë*”, pra, duke bërë një ndryshim të konkluzionit nga 27.10.2017 – 11.9.2019, përmbajtja e të cilit është e njohur nga trupi gjykues, i cili në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar ka lexuar raportin e plotë pranë këtij institucioni, raport ky i cili është deklasifikuar pjesërisht po në të njëjtën ditë, 11.9.2019.

Subjekti ka pranuar reflektimin e çështjes nga Komisioni në mënyrë korrekte në rezultatet e hetimit, në dosjen e vënë në dispozicion nëpërmjet kopjes së CD-së, por edhe faktin se Komisioni ka kryer një hetim të thelluar të rastit duke kërkuar informacion mbi çështjen e hetuar pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

³⁰ Referojuni shkresës nr.***prot., datë 12.7.2019, në dosjen e Komisionit.

³¹ Referojuni shkresës nr. ***prot., datë 9.8.2019, të Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe shkresës nr. ***prot., datë 14.8.2019, të Prokurorisë së Përgjithshme, në dosjen e Komisionit.

³² Referojuni shkresës nr. 2116/4 prot., datë 4.7.2019, në dosjen e Komisionit.

Subjekti ka renditur dhe pasqyruar kronologjikisht veprimet hetimore dhe procedurale të ndjekura nga momenti i regjistrimit të procedimit penal, që përben edhe objektin e diskutimit të “dyshtar” për shpërdorim detyre dhe deri në përfundimin e gjykimit ku ky i pandehur është dënuar nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë.

Mbi të gjithë analizën e shpjeguar, subjekti ka deklaruar se:

- Procedimi penal nr. ***/2015 është realizuar me veprime të hapura, konkluduar dhe vlerësuar prej tij pasi procedimi është regjistruar në vitin 2015.
- Oficerët e policisë gjyqësore kanë kryer për një periudhë të gjatë kohe veprime të hapura hetimore si, këqyrje, pyetje personash që kanë dijeni për rrethanat e hetimit, administrim dokumentacioni, etj.
- Vepra penale e dyshuar ishte e shtrirë në kohë para fillimit të procedimit penal nr. ***.

Pretendimi lidhur me dyshime për kryerje të veprimeve të kundërligjshme me personin S. L. në këtë procedim është plotësisht i pavërtetë. Për këtë person subjekti ka deklaruar: “... *jam investuar për izolimin e tij në paraburgim që prej datës 15.1.2018, ...e duke vijuar me verifikimin e kushteve të kësaj mase sigurimi, kërkimin për rrëzimin e kërkesës për zëvendësimin e masës së sigurimit ‘arrest në burg’, e më tej në kërkimin tim si prokuror i çështjes për zgjatjen e afatit të paraburgimit në funksion të hetimeve të plota lidhur me këtë procedim penal.*”

Subjekti ka deklaruar se me këtë person nuk ka asnjë lidhje gjinie, krushqie, krahinore apo marrëdhënie shoqërore.

Subjekti ka deklaruar se në lidhje me objektin e mirëpërcaktuar dhe kufijtë e vendosur, sipas nenit DH, të Aneksit të Kushtetutës, objekti i këtij kontrolli është identifikimi i atyre subjekteve që kanë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Në rastin konkret, konstatohet qartësisht devijimi i organit mbështetës në kapërcim të hapur të kornizave ligjore, në kapërcim të kompetencave të njohura nga aktet e përmendura si më lart, në kapërcim të çdo kriteri ligjor të parashikuar për mënyrën e realizimit të kontrollit të figurës, parashikuar nga neni DH i Aneksit të Kushtetutës, neni 34 dhe 38 i ligjit nr. 84/2016, duke përcjellë informacion i cili nuk përmban asnjë nga elementet e kërkuara nga ligji, informacion të paplotë, të pabazuar mbi prova të sakta kundër frymës së ligjit për krijimin e Grupit të Punës.

Subjekti ka pretenduar se, nëse Grupi i Punës do të kishte kryer minimalisht një verifikim, do të kishte evidentuar se i gjithë hetimi është kryer nga ana ime/e subjektit me veprime të hapura dhe personat në fjalë janë ngarkuar me masë të kërkuar nga ana e tij si prokuror i çështjes. Rrjedhimisht, në mungesë të një verifikimi të plotë, DSIK-ja ka rrezikuar nxjerrjen e përfundimeve të gabuara në rëndim të pozitës së subjektit të rivlerësimit.

Vlerësimi i Komisionit

Komisioni, si organi i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të lartpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016.

Trupi gjykues, në analizë të informacionit të dhënë nga raporti i DSIK-së, shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, veprimeve hetimore të kryera prej tij lidhur me procedimin penal nr. ***, për veprat penale të parashikuara nga nenet 190 dhe 144/a të Kodit Penal, nga ku

rezultonte se për të pandehurit i kishte kërkuar gjykatës caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, përfshirë këtu edhe shtetasin S.L., për të cilin janë hedhur dyshimet mbi rolin dhe ushtrimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, çmon se veprimet e ndërmarra prej tij në aspektin ligjor kanë qenë në përputhje me kërkesat e legjislacionit penal për veprat penale për të cilat akuzoheshin të pandehurit.

Ky konstatim është në koherencë edhe me pasqyrimin e DSIK-së në raportin e saj se veprimtaria e dyshuar e kundërligjshme e këtij subjekti rivlerësimi nuk gjen pasqyrim të drejtpërdrejtë në përcaktimet dhe parashikimet e ligjit nr. 84/2016 për “kontakte të papërshtatshme” me person/persona të përfshirë në krimin e organizuar.

Në këto kushte, trupi gjykues konkludon se:

- i. në nivelin në të cilin gjenden provat e administruara nga Komisioni, më konkretisht ato të ndodhura në fashikullin penal të hetuar pranë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës;
- ii. në nivelin e shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit,

pavarësisht dyshimeve të ngritura, në përfundim nuk arriti në provueshmërinë e tyre. Në këto rrethana, trupi gjykues vlerëson se për subjektin e rivlerësimit, z. Ndini Tavani, nuk u arrit të provohet papërshtatshmëria për vijimin e ushtrimit të detyrës, dhe për rrjedhojë çmon se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Raporti mbi vlerësimin e aftësive profesionale është përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Raporti është mbështetur në: formularin e vetëdeklarimit, tri dokumentet ligjore të përzgjedhur nga subjekti i rivlerësimit, të dhëna dhe dokumente që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit, pesë dosjet gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe të dhënat nga burimet arkivore të KLP-së.

Raporti, ndër të tjera, ka analizuar:

- a) aftësitë profesionale;
- b) aftësitë organizative;
- c) etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale;
- ç) aftësitë personale dhe angazhimin profesional.

Analiza e gjetjeve³³ në këtë raport i referohet të dhënave të nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti; (ii) pesë dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; dhe (iii) të dhënat nga 23 prokuroritë e rretheve gjyqësore, Drejtorisë së Përgjimeve të Telekomunikimit dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informative dhe Zyra e Informacionit të Klasifikuar, sektori i protokoll-arkivit, si dhe burimet arkivore të sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun në Prokurorinë e Përgjithshme.

³³ Bazuar në kriteret ligjore të parashikuara nga nenet 73-76, të ligjit nr. 96/2016.

Nga raporti i Këshillit të Lartë të Prokurorisë rezulton se në tërësi për subjektin e rivlerësimit, lidhur me aftësitë profesionale dhe angazhimin personal, etikën, si dhe integritetin në ushtrim të detyrës nuk janë konstatuar problematika, ndërsa në dy dosje, nga pesë dosjet e përzgjedhura me short, janë konstatuar problematika për të cilat Komisioni ka arsyetuar gjerësisht në rivlerësimin e tij profesional, si më poshtë trajtuar.

RIVLERËSIMI PROFESIONAL

Komisioni, pas verifikimit të raportit për analizën e aftësive profesionale kryer nga KLP-ja, dhe dosjeve ku është bazuar ky raport, ka konstatuar si vijon:

Komisionit, në lidhje me pesë dosjet e shortuara, i rezultoi se:

1. Ndaj “vendimit për mosfillimin e procedimit penal nr. *** e vitit 2014”, akt i datës 24.11.2014, për veprën penale “falsifikim i dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal (që i përket dosjes nr. 1), nuk është ushtruar ankim ndaj vendimit të mosfillimit të procedimit penal nr. ***, e vitit 2014.
2. Ndaj “vendimit për pushimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2015”, datë 11.3.2015, regjistruar për veprën penale të “refuzimit për deklaram, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë”, parashikuar nga neni 257/a/1 i Kodit Penal (që i përket dosjes nr. 2), nuk është ushtruar ankim.
3. “Vendimi për pushimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2014”, datë 11.9.2014, marrë në kuadër të procedimit penal nr. ***, të regjistruar në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, (që i përket dosjes nr. 3), rezulton se i është komunikuar kallëzuesit K. L. me postë me shkresën nr. ***prot., datë 24.11.2014.
4. Ndaj “kërkesës për gjykimin e çështjes penale nr. *** të vitit 2016”, datë 20.4.2016, (që i përket dosjes nr. 4), marrë në kuadër të procedimit penal nr. ***/2016, të regjistruar në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 13.10.2016, ka pranuar kërkesën e prokurorit për deklarimin fajtor të të pandehurit E. H., duke e dënuar me 300 000 lekë gjobë.
5. Ndaj “kërkesës për gjykimin e çështjes penale nr. *** të vitit 2015”, datë 10.12.2015 (që i përket dosjes nr. 5), marrë në kuadër të procedimit penal nr. ***/2015 të regjistruar në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, gjykimi është bërë në mungesë pasi është bërë ekstradimi i tij për në Itali, sepse rezultonte se ishte në kërkim ndërkombëtar nga shteti italian për një dënim penal prej 2 vjet e 6 muaj në Itali.

Nën dritën e hetimit të plotë dhe të thelluar, megjithë zgjidhjet përfundimtare të çështjeve të sipërtrajtuara, Komisionit, në lidhje me veprimet hetimore të subjektit në dosjen nr. 2 (sikurse është shprehur edhe KLP-ja në raportin e saj) dhe në dosjen nr. 3, i rezultoi si vijon:

➤ Në lidhje me dosjen nr. 2

1. Në fashikullin që i përket procedimit penal nr. ***/2015 (për shtetasin I. K.), rezulton se subjekti i rivlerësimit në datën 10.3.2015 kishte marrë vendimin për regjistrimin e procedimit penal, me argumentimin “për të grumbulluar të dhëna të nevojshme, është e domosdoshme kryerja e veprimeve të tjera hetimore që bëjnë të nevojshëm regjistrimin e procedimit penal”.
2. Një ditë më pas, pa u kryer asnjë veprim hetimor nga aktet e administruara në fashikullin penal në datën 11.3.2015, rezultoi se nga subjekti i rivlerësimit ishte marrë vendimi për pushimin e procedimit penal.

3. Gjithashtu, u konstatua se në dosjen penale ndodhej edhe një relacion i Oficerit të Policisë Gjyqësore, i cili pasi kishte relatuar të gjithë dinamikën e kallëzimit dhe veprimeve të kryera kishte sugjeruar me të njëjtin arsyetim mosfillimin e procedimit penal.
4. Në këto kushte, Komisioni ka konstatuar dhe për këtë i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime³⁴ se:
 - Dukej sikur regjistrimi i këtij procedimi penal ishte bërë formalisht, pasi nuk ishte kryer asnjë veprim hetimor për të konkluduar në lidhje me përfundimin e hetimit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Subjekti në parashtrimet e tij ka sqaruar se:

- Kallëzimi penal i ILDKPKI-së është regjistruar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 13.1.2015.
- Dosja i është ngarkuar për kryerjen e verifikimeve Oficerit të Policisë Gjyqësore dhe sipas urdhrat të Prokurorit të Përgjithshëm vendimet e mosfillimit, kur ishte rasti, duhet të merreshin brenda një afati 30 ditor nga dita e regjistrimit të kallëzimit penal.
- Nga aktet e dosjes rezulton që verifikimet janë kryer nga Oficeri i Policisë Gjyqësore tej afatit 30 ditor dhe relacioni është përpiluar prej tij në datën 27.2.2015.
- Në këto rrethana kishte vendosur regjistrimin e procedimit dhe pushimin e tij, pasi kishte bindjen se është i bazuar në ligj dhe prova.
- Vendimi i është njoftuar kallëzuesit, ILDKPKI-së, në datën 27.3.2015, dhe nuk rezulton që ndaj tij të jetë ushtruar ankim.

Vlerësimi i Komisionit

Trupi gjykues, në analizë të fakteve të konstatuara në vendimin e pushimit të procedimit penal, të provave të administruara në fashikullin hetimor, si dhe të shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, vëren se subjekti me parashtrimet e tij pretendon për veprime të kryera në tejkallim të afateve procedurale nga Oficeri i Policisë Gjyqësore, të cilat sipas tij kanë passjellë legjitimitimin e kryerjes së veprimeve të tij procedurale por edhe vendimmarrëse, brenda harkut kohor prej dy ditësh. Trupi gjykues ka konstatuar se veprimet apo aktet e ndërmarrja nga subjekti nga përbërja substanciale nuk përputhen dhe se njëri prej tyre, konkretisht vendimi për regjistrimin e procedimit penal, ka mbetur i pavlerë për sa kohë në zbatim të tij nuk janë ndërmarrë detyrat e lëna, konkretisht grumbullimi i disa të dhënave në favor të hetimit.

Pra, subjekti i rivlerësimit ndërsa ka vlerësuar regjistrimin e procedimit penal me arsyetim për grumbullimin e disa të dhënave, pa u realizuar ky qëllim, ka legjitimuar vetëm një ditë më pas me vendimmarrje “pushimin e çështjes”, vendim në të cilin minimalisht do të duhej të kishte arsyetuar se përse erdhi ndërmarrja e një akti të shpejtë.

Edhe sikur të merret i mirëqenë shpjegimi i subjektit do të duhej që së paku ai të ishte cituar i argumentuar në vendimmarrjen e pushimit të çështjes penale. Është mjaft e rëndësishme që akti procedural të jetë i qartë dhe i mirëargumentuar, si një element apo matës i cilësisë dhe profesionalizmit ndaj çdo subjekti rivlerësimi.

Në referencë të legjislacionit që ndikon në vlerësimin e aftësive profesionale, rast pas rasti, trupi gjykues, në vlerësimin e kësaj çështjeje penale, arsyeton duke marrë në konsideratë përmbushjen e kërkesave të ligjit të aplikueshëm nr. 96/2016, *neni 73/ Aftësitë profesionale të*

³⁴ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

prokurorit 1. Vlerësimi i aftësive profesionale të prokurorit përfshin njohuritë ligjore dhe të arsytimit ligjor. 2. Aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e prokurorit për të hetuar dhe për të marrë urdhra dhe vendime, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën. 3. Aspekti i arsytimit ligjor të prokurorëve në marrjen e vendimeve dhe veprimeve hetimore vlerësohet duke u bazuar në tregues të tillë si, qartësia dhe kuptueshmëria e akteve të prokurorisë, struktura e qëndrueshme dhe e mirorganizuar e akteve të prokurorisë, aftësia për të marrë në pyetje dhe cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik të prokurorit.

- Për sa më sipër, trupi gjykues çmon se në çështjen penale, objekt i hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit nuk i ka kushtuar rëndësinë e duhur analizimit dhe argumentimit të vendimit të pushimit të çështjes, dalë pas një vendimi për të cilin vetë subjekti kishte lënë detyrë për t'u përmbushur, por që nuk rezultoi i tillë.

➤ **Në lidhje me dosjen nr. 3**

1. Komisionit, gjatë hetimit administrativ, krahas përshkrimit të kësaj çështjeje në raportin profesional, si një ndër dosjet e shortuara, i ka rezultuar se kallëzuesi, K. L., ka depozituar edhe dy denoncime³⁵, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016. Parë në këtë këndvështrim është vlerësuar se rasti kërkon hetim të thelluar, objektiv dhe pritshmëri në rezultate konkrete mbi veprimet procedurale dhe hetimore të ndërmarra nga subjekti i rivlerësimit.
2. Në vijim, nga shqyrtimi i akteve të procedimit penal nr. *** të vitit 2014, për të cilën ka rezultuar se subjekti ka marrë vendimin për pushimin e procedimit penal në datën 11.9.2014, sikurse është shprehur edhe KLP-ja në raportin e vlerësimit profesional të subjektit, por edhe të denoncimeve, rezultoi si vijon:
 - Procedimi penal i hetuar nga subjekti i rivlerësimit është pasojë e vendimit të ndarjes së çështjes penale në ngarkim të tri të pandehurve, përkatësisht I.A., E.H. me detyrë notere dhe L. K. me detyrë notere, pasi për këtë të fundit drejtuesi i prokurorisë ka veçuar hetimin. Më konkretisht, është vendosur që për shtetasen L. K. të vijojnë hetimet, ndërsa për dy të akuzuarit e tjerë çështja t'i drejtohet organit të gjyqësorit.
 - Në këtë kontekst, subjekti i rivlerësimit në të njëjtën datë të veçimit të çështjes nr. ***, në datën 14.03.2014, ka vendosur zgjatjen e hetimeve nga data 14.3.2014 deri më 14.6.2013, me arsyetimin se duhen kryer disa veprime hetimore të cilat janë cituar edhe në vendimin e drejtuesit të organit të prokurorisë, për ndarjen e çështjes. Më konkretisht, zgjatja e hetimeve është ndërmarrë për të thirrur z. K. L., i cili në procedimin penal mban cilësinë e kallëzuesit, si dhe për të administruar dokumentacionin që është përdorur nga personat për identifikimin para noterit për përpilimin e akteve objekt hetimi, etj.
 - Nga aktet e administruara rezulton se ndryshe nga se është arsyetuar në vendimin e zgjatjes së hetimeve (datë 14.3.2014) për të pyetur shtetasin K. L., nga subjekti i rivlerësimit në periudhën 3-mujore, thuajse në përfundim të saj, në datën 3.6.2016 është pyetur në cilësinë e të pandehurës shtetasja L. K., me detyrë notere.
 - Pas këtij veprimi hetimor nuk rezulton që subjekti të ketë kryer veprim tjetër hetimor, por rezulton se në datën 14.6.2014 ka zgjatur sërish kryerjen e hetimeve deri në datën

³⁵ Nr. *** prot., datë 4.1.2018 dhe nr. *** prot., datë 8.2.2018, në dosjen e Komisionit.

14.9.2014, me të njëjtin arsyetim të bërë si në vendimin e parë të zgjatjes së hetimeve, për të pyetur shtetasin K.L.(me cilësinë e kallëzuesit), por edhe shtetasin I.A., çështja e të cilit, sipas akteve, kishte kaluar për gjykim pranë organeve të gjyqësorit me cilësinë e të pandehurit.

- Nga aktet rezulton se Oficeri i Policisë Gjyqësore (E. H.) në datën 21.6.2014 ka pyetur shtetasin K. L. me cilësinë e personit që ka dijeni për rrethanat e hetimit.
- Nuk rezulton që të jetë pyetur shtetasi I. A., sikurse subjekti ka arsyetuar, në vendimin e dytë të zgjatjes së hetimeve, si edhe nuk rezulton që të ketë arsyetuar në ndonjë akt mbi mos marrjen në pyetje të këtij shtetasi.
- Megjithëse hetimet janë shtyrë me gjashtë muaj, megjithëse ka pasur aktekspertime të kryera më parë ku dhe është konkluduar mbi kryerjen e falsifikimit nga shtetasja L. K. me detyrë notere, përsëri është vendosur pushimi i procedimit penal në ngarkim të saj.

Trupi gjykues, për të gjithë konstatimet sa më sipër, i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime³⁶.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Subjekti në parashtrimet e tij ka sqaruar se vendimi i pushimit të këtij procedimi penal (pas rileximit të akteve) është marrë pas analizës së akteve që ndodheshin në dosje dhe vlerës së dhënë provave dhe akteve prej tij si prokuror i çështjes.

Lidhur me mosarsyetim me akt të shkruar të mosmarrjes në pyetje të një shtetasi, subjekti sqaron se pavarësisht detyrave të lëna për oficerët e policisë gjyqësore (oficeri ka qenë i seksionit të prokurorisë), çështjet si rregull, në përgjithësi me këta oficerë, janë ndjekur në dinamikë dhe në kohë, dhe referuar vendimit të pushimit të procedimit që pyetja e personit të mos ndikonte në rezultatin e përfundimit të çështjes.

Nga aktet e dosjes rezulton se ankuesi K. L. është njoftuar nga ana e subjektit si prokuror i çështjes, me shkresën nr***, datë 24.11.2014, për vendimin e pushimit, dhe që nga ajo ditë e deri aktualisht, subjekti nuk i rezulton të jetë ankimuar vendimi i pushimit nga K. L. si person i interesuar për çështjen.

Subjekti sqaron gjithashtu edhe se nisur nga ngarkesa e madhe e punës së tij si prokuror në vite dhe natyra e çështjeve të hetuara prej tij, mundet që vendimi për zgjatjen e afatit të hetimeve të jetë përpiluar në mënyrë që aktet të ishin të vlefshme proceduralisht dhe vendimmarrja të kryhej brenda afateve ligjore.

Vlerësimi i Komisionit

Trupi gjykues në analizë të fakteve të konstatuara gjatë hetimit administrativ, provave të fashikullit hetimor dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, konstaton se:

1. Subjekti nuk ka arritur të arsyetojë thelbësisht rreth gjetjeve konkrete, por synon të provojë përmbushjen e rolit të tij në hetimet e kryera, me faktin se vendimmarrja e tij ka qenë e drejtë për sa kohë ajo nuk është ankimuar.
2. Lënia në fuqi e një vendimmarrjeje padyshim është pjesë përbërëse e vlerësimit të një subjekti rivlerësimi nga njëra anë, por nga ana tjetër zbatimi i procedurës në një çështje hetimore është gjithashtu jo vetëm i rëndësishëm nga pikëpamja procedurale, por është edhe një ndër treguesit profesional në ushtrimin e detyrës së prokurorit.

³⁶ Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

3. Subjekti nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm se përse ka zgjatur hetimet dy herë nga tre muaj. Subjekti nuk ka argumentuar në asnjë prej akteve të tij mbi përmbushjen e kërkesave të nenit 324³⁷ të Kodit të Procedurës Penale, sepse rasti kishte qenë kompleks, ose sepse gjendej në pamundësi objektive për t'i përfunduar hetimet brenda afatit të zgjatur.
4. Subjekti nuk arriti të provojë bindshëm se cilat ishin arsyet e mospërmbushjes së detyrës së lënë nga eprori i tij në vendimin e veçimit të çështjes së ngarkuar, më konkretisht, subjekti nuk provoi dhe as ka arsyetuar në vendimin e dytë të zgjatjes së hetimeve se përse nuk thirri në vendimmarrjen e parë të zgjatjes së hetimeve, me cilësinë e dëshmitarit, kallëzuesin shtetasin K.L., por kishte thirrur noteren e cila akuzohej në këtë çështje në mënyrë të drejtpërdrejtë për falsifikim të dokumenteve në disfavor të kallëzuesit, me pasoja cenim pronësie.
5. Subjekti ka anashkaluar të japë shpjegime se cilat ishin arsyet apo rrethanat që e çuan në mosmarrjen në konsideratë të të gjithë provave për të cilat prokurori i mëparshëm i çështjes kishte çmuar dërgimin për gjykim me cilësinë e të pandehurës edhe shtetasen L.K. me detyrë notere, pasi kishte arritur në provueshmërinë e falsifikimit të dokumenteve, apo minimalisht të shpjegonte se përse nuk kishte arsyetuar gjerësisht mbi këtë situatë e cila do të qartësonte vendimmarrjen e pushimit të një çështjeje të ndërlikuar.
6. Subjekti në arsyetimin e vendimit të pushimit nuk ka analizuar dhe arsyetuar me argumente se përse nuk thirri ashtu sikurse kishte vendosur për të dytën herë të zgjaste afatin e hetimit, në cilësinë e personit që kishte dijani për veprën penale dhe që ishte dërguar për gjykim me cilësinë e të pandehurit nga prokurori i mëparshëm, shtetasin I.A. .

Në funksion të përmbushjes së kërkesave të ligjit të zbatueshëm në këtë rast, nr. 96/2016, i aplikueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale, neni 73 - Aftësitë profesionale të prokurorit, ku citohet shprehimisht:

“1. Vlerësimi i aftësive profesionale të prokurorit përfshin njohuritë ligjore dhe të arsyetimit ligjor.

2. Aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e prokurorit për të hetuar dhe për të marrë urdhra dhe vendime, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën.

3. Aspekti i arsyetimit ligjor të prokurorëve, në marrjen e vendimeve dhe veprimeve hetimore, vlerësohet duke u bazuar në tregues të tillë si qartësia dhe kuptueshmëria e akteve të prokurorisë, struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e akteve të prokurorisë, aftësia për të marrë në pyetje dhe cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik të prokurorit”.

Neni 74 aftësitë organizative

“4. Në rastin e prokurorit, aftësia e prokurorit për të kryer në mënyrë të efektshme procedura hetimore dhe procedura të tjera të sistemit të prokurorisë matet duke u bazuar në treguesit e kryerjes së veprimeve të nevojshme hetimore dhe procedurale brenda afatit kohor të përcaktuar, të mbledhjes së provave të nevojshme, duke përfshirë mbikëqyrjen e dërgimit pa vonesë të akteve të nevojshme të njoftimit.”

³⁷ Neni 324: Zgjatja e afatit (shtuar një paragraf në pikën “2” me ligjin nr. 8460, datë 11.2.1999; shtuar fjali në pikën 1, ndryshuar fjalia e dytë në pikën 2 dhe pika 4, me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017) 1. Prokurori mund ta zgjasë afatin e hetimeve për një kohë deri në tre muaj... 2. Zgjatje të mëtejshme, secila për një kohë jo më shumë se tre muaj, mund të bëhen nga prokurori në rastet e hetimeve komplekse ose të pamundësisë objektive për t'i përfunduar ato brenda afatit të zgjatur. ... 3. Vendimi për zgjatjen e afatit të hetimeve u njoftohet të pandehurit dhe viktimës...

Neni 75/ etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale.

*“5. Integriteti i magistratit në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi ose presioni të jashtëm, matet duke u bazuar në tregues të tillë si rezultati i ankesave dhe verifikimi i tyre ... por edhe të kritereve të përcaktuara në rregulloren për sistemin e vlerësimit të punës dhe të aftësive profesionale e morale të prokurorëve, miratuar me urdhrin nr. ***, datë 11.12.2012, të Prokurorit të Përgjithshëm, ku përveç kritereve dhe kërkesave të përcaktuara si bazë vlerësimi i aftësive të subjektit të rivlerësimit, janë parashikuar edhe rastet se kur kemi të bëjmë me procedime penale komplekse, si dhe faktorët që i bëjnë të tillë ato, vlerësohet se nuk gjen vend zgjatja e afateve të hetimit të çështjes penale, objekt i këtij hetimi administrativ, dhe për pasojë mbetet tërësisht e paprovuar koha e gjatë e mbajtjes së çështjes nën hetim duke mos pasqyruar efektivitet në zgjidhjen e saj brenda një afati të arsyeshëm që korrespondon me një ndër kriteret e vlerësimit të punës së prokurorit, atë të shpejtësisë në hetimet penale”.*

Në përfundim,

- Trupi gjykues, në konstatim të fakteve se subjekti nuk ka arsyetuar dhe argumentuar veprimet dhe mosveprimet hetimore, për të konkluduar në një vendim të qartë, të thelluar dhe të analizuar mbi bazën e akteve të administruara në dosjen hetimore, çmon se subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kundërshtim me parashikimin e bërë në nenin 324 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe kërkesat e ligjit nr. 96/2016.
 - **Në lidhje me procedime penale të mosfilluara**, pushuara apo pezulluara nga prokuroritë e rretheve gjyqësore, Prokuroria për Krime të Rënda dhe Prokuroria e Përgjithshme, sikurse thuhej edhe në raportin e vlerësimit profesional, rezulton të ketë pasur dy materiale procedurale, për të cilat Komisionit i ka rezultuar se:
 1. Për kallëzimin penal nr***, datë 26.3.2013, të shtetasit G. Sh. ndaj subjektit të rivlerësimit për veprën penale “shpërdorim detyre”, për të cilën Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier ka vendosur mosfillimin e procedimit penal nr. ***, në datën 26.3.2013, nuk është ushtruar ankim.
 2. Për procedimin penal të regjistruar në datën 19.1.2018 për veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, pa emër, çështje e hetuar nga Prokuroria e Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë, Komisionit i ka rezultuar se çështja është ende nën hetim për shkak të kthimit të akteve nga organi i gjyqësorit për hetime të mëtejshme.

Komisionit, pas verifikimit të ankesave të depozituara nga shtetas të ndryshëm në cilësinë e kallëzuesve ndaj subjektit të rivlerësimit, të përshkruara në raportin e vlerësimit profesional, nuk i kanë rezultuar problematika për shkak se praktikat e trajtuara rezultojnë me kthim përgjigje, me vendimmarrje të organit të gjyqësorit, në të njëjtën mënyrë sikurse ka vepruar subjekti i rivlerësimit me vendimmarrje që vijnë të jenë në shqyrtim nga organet e gjyqësorit, apo edhe me vendimmarrje të cilat nuk i përkasin subjektit të rivlerësimit, përfshirë këtu edhe praktikën nr. *** e vitit 2018. Kjo e fundit i përkiste shtetasit A. S., për të cilën subjekti, pasi i është lënë të japë shpjegime mbi ankimin e bërë ndaj vendimit të pushimit të procedimit penal nr. *** të dhënë prej tij, ka rezultuar se:

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në datën 8.5.2018 ka vendosur të shfuqizojë vendimin e dhënë nga subjekti ndaj procedimit penal të sipërcituar dhe kthimin e akteve, duke lënë si detyrë kryerjen e disa veprimeve të tjera hetimore, vendim i cili sipas vërtetimit datë

31.7.2019, të po kësaj gjykate, pas ankimit të ushtruar nga subjekti i rivlerësimit është dërguar në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe se ende (deri në ditën e vërtetimit) ndodhej pranë asaj gjykate.

➤ **Mbi denoncimet e paraqitura pranë Komisionit për subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016**

Pranë Komisionit u paraqitën 31 denoncime³⁸ nga shtetas të ndryshëm.

➔ Lidhur me vërtetësinë e fakteve dhe rrethanave të pasqyruara në përmbajtje të denoncimeve Komisioni kreu hetim të zgjeruar.

Së pari, Komisioni gjatë verifikimit të denoncimeve konstatoi se në rastet (siç pasqyrohet më sipër) kur denoncuesi kishte depozituar më shumë se një denoncim, në përmbajtje trajtohej i njëjti objekt ankimi.

Për një hetim objektiv, pasojat e të cilit ndikojnë³⁹ në përmbushjen me korrektësi dhe profesionalizëm të funksionit të subjektit të rivlerësimit, Komisioni i kërkoi një raport të specializuar edhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, duke i vënë në dispozicion denoncimet përkatëse pas të cilit ky i fundit dërgoi raportin e parë⁴⁰, si dhe një raport⁴¹ shtesë mbi to.

Në vijim, trupi gjykues, pas analizimit të dy raporteve të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të të gjithë dokumentacionit mbështetës të depozituar, jo vetëm nga ky i fundit, por edhe nga denoncuesit, *ka konstatuar se nga 31 denoncimet, 16⁴² prej tyre nuk përmbanin fakte apo rrethana që mund të përbënin prova në lidhje me kriterin e vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit.*

Ndërsa, për gjashtë denoncimet e shtetasit F. D., nga analizimi i përmbajtjes së tyre, rezultoi se pesë denoncime kishin të njëjtin objekt ankimi. Më konkretisht, në pesë denoncime vërehej se shtetasi F. D. kishte kallëzuar për shpërdorim detyre subjektin e rivlerësimit nën pretendimin për moskryerje të veprimeve të duhura hetimore në procedimin penal nr. ***prot., datë 9.4.2019, procedim që lidhej me procedimin penal nr. ***të vitit 2018. Kallëzimi i shtetasit F. D. rezultoi ende në hetim në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë.

Trupi gjykues, pas analizimit të parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit në prapësime lidhur me themelin e procedimit penal të hetuar prej tij, shkak i të cilit ishte bërë kallëzimi i shtetasit F. D., por edhe verifikimit të dokumentacionit të administruar në dosje, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit, pas kryerjes së veprimeve hetimore ndaj këtij shtetasi, kishte kërkuar masën e arrestit me burg dhe në vijim edhe masën e dënimit për veprat penale të korrupsionit aktiv të gjyqtarit ose prokurorit.

³⁸ Një denoncim është depozituar nga shtetasi V. B.C.; dy denoncime janë depozituar nga shtetasi V. A.Q.; gjashtë denoncime janë depozituar nga shtetasi F. D.; një denoncim është depozituar nga shoqëria "****" sh.p.k., me administrator A. A.; tri denoncime janë depozituar nga shtetasi V.Ç.; një denoncim i depozituar nga shtetasja L. H. S.; tri denoncime janë depozituar nga shtetasi E. Q.S.; dy denoncime janë depozituar nga shtetasi F.R. O.; dy denoncime janë depozituar nga shtetasi E. B.; dy denoncime janë depozituar nga shtetasi A.Z.; një denoncim është depozituar nga shtetasi I. Z.S.; dy denoncime janë depozituar nga shtetasi K. L.; një denoncim është depozituar nga shtetasi A.K.; një denoncim është depozituar nga shtetasi A.R. një denoncim është depozituar nga shtetasi F. K.; një denoncim është depozituar nga shtetasi S. Z.; një denoncim është depozituar nga shtetasja F. B..

³⁹ Referencë, vendimi nr. 21, datë 13.9.2019, i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, <http://kpa.al/ep-content/uploads/2019/11/Vendimi-G-Medja-i-anonimizuar-per-web.pdf>, fq. nr. 60, pika 26.1.1.

⁴⁰ Referojuni informacionit të dhënë bashkëngjitur shkresës nr. *** prot., datë 21.6.2019, të KLP-së, në dosjen e Komisionit.

⁴¹ Referojuni informacionit të ardhur me shkresën nr*** prot., datë 30.7.2019, në dosjen e Komisionit.

⁴² Të depozituara përkatësisht: dy nga shtetasja V. Q.; një nga shtetasja L. S.; dy nga shtetasi F. O. tre nga shtetasi V. Ç.; dy nga shtetasi E.B.; dy nga shtetasi A. Z.; një nga shtetasi A. K.; një nga shtetasi F.K.; një nga shtetasi S. Z. dhe një nga shoqëria "****" sh.p.k., me administrator z. A. A..

Trupi gjykues, duke konsideruar nga njëra anë faktin se vendimmarrjet gjyqësore provojnë hetimin e plotë nga subjekti i rivlerësimit ndaj të akuzuarit dhe të dënuarit F. D., dhe nga ana tjetër faktin që kallëzimi penal i po këtij shtetasi bërë ndaj subjektit të rivlerësimit, rezulton të jetë ende nën hetim, nuk arriti të krijojë dyshime të arsyeshme mbi mospërbushjen e detyrave dhe përgjegjësive të ushtruara nga subjekti lidhur me çështjen penale për të cilën akuzohet dhe për rrjedhojë, nuk arriti të krijojë dyshime edhe lidhur me nivelin e provueshmërisë së përmbajtjes së denoncimit.

Për sa i përket denoncimit të gjashtë, të shtetasit F. D., trupi gjykues konstatoi se në përmbajtje të denoncimit të tij ky shtetas pasqyronte dhe pretendonte për çështje⁴³ (që nuk kanë pasur lidhje me denoncuesin) të hetuara nga subjekti i rivlerësimit, që sipas tij rezultonin problematike në drejtim të ushtrimit të kompetencave ligjore nga subjekti. Në lidhje me këto denoncime, trupit gjykues, sikurse është shprehur edhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë në raportin shtesë të tij, në analizë të vendimeve⁴⁴ gjyqësore të dhëna për çështjet penale të hetuara nga subjekti i rivlerësimit, në tërësi i rezultoi se pretendimet e denoncuesit nuk qëndronin, pasi proceset hetimore ishin ndjekur në gjykata pas dërgimit për gjykim nga ana e subjektit të rivlerësimit dhe se vendimmarrjet e organit gjyqësor për këto raste, nuk mund të jenë më objekt i vlerësimit për subjektin dhe se për një rast⁴⁵ çështja ishte ende nën hetim e për pasojë ajo nuk mund të trajtohej.

Gjithashtu, trupi gjykues pas analizimit të parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit ndaj denoncimit të shtetasit F. B., e cila pretendonte për shkelje procedurale të kryera nga subjekti gjatë hetimit të çështjes penale në ngarkim të saj dhe dokumentacionit të depozituar nga kjo shtetase, në tërësi nuk konstatoi problematika.

Trupit gjykues, nga analizimi i denoncimit të shtetasit A. R., tri denoncimeve të shtetasit E.S., denoncimit të shtetasit V. Ç., denoncimit të shtetasit I.S., nga analizimi i dokumentacionit shoqëruar, si dhe nga raporti i Këshillit të Lartë Gjyqësor, i rezultuan problematika të cilat lidhen ngushtësisht me përmbushjen e detyrave thelbësore të funksionit të prokurorit në drejtim të një hetimi të gjithanshëm, të plotë, profesional, efektiv në kohë, por edhe të vlerësuara në kuadër të interesit publik.

➤ **Në lidhje me denoncimin e shtetasit A. R.**

Referuar ankesës, me objekt “*Ankim për veprimet e prokurorëve z. N.T. dhe z. Ndini Tavani dhe gjykatësit L.S., K. V. për gjykimin e çështjes nr. ***regj. Them, datë regj. 15.2.2016 dhe nr. ***vendimi, datë 8.6.2017. Në ankimin e tij denoncuesi parashtron rrethanat e çështjes penale nr. *** të vitit 2017.*”

Nga studimi i fashikullit⁴⁶ Komisionit i ka rezultuar se: Denoncuesi ka depozituar, krahas një kallëzimi të mëparshëm, që nuk ka rezultuar të ketë qenë objekt i punës së subjektit të

⁴³ Në lidhje me pushimin e procedimit penal nga subjekti i rivlerësimit, për çështjen e byzylykëve elektronikë që përdoren për të dënuarit, prokurori Ndini Tavani pushoi hetimet edhe ndaj mjekut të Sanatoriumit F.Ç., pavarësisht se ky i fundit shfaqej në kamerën e fshehtë të emisionit “STOP”; prokurori Ndini Tavani ka pasur në hetim biznesmenin e njohur R.T.; vjedhja e shekullit në Bankën e Shqipërisë, shtetin në humbje e përfaqësoi prokurori Ndini Tavani; në dosjen voluminoze CEZ prokurori Ndini Tavani ka drejtuar ose po drejton hetimet për këtë çështje shumë të përfolur.; prokurori Ndini Tavani ka fshehur dhe nuk ka hetuar kallëzimin penal të shtetasit J.P. ... (rasti është i njëjtë me denoncimin e parë të shtetasit F. D., të sipërrajtuar, për të cilin i është kërkuar të japë shpjegime).

⁴⁴ Vendimi nr*** regj. them., datë 27.4.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; vendimi nr. **, datë 22.12.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me të pandehur R. T., i akuzuar për veprën penale “mospagim të taksave dhe tatimeve”, parashikuar nga neni 181 i Kodit Penal; vendimi nr. **, datë 12.10.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të pandehur A. F., i akuzuar për veprën penale “shpërdorim detyrë”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

⁴⁵ Në lidhje me dosjen voluminoze CEZ, dosja penale është ende në hetim dhe nuk ka një vendim përfundimtar në lidhje me të.

⁴⁶ Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me shkresën nr***prot., datë 11.6.2019, ka dërguar një kopje të fashikullit penal nr. *** i vitit 2008, të njehsuar me origjinalin.

rivlerësimit, një tjetër kallëzim për veprën penale “falsifikim të dokumenteve”, me pretendimin se pasi gjatë gjykimit të çështjes me të pandehur Gj. Ç., është konstatuar se njëri nga ekspertët e thirrur nga gjykata nuk ka qenë në Shqipëri në momentin kur është bërë ekspertimi i të dëmtuarit A.R. (djali të denoncuesit). Në këto kushte është regjistruar procedimi penal nr. *** i vitit 2017, procedim i cili i ka rënë në short prokurorit Ndini Tavani.

Pas kryerjes së një sërë veprimesh hetimore, prokurori ka marrë vendimin për t’iu drejtuar gjykatës me kërkesë për pushimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2017, në janar të vitit 2018. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me gjyqtar K. V., me vendimin nr. ***, datë 26.2.2018 ka pranuar kërkesën e prokurorisë për pushimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2017.

Ky vendim është ankimuar dhe me vendimin nr. ***, datë 30.4.2018, dhe Gjykata e Apelit Tiranë ka prishur vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe e ka kthyer për hetime të mëtejshme procedimin penal nr. ***, me arsyetimin se nga akuza nuk janë respektuar dispozitat e nenit 58 të Kodit të Procedurës Penale, për komunikimin e të dëmtuarit në lidhje me rezultatin e hetimeve.

Pas kryerjes së njoftimit të kallëzuesit me rezultatin e hetimeve, prokurori ka proceduar sërish me kërkesën për pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. *** të vitit 2017.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 8.10.2018, ka vendosur kthimin e akteve të hetimeve paraprake të procedimit penal nr. *** të vitit 2017, për kryerjen e hetimeve të plota sikundër përcaktohet në arsyetimin e vendimit, duke i caktuar prokurorisë një afat prej 60 ditë, nga dita që ky vendim të marrë formë të prerë. Ndaj këtij vendimi është bërë ankim dhe Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 21.11.2018, ka vendosur “lënien në fuqi të vendimi nr. ***, datë 8.10.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”.

Në datën 21.3.2019 prokurori ka urdhëruar kryerjen e veprimeve hetimore në zbatim të vendimit të Oficerit të Policisë Gjyqësore pranë Drejtorisë së Policisë Tiranë, z. Gj. N. . Në datën 16.5.2019, me shkresën nr. *** prot., është dërguar fashikulli penal i *përfunduar*.

Në dosjen hetimore ndodhet edhe një kërkesë drejtuar drejtuesit të prokurorisë, znj. E.I., për përjashtimin e prokurorit Ndini Tavani dhe të Oficerit të Policisë Gjyqësore, Gj. N., nga hetimi i çështjes penale nr. *** të vitit 2017, por nuk konstatohet marrja e një vendimi prej saj në lidhje me këtë kërkesë.

Procedimi penal nr***i vitit 2017, për të cilin është bërë ankesë nga shtetasi A. R., është ende në hetim dhe ka rezultuar ende pa vendimmarrje deri në datën 11.6.2019.

Komisioni, bazuar në nenin E, të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 73, të ligjit nr. 96/2016, për vlerësimin profesional, për sa më sipër ka konstatuar dhe për pasojë i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime⁴⁷, pasi:

- Dukej se subjekti nuk kishte njoftuar palën e dëmtuar dhe nuk kishte kryer hetime të plota për rastin, veprime këto të konstatuara dhe të lëna në fuqi nga gjykatat.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Subjekti, ndër të tjera, në parashtrimet e tij ka shpjeguar se:

⁴⁷ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

- Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë ka referuar në datën 6.11.2017 materialin hetimor në lidhje me kallëzimin e shtetasit A.R. .
- Kallëzimi është regjistruar me nr. ***, datë 7.11.2017.
- Sipas shortit manual të datës 7.11.2017, subjekti është shortuar si prokuror për ndjekjen e këtij materiali hetimor.
- Sipas urdhrorit të regjistrimit të datës 13.11.2017, subjekti ka vendosur regjistrimin e procedimit penal me nr. ***.
- Në përfundim të hetimeve paraprake është përpiluar relacioni i Oficerit të Policisë Gjyqësore, duke sugjeruar pushimin e procedimit penal.
- Në datën 28.12.2017 është përpiluar kërkesa për pushimin e procedimit, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. *** regj. them., datë 26.2.2018, ka vendosur pranimin e kërkesës dhe pushimin e procedimit penal nr. 9307/2017.
- Mbi ankimin e kallëzuesit, me vendimin nr. *** regj. them., datë 30.4.2018, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. ***regj., datë 26.2.2018 dhe kthimin e akteve.
- Sipas vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, ndryshimi i vendimit nr. ***, datë 26.2.2018, është vendosur për shkak të mosnjoftimit të kallëzuesit për përfundimin e hetimeve dhe detyrimin e organit të akuzës për të njoftuar viktimën për përfundimin e hetimeve.

Nga aktet e fashikullit të hetimit të procedimit penal rezulton se gjetja e Gjykatës së Apelit Tiranë nuk qëndron dhe është e pavërtetë, pasi në aktet e procedimit (f. 89, 90, 91) ndodhet njoftimi i përfundimit të hetimeve kundrejt nënshkrimit të shtetasit A.R. (kallëzuesi).

Pas vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, si prokuror i çështjes subjekti ka urdhëruar në datën 7.7.2018, sipas shkresës nr. *** (f. 29 e fashikullit të hetimit) për t'i njoftuar dhe bërë me dije kallëzuesit kërkesën për pushimin e procedimit penal. Në faqen 5 të këtij fashikulli ndodhet shënimi me shkrimin dhe nënshkrimin e shtetasit A. R. .

Gjykata e Apelit Tiranë në vendimin e saj me nr***, datë 30.4.2018, nuk ka përcaktuar asnjë detyrë për prokurorinë, por ka prishur vendimin nr***, datë 26.2.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, duke "sajuar" mungesën e njoftimit të përfundimit të hetimeve për kallëzuesin (viktimën) në një kohë që siç e ka sqaruar edhe më sipër, ky njoftim është kryer dhe ndodhet në faqet 89, 90 dhe 91 të fashikullit të hetimit.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. *** regj., datë 8.10.2018, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr***, datë 21.11.2018, ka vendosur kthimin e akteve të hetimeve paraprake për këtë procedim penal Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Si detyra për prokurorinë nga gjykata e shkallës së parë janë përcaktuar:

- të pyetet kallëzuesi;
- të pyetet përfaqësuesi i kallëzuesit;
- t'i kërkohen dokumente dhe prova që i shërbejnë hetimit.

Subjekti ka shprehur bindjen se pavarësisht parashikimeve ligjore për detyrueshmërinë e kryerjes së veprimeve hetimore të lëna si detyrë nga gjykata në një vendim të saj, këto veprime konkrete janë lënë vetëm për shkak të mospranimit të kërkesës për pushimin e çështjes dhe në vlerësimin e tij si prokuror nuk do të sillnin risi në hetimin e kësaj çështjeje.

Subjekti ka parashtuar disa fakte:

- në f. 17 të dosjes ndodhet kallëzimi i shtetasit A.R., në të cilën nuk është përshkruar pretendimi i tij në lidhje me veprimet dhe mosveprimet e të kallëzuarve;
- shtetasi A. R. është pyetur në datën 31.10.2017;
- shtetasi A. R. është pyetur në datën 31.10.2017;
- në përfundim të hetimeve (f. 89, 90, 91) kallëzuesi është njohur me përfundimin e hetimeve.
- shtetasi A. R., në datën 9.7.2018, është njohur me përfundimin e hetimeve dhe ka shprehur mosdakordësinë mbi mënyrën e përfundimit të hetimeve.

Subjekti ka citur se: *“...pas kthimit të dosjes nga Gjykata e Apelit Tiranë, si prokuror i çështjes kam ngarkuar Oficerin e Policisë Gjyqësore për kryerjen e veprimeve të urdhëruara nga gjykata. Në datën 16.5.2019, dosja është kthyer pa veprime nga drejtoria vendore e Policisë Tiranë. Në datën 10.4.2019 në organin procedues është administruar një kërkesë e përsëritur e shtetasit A. R. për zëvendësimin e prokurorit të çështjes dhe Oficerit të Policisë Gjyqësore. Me vendimin e datës 2.9.2019 kam vendosur zëvendësimin e Oficerit të Policisë Gjyqësore dhe referuar vendimit të gjykatës kam urdhëruar dhe ndryshimin e cilësimit juridik, duke vazhduar hetimet për veprën penale të ekspertimit të rremë sipas nenit 309 të Kodit Penal.”*

Gjithashtu, subjekti ka sqaruar se çështja është ende në hetim dhe se ka bindjen e bazuar në ligj se nuk ka asnjë rrethanë objektive apo subjektive për të hequr dorë nga hetimet e këtij procedimi penal. Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës subjekti kërkon të konsiderohet fakti që kjo çështje është në shqyrtim në fazën e hetimeve.

Vlerësimi i Komisionit

Trupi gjykues, në analizë të përmbajtjes së denoncimit, akteve të administruara në fashikullin penal dhe parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit, çmon se qëndron pretendimi i subjektit lidhur me kthimin e akteve të çështjes penale nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. ***regj. them., datë 30.4.2018, për shkak të mungesës së njoftimit të përfundimit të hetimeve për kallëzuesin (viktimën), pasi nga aktet rezulton, sikurse është shprehur edhe subjekti, se njoftimi është kryer dhe se ky fakt pasqyrohet në faqet 89, 90 dhe 91 të fashikullit të hetimit.

Por nga ana tjetër, trupi gjykues çmon se nuk qëndron pretendimi tjetër i subjektit të rivlerësimit lidhur me kthimin për të dytën herë të akteve si nga Gjykata e Shkallës së Parë dhe po ashtu edhe nga ajo e Apelit, ku ndër të tjera është lënë detyrë që krahas pyetjes për kallëzuesin dhe përfaqësuesin e tij të merren edhe dokumente dhe prova që i shërbejnë hetimit. Subjekti, në parashtrimet e tij nuk ka dhënë asnjë argument nëse në hetimet e kryera pas kthimit për herë të parë të akteve të kishte kërkuar prova dhe dokumente që i shërbenin hetimit, dhe për pasojë duket se ky qëndrim i gjykatës në kthimin e akteve ka qenë i drejtë.

- Trupi gjykues çmon se ndërmarrja e veprimeve të subjektit të rivlerësimit për të zëvendësuar Oficerin e Policisë Gjyqësore vetëm përgjatë hetimit administrativ nga Komisioni, në një kohë që nga i pandehuri një kërkesë e tillë ishte shprehur në kohë, cënon rolin dhe njëanshmërinë e tij në funksion të ushtrimit të detyrës.
- Trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 96/2016 dhe Rregulloren për “Sistemin e vlerësimit të punës dhe të aftësive profesionale dhe morale të prokurorëve”, miratuar me urdhrin nr. ***, datë 11.12.2012, të Prokurorit të Përgjithshëm, ku ndër të tjera, rasti trajtohet si zgjidhje e gabuar ligjore, parashikuar në pikën 1.3 të nenit 16 të kësaj rregulloreje.

- Trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të përmbushë në kohë një prej aftësive të parashikuara në nenin 73/2 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si element që vlerëson aftësitë profesionale të prokurorit, “aftësinë për të mbledhur provat e kërkuara me ligj”.

➤ **Në lidhje me tri denoncimet (mbi të njëjtin objekt ankimi) e shtetasit E.S.**

Referuar denoncimeve të depozituara në Komision konstatohet se ky shtetas, ndër të tjera, ka parashtruar se:

- ka qenë person nën hetim në kuadër të procedimit penal nr. *** të vitit 2017 dhe se në datën 10.9.2017 shtetasi P. P., me profesion avokat, ka bërë kallëzim penal për një ngjarje të ndodhur në këtë datë, ku është qëlluar me armë zjarri ndaj mjetit të tij “Mercedes Benz” me targa ***;
- sipas informacioneve paraprake të siguruara në rrugë operative nga policia gjyqësore, si person i dyshuar për këtë ngjarje ka qenë shtetasi E. S.;
- me anë të vendimit të gjykatës është ushtruar kontroll në banesën e shtetasit E. S. dhe gjatë kontrollit të ushtruar në pjesën e çatisë së banesës së këtij shtetasi është gjetur një kuti në formë pakoje, brenda së cilës ishte një kallëp tritoli me një kapsollë detonatore elektrike, armë zjarri pistoletë e tipit Zastava mod.7.65 mm, tre fishekë pistoletë të kalibrit 7.65 mm, një mbytës zhurme për pistoletë, një qese e tejdukshme me lëndë narkotike e llojit heroinë dhe një granatë ngjyrë jeshile e llojit defensiv;
- është bërë arrestimi në flagrancë i këtij shtetasi dhe me vendimin nr. ***, datë 18.9.2017, është caktuar masa e sigurimit “arrest me burgim”. Në datën 29.12.2017, me vendimin nr. *** të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është ndryshuar masa e sigurimit nga “arrest në burg” në “arrest në shtëpi”;
- vetëm në datën 11.10.2018 është bërë shuarja e masës së sigurimit “arrest në shtëpi”, me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. *** akti për shkak të kalimit të afatit 1-vjeçar pa u dërguar aktet në gjykatë, sipas nenit 261 dhe 263 të Kodit të Procedurës Penale;
- ka pretenduar se nga momenti i zbatimit të masave të sigurimit, nuk i është komunikuar asnjë veprim hetimor.

➤ **Verifikimi i dosjes⁴⁸ penale**

Komisionit, nga verifikimi i fashikullit penal, ndër të tjera, i rezultoi se:

- Subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e çështjes penale nr. *** të vitit 2017 në ngarkim të shtetasit E.S., në datën 10.5.2019.
- Është bërë ndarja e kësaj çështjeje për zbulimin e autorit për veprat penale “kanosje”, “prodhim dhe shitje të narkotikeve”, si dhe “prodhim dhe shitje të armëve luftarake, municioneve”, parashikuar nga nenet 84, 283/1 dhe 278 të Kodit Penal.
- Nga prokurori i çështjes janë kryer një sërë veprimesh hetimore për zbardhjen e plotë të çështjes, dhe gjithashtu është kryer edhe veprimi i eksperimentit hetimor në datën 12.6.2018, duke u pyetur më pas personi nën hetim E. S., ku nuk konstatohen veprime të tjera hetimore.
- Në datën 14.12.2018 është përpiluar akti për përfundimin e hetimeve, sipas të cilit është konkluduar se megjithë hetimet e kryera nuk provohet kryerja e veprave penale të

⁴⁸ Fashikulli penal nr. *** i vitit 2017, për të cilën është vendosur pushimi i çështjes penale në ngarkim të shtetasit E.S. në datën 10.5.2019, nga subjekti i rivlerësimit.

parashikuara nga nenet 84, 283/1 dhe 278 i Kodit Penal nga personi nën hetim E. S. dhe për sa më sipër, në bazë të nenit 327 të Kodit të Procedurës Penal mbrojtësit i është komunikuar e drejta për t'u njohur me aktet dhe për të marrë kopje të tyre, të paraqesë brenda 10 ditëve memorie e dokumente si dhe t'i kërkojë prokurorit kryerjen e hetimeve shtesë. Ky akt për përfundimin e hetimeve i është komunikuar mbrojtësit, i cili ka nënshkruar, por nuk i është komunikuar personit nën hetim.

- Në kërkesë-memorien e paraqitur nga personi nën hetim para Prokurores së Përgjithshme nr. ***, datë 3.4.2018 (kërkesë e cila i është dërguar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për vlerësim me shkresën nr*** prot., datë 8.5.2018), është pretenduar njëanshmëria e veprimeve të Oficerit të Policisë Gjyqësore, E. Sh.Gj., për konflikt interesi të hapur, për shkak të lidhjeve të këtij të fundit me pronarin I. Xh. .
- Prokurori, pas kalimit të afatit 10 ditor (kur nuk ka kërkesa të tjera) nuk ka disponuar me kërkesën për pushimin e çështjes në ngarkim të shtetasit E.S., referuar parashikimit ligjor të nenit 327 të Kodit të Procedurës Penale, por ka disponuar me këtë kërkesë në datën 10.5.2019.
- Prokurori nuk kishte hetuar paralelisht edhe mundësinë e një inskenimi të vendosjes së provave materiale me qëllim implikimin e këtij shtetasi nga persona të tjerë, për sa kohë ky shtetas pretendonte se kishte bërë kallëzim penal për konfliktin e pronësisë me familjen Xh. vetëm pak kohë më parë se të ndodhte ngjarja; dhe për pasojë, për sa më sipër, i kërkoj subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime⁴⁹.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Ndër të tjera, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se:

Ligji procedural penal parashikon se kërkesa për dërgimin në gjykim ose për pushimin e procedimit apo të çështjes përpilohet pas njoftimit të përfundimit të hetimeve dhe pas kalimit të kohës për të pandehurin për t'u njohur me aktet dhe mundësinë për të paraqitur memorie dhe kërkesa për akte dhe prova. Sipas nenit 327 të Kodit të Procedurës Penale, përpilimi i kërkesës për pushimin e çështjes apo procedimin, edhe pse renditet si akt procedural pas njoftimit të akteve të të pandehurit dhe të të dëmtuarit, nuk lidhet me afat të caktuar për përpilimin e një akti të tillë.

Subjekti çmon se shtetasit E. S. nuk i janë prekur interesat e ligjshme përgjatë kohës deri në përpilimin e kërkesës për pushimin e çështjes në ngarkimin e tij. Për sa i përket hetimit paralelisht të pretendimit të këtij shtetasi për inskenimin e çështjes në ngarkimin e tij, subjekti ka sqaruar se:

- së pari, veprimet procedurale janë kryer në kontroll të gjykatës së hetimeve paraprake (që me kërkesën për kontrollin e banesës) sipas akteve të dosjes;
- së dyti, vlerësimi i strategjisë së hetimit varet dhe çmohet nga prokurori i çështjes, si organ për ushtrimin e ndjekjes penale;
- së treti, shtetasit E. S. ka qenë në cilësinë e personit nën hetim dhe si i tillë veprimet hetimore janë shtrirë për të provuar nëse veprat penale ishin kryer ose jo nga ai person;
- së katërti, kryerja e të gjitha veprimeve hetimore, në veçanti kryerja e eksperimentit hetimor të vendosur prej tij si prokuror i çështjes, provon tej çdo pretendimi të atij shtetasi se si prokuror i çështjes ka ndjekur dhe respektuar në hetimin e këtij procedimi penal se nevojën

⁴⁹ Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016.

për ushtrimin e ndjekjes penale në funksion të provave për ngjarjen dhe të drejtat dhe liritë e personit;

- së pesti, në përfundim të hetimeve është çmuar për kërkesën për pushimin e çështjes, duke krijuar bindjen në këtë çast dhe për ndarjen e procedimit si relatohet në raportin e Komisionit;
- së gjashti, vlerëson dhe ka bindjen se zgjedhja e kohës për ndarjen e procedimit dhe vazhdimin e hetimeve është e duhura, për të mos paragjykuar gjatë hetimeve që kryheshin ndaj këtij personi, përfundimin e hetimeve paraprahe.

Po ashtu, subjekti ka cituar se kërkesa për pushimin e kësaj çështjeje është duke u gjykuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe seanca e radhës rezultoi të jetë caktuar në datën 9.10.2019. Ndërkohë që, procedimi i ndarë pas vendimit të tij si prokuror i çështjes për zëvendësimin e Oficerit të Policisë Gjyqësore, për të cilin ka pretendime shtetasi E. S., është dërguar për veprime të mëtejshme në Komisarriatin e Policisë Nr. 4 Tiranë.

Referuar në nenin E të Aneksit të Kushtetutës, subjekti ka sjellë në vëmendje që të konsiderohet fakti që kjo çështje është në gjykim dhe pjesa e ndarë e këtij procedimi në hetime paraprahe.

Vlerësimi i Komisionit

Trupi gjykues, nga analizimi i dokumentacionit të administruar dhe parashtrimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me konstatimin e Komisionit se kërkesa për pushimin e çështjes në ngarkim të shtetasit E. S. ishte përpiluar nga prokurori në datën 10.5.2019, rreth pesë muaj pas kërkesës së përpiluar për përfundimin e hetimeve, më konkretisht, në datën 14.12.2018, konstaton se subjekti i rivlerësimit synon të justifikojë vonesën me faktin se në ligj nuk është parashikuar afati i kësaj kërkesë.

Në ndryshim nga pretendimi i subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, në interpretim të nenit 327 të Kodit të Procedurës Penale, konkludon se dispozita nuk mund të shihet e ndarë por në kontekstin e vijueshmërisë së saj dhe, për rrjedhojë, vlerëson se fakti që pika 4 e këtij neni i jep të drejtë të pandehurit që brenda një afati 10 ditor nga njoftimi i përfundimit të hetimeve të paraqesë memorie dhe dokumente, kërkesë për hetime shtesë, etj. Po ashtu, fakti që nëse kërkohen të tilla, sipas pikës 5 të po këtij neni, prokurori detyrohet që nëse e pranon kërkesën të kryejë procedura brenda afatit 30 ditë, qartëson në mënyrë të drejtpërdrejtë se nëse nuk depozitohen të tilla sikundër është edhe ky rast, atëherë subjekti i rivlerësimit nuk kishte arsye legjitime për të mbajtur çështjen për rreth pesë muaj nga përfundimi i hetimeve deri në kërkesën për pushimin e saj. Pra, do të quhej një afat maksimal, megjithëse në këtë rast i sforcuar, pritja 30 ditore për të rezultuar më pas me kërkesën për pushimin e çështjes.

Nga ana tjetër, trupi gjykues çmon se tejkalimi i afateve procedurale nuk do të gjente mbështetje edhe në këndvështrim të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut, për më tepër kur prej dhjetorit të vitit 2018 nga hetimi kishte rezultuar se nuk provohej nga ky shtetas kryerja e veprave penale të parashikuara nga nenet 84, 283/1 dhe 278 të Kodit Penal.

Trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit me veprimet dhe mosveprimet e tij, kryesisht pa dhënë argumente bindëse për kohën e gjatë të rezultuar mes kryerjes së dy veprimeve procedurale të kryera nga ana e tij, ka cenuar procesin e rregullt në dobi dhe interes të denoncuesit, nuk është treguar efektiv në përmbylljen e fashikullit hetimor dhe për pasojë ka

vepruar në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 96⁵⁰/2016, i aplikueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale por edhe të kriterëve të përcaktuara në rregulloren për “Sistemin e vlerësimit të punës dhe të aftësive profesionale dhe morale të prokurorëve”, miratuar me urdhrin nr. ***, datë 11.12.2012, të Prokurorit të Përgjithshëm, ku ndër kriteret dhe kërkesat e përcaktuara si bazë për vlerësimin e aftësive të subjektit të rivlerësimit është edhe efektiviteti i ushtrimit të ndjekjes penale dhe administrimi i një procedimi penal.

Gjithashtu, trupi gjykues, edhe në lidhje me konstatimin tjetër se: *prokurori nuk kishte hetuar paralelisht edhe mundësinë e një inskenimi të vendosjes së provave materiale me qëllim implikimin e këtij shtetasi nga persona të tjerë, për sa kohë ky shtetas pretendonte se kishte bërë kallëzim penal për konfliktin e pronësisë me familjen Xh. vetëm pak kohë më parë se të ndodhte ngjarja, çmon se:*

- i. për sa kohë subjekti i rivlerësimit nuk argumentoi se përse kishte mbajtur për një kohë të gjatë përpilimin e kërkesës për pushimin e çështjes, përderisa kishte arritur në përfundim se vepra penale nuk ishte konsumuar nga i pandehuri;
- ii. për sa kohë subjekti i rivlerësimit nuk kishte pranuar kërkesën e të pandehurit për zëvendësimin e Oficerit të Policisë Gjyqësore për shkak se i pandehuri pretendonte që ky i fundit të ishte në konflikt interesi në këtë proces, për më tepër kur kjo kërkesë ishte bërë me shkrim;
- iii. për faktin që Komisioni konstatoi se subjekti kishte bërë zëvendësimin e OPGj-së vetëm pasi ishte njohur me rezultatet e hetimit administrativ;
- iv. për sa kohë në këtë çështje implikohej edhe shtetasi P. P., i cili kishte qenë avokat i të pandehurit, por në çështjen civile pronësore,

mosndërmarrja e veprimeve të tjera hetimore në kohën e duhur, pra, paralelisht me hetimin e themelit, por vetëm pas ndarjes së çështjes në datën 10.5.2019, kur edhe ka urdhëruar kryerjen e veprimeve hetimore në këtë drejtim, bie në kundërshtim me rolin dhe përmbushjen e detyrave të prokurorit me profesionalizëm, efektivitet dhe paanshmëri.

➤ **Në lidhje me denoncimin nr. *** prot., datë 17.4.2019, depozituar nga shtetasi V.Ç.**

Denoncuesi pretendon se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer hetim të thelluar për falsifikimin e dokumenteve të disa ish-pronarëve, të cilët kanë përfituar padrejtësisht truall. Këto pretendime (të cilat sipas denoncuesit janë zbuluar nga prokuroria dhe shqyrtuar nga Gjykata e Shkallës së Parë) nuk janë marrë parasysh nga subjekti, i cili ka vendosur *pushimin e procedimit nr. ***, datë 26.7.2018.*

Denoncimi është shoqëruar me materiale shkresore që i përkasin çështjes si më poshtë vijon:

- ankesë drejtuar KLP-së;
- kallëzim penal kundër Drejtorisë së Drejtimit të Pronës Publike Pranë Ministrisë së Financave, Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, shtetasve Ll.;
- memo drejtuar subjektit Ndini Tavani;
- kërkesë e prokurorisë për pushimin e çështjes;
- vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për të zgjatur hetimet me dy muaj;

⁵⁰ Neni 74/4 Në rastin e prokurorit, aftësia e prokurorit për të kryer *në mënyrë të efektshme procedura hetimore* dhe ...matet duke u bazuar në treguesit e kryerjes së veprimeve të nevojshme hetimore dhe procedurale brenda afatit kohor të përcaktuar, të mbledhjes së provave të nevojshme, duke përfshirë mbikëqyrjen e dërgimit pa vonesë të akteve të nevojshme të njoftimit.

- vendim i Gjykatës së Apelit Tiranë për refuzimin e ankimit nga prokuroria.

➤ Rrethanat e çështjes

Nga aktet e depozituara nga kallëzuesi rezulton se kallëzimi i përket një procesi gjyqësor civil, i cili është shqyrtuar në disa shkallë gjykimi.

Denoncuesi ka privatizuar disa objekte nëpërmjet AKP-së, trualli i të cilave i është kthyer ish-pronarëve.

Më tej, pasi gjykatat kanë vendosur pavlefshmëritë e kontratave të denoncuesit me shitësit e pasurisë dhe kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme, institucionet publike kanë dhënë këtë pasuri me të drejtën e parablerjes ish-pronarëve.

Denoncuesi pretendon për investime të kryera në objektet e ndërtuara në truallin e ish-pronarëve dhe për këtë ka paraqitur kallëzim, nën argumentin se institucionet publike kanë vepruar në kundërshtim me ligjin lidhur me dhënien e pasurisë ish-trashëgimtarëve/ish-pronarëve.

- Subjekti i rivlerësimit ka kërkuar pushimin e procedimit penal.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. *** akti, datë 2.11.2018, ka vendosur kthimin e akteve që i përkasin procedimit penal nr. ***/2018, për veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, organit të prokurorisë dhe vazhdimin e hetimeve, si dhe përfundimin e tyre brenda dy muajve nga marrja formë e prerë e këtij vendimi. Në këtë vendimmarrje gjykata ka arsyetuar mbi veprën penale të falsifikimit, si dhe ka lënë detyra për organin e prokurorisë për të vijuar hetime të mëtejshme.

Ndër të tjera, gjykata në vendimin e saj është shprehur: “...në lidhje me kërkesën e pushimit për sa i përket veprës ‘falsifikim i dokumenteve’, *pretendimi i prokurorisë se vërtetësia e dokumentit që pretendohet i falsifikuar, duhet të bëhet në rrugë civile duke iu drejtuar me padi për konstatim të pavlefshëm të kësaj kontrate, lidhur ndërmjet palëve të sipërpërshkruara, pasi është një marrëdhënie juridiko-civile, jo vetëm që është i pabazuar në provat e administruara gjatë gjykimit, por është dhe rezultat i interpretimit të gabuar të ligjit procedural civil e penal. Kjo për faktin pasi nga ana e viktimës nuk pretendohet falsiteti i kontratave të shitjes, por pretendohet përdorimi i një dokumenti të falsifikuar, sikurse është vendimi nr. ***, datë 16.9.2000, i KKKP-së Tiranë, falsiteti i të cilit është provuar tashmë me vendimin nr***, datë 9.9.2011, e Gjykatës së Apelit Tiranë.*”

Në përfundim të gjykimit, gjykata ka urdhëruar prokurorinë të kryejë këto veprime hetimore: (i) të regjistrohet në regjistrin e veprave penale si person nën hetim emri i shtetasit F.Ll., në zbatim të nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale; (ii) të pyetet shtetasi F. Ll. si person nën hetim, në zbatim të nenit 296 Kodit të Procedurës Penale, në praninë e detyrueshme të një mbrojtësi, në respektim të gurmës “ë”, të pikës 1, të nenit 49, të Kodit të Procedurës Penale; (iii) të njoftohet shtetasi F. Ll. (pasi të merret i pandehur); (iv) në zbatim të pikës 4, të nenit 327, të Kodit të Procedurës Penale të njoftohet i pandehuri se ka të drejtë që brenda 10 ditëve të paraqesë memorie dhe dokumente, t’i kërkojë prokurorit kryerjen e hetimeve shtesë, të bëjë deklarime apo të kërkojë që të merret në pyetje; dhe (v) paraqitjen e kërkesës për dërgim në gjyq konform gurmës “b”, të pikës 6, të nenit 327, dhe nenit 331 e vijues të Kodit të Procedurës Penale.

Kundër vendimit të gjykatës është ushtruar ankim, pas të cilit edhe Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë 6.2.2019, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë, për shkak se përfaqësuesi i organit të akuzës në apel ka hequr dorë nga ankimi i depozituar.

Nga sa më sipër është konstatuar se subjektit të rivlerësimit i është kërkuar të japë shpjegime, pasi:

- Dukej se subjekti i rivlerësimit nuk ka vepruar në përputhje me standardet e përcaktuara nga ligji nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ku ndër të tjera parashikohen si elementë që përcaktojnë aftësitë profesionale të prokurorit:
 - a. aftësia për të hetuar dhe marrë urdhra dhe vendime;
 - b. aftësia për të mbledhur provat e kërkuara me ligj;
 - c. aftësia për të marrë në pyetje.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka parashtruar se ishte ngarkuar për hetimin e procedimit penal nr. *** të kësaj prokurorie, procedim penal i regjistruar pas kallëzimit penal të shtetasit V. Ç. . Në përfundim të hetimeve paraprake i ishte drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesë për pushimin e procedimit penal nr. ***.

Me vendimin nr. *** akti, datë 2.11.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë kishte vendosur kthimin e akteve dhe detyrimin e organit procedues për të kryer veprimet hetimore të vendosura nga gjykata. Pas ankimit me vendimin nr. ***, datë 6.2.2019, Gjykata e Apelit Tiranë kishte vendosur mospranimin e ankimit. Në vijim, ka parashtruar se vendimi i gjykatës kishte urdhëruar si veprime hetimore:

- regjistrimin e emrit të personit nën hetim të shtetasit F.LL.;
- pyetjen si person nën hetim;
- njoftimin e akuzës;
- njoftimin me përfundimin e hetimeve;
- dërgimin për gjykim të çështjes.

Në pjesën arsyetuese gjykata ishte shprehur: *“Duke qenë se gjykata nuk mund të urdhërojë prokurorin të formulojë akuzë për persona emrat e të cilëve nuk rezultojnë të jenë të shënuar në regjistrin e njoftimeve të veprave penale, gjykata urdhëron prokurorin:*

- *të regjistrojë emrin si person në hetim për shtetasin;*
- *të formulojë akuzën;*
- *ta pyesë si të pandehur;*
- *t’i japë kohë 10 ditë për të paraqitur memorie;*
- *t’i japë të pandehurit të drejtën për t’u pyetur;*
- *të dërgojë çështjen në gjyq.”*

Subjekti ka deklaruar se vendimi i gjykatës është i paarsyetuar. Vendimi i paarsyetuar e bën të pavlefshëm në kuptim të nenit 112/3 të Kodit të Procedurës Penale. Gjykata ka urdhëruar *de facto* formulimin e akuzës për persona emra të të cilëve nuk janë të shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale. Ky disponim i gjykatës vjen ndesh me kërkesat e nenit 329/4 të Kodit të Procedurës Penale. Sipas kësaj dispozite: *“Gjykata nuk mund të urdhërojë prokurorin që të formulojë akuzë për persona të tjerë, emri i të cilëve nuk është regjistruar sipas nenit 287 të këtij kodi.”*

Sipas nenit 329/3/c dhe nenit 329/4 të Kodit të Procedurës Penale, gjykata urdhëron formulimin e akuzës vetëm kur plotësohen këto dy kushte:

- 1) hetimet janë kryer të plota dhe rezulton se ka prova të mjaftueshme për të mbështetur akuzën në gjyq;
- 2) vetëm për personat, emrat e të cilëve janë të regjistruar në regjistrin e njoftimeve të veprave penale si persona nën hetim.

Në çdo rast tjetër, kur gjykata çmon se duhet të kryhen veprime të tjera hetimore, nuk mund të parashikojë të ardhmen dhe të urdhërojë apriori formulimin e një akuze ende pa u kryer veprimet hetimore të urdhëruara dhe/ose ato që mund të dalin të domosdoshme më tej. Urdhërimi i gjykatës është i pakuptimtë dhe në kundërshtim me procedurën penale. Ato që gjykata i konsideron si veprime hetimore (njoftimi i akuzës, regjistrimi i emrit të personit në regjistrin e njoftimit të veprave penale, njohja me të drejtat e të pandehurit, dhënia kohë për memorie etj.), nuk janë të tilla. Ato janë akte procedurale që kryhen kur organi i akuzës çmon për ekzistencën e provave të mjaftueshme që do të passjellin marrjen e një personi të cilësisë së të pandehurit në një procedim penal.

Megjithë ndryshimet thelbësore në Kodin e Procedurës Penale, e drejta për të ushtruar ndjekjen penale është atribut i organit procedues, që në përputhje me ligjin të urdhërojë kryerjen e hetimeve mbi një person konkret fizik apo juridik. Gjykata, vetëm në rastet kur është ushtruar një ndjekje penale dhe konsideron se hetimet janë kryer të plota, mund të urdhërojë formulimin e akuzës. Gjykata, si veprime hetimore, nuk ka bërë gjë tjetër veçse ka kopjuar dispozitat e Kodit të Procedurës Penale që lidhen me personin nën hetim dhe të pandehurin, si dhe të drejtat dhe detyrimet e tyre në një proces penal. Kapërcime dhe artificialitete të tilla, si ato të urdhëruara nga gjykata, janë në kundërshtim me Kushtetutën dhe Kodin e Procedurës Penale. Referuar vendimit të gjykatës së shkallës së parë nuk rezulton që veprimet hetimore të kryera nga ana e tij të jenë kryer të mangëta. Gjykata ka arritur në përfundimin se duhet të njoftohet akuza mbi të njëjtat akte dhe prova të administruara nga ana e tij si prokuror i çështjes dhe Oficerit të Policisë Gjqësore.

Subjekti deklaron se është i bindur në faktin se vepra penale e falsifikimit të dokumenteve, si vepër penale për të cilën aludon gjykata për njoftimin e akuzës, është vepër penale jo formale, por materiale, dhe kërkon ardhjen e një pasojë të caktuar dhe qëllimin për të arritur në një pasojë të caktuar nga personi që e përdor.

Sipas akteve të dosjes rezulton se vendimi nr. ***, datë 16.9.2000, i KKKP-së Tiranë, edhe pse në dosjen e dorëzuar nga shtetasi F. Ll. nuk është marrë në konsideratë për vendimmarrjen e institucionit të kallëzuar. Në të tilla kushte, duke mos ardhur asnjë pasojë nga përdorimi i një dokumenti të tillë, ka çmuar dhe ka bindjen se nuk plotësohen elementet e figurës së veprës penale, të parashikuara nga neni 186 i Kodit Penal.

Subjekti kërkon të konsiderohet fakti që kjo çështje është në shqyrtim në fazën e hetimeve paraprake, pas kthimit nga Gjykata e Apelit Tiranë.

Vlerësimi i Komisionit

Trupi gjykues, në analizë të vendimit të organit gjyqësor, në analizë të kërkimit të organit të prokurorisë, çmon se pretendimet e subjektit lidhur me arsyen e kërkimit të pushimit të procedimit penal se falsiteti i dokumentit duhet trajtuar nëpërmjet shqyrtimit të një procesi civil për pavlefshmëri kontratash, nuk qëndron.

Për sa kohë falsiteti i një dokumenti është provuar, me të drejtë gjykata ka vlerësuar se shkaktimi i pasojës nga përdorimi i saj duhet të hetohet dhe për këtë ka lënë detyrat përkatëse.

Gjithashtu, trupi gjykues çmon se për sa kohë kërkimi i pushimit të çështjes është prishur nga gjykata dhe megjithë ankimin e ushtruar që presupozohet se është parashtruar në të njëjtën linjë, sikurse në këto parashtrime, dhe përsëri vendimmarrja e një shkalle më të lartë të gjyqësorit, si ajo e apelit, ka mbajtur të njëjtin qëndrim me gjykatën e shkallës më të ulët, veprimet dhe mosveprimet e subjektit të rivlerësimit nuk janë ndërmarrë, sikurse kërkohet në pikën 2, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016 dhe, për pasojë, nuk vlerësohen pozitivisht në aspektin e njohurive ligjore duke u bazuar në aftësinë e prokurorit për të hetuar dhe për të marrë urdhra dhe vendime, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin, sipas kërkesave ligjore, për të mbledhur provat e kërkuara me ligj, për të interpretuar ligjin dhe për të analizuar jurisprudencën.

Po ashtu mbi hetimin e kryer për këtë çështje, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit, nëse do të kishte thelluar hetimet e kryera, do të kishte përmbushur një ndër elementët që përfshihet në aftësitë profesionale juridike dhe teknike, konkretisht aftësinë për të kryer ndjekje penale në hetim dhe në gjyq dhe për të krijuar dhe administruar procedimin penal.

➤ **Në lidhje me denoncimin e shtetasit I. S.**

Me objekt: *“Denoncoj prokurorin Ndini Tavani për zvarritje të procesit hetimor. Nuk ka kryer hetimet e nevojshme lidhur me çështjen time, ka devijuar hetimin duke keqinterpretuar anën ligjore dhe ka sjellë parashkrimin e veprave penale dhe amnistinë për personat që duhet të ishin dënuar. Ky prokuror nuk ka zbatuar as vendimin e Gjykatës së Apelit. Bashkëlidhur dokumentacioni. Vendim pushimi i datës 22.3.2012, vendim pushimi i datës 9.4.2015, vendim i Gjykatës së Apelit nr. ***, datë 28.3.2014, nr. ***, datë 16.3.2018, disa ankime etj.”*

➤ Rrethanat e çështjes nr. *** të vitit 2011

Në datën 5.10.2011 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar procedimin penal nr. *** për veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248, i Kodit Penal. Regjistrimi i këtij procedimi është vendosur mbi bazën e kallëzimit të shtetasit I. S. kundër shtetasit E. P., me detyrë përgjegjës i Sektorit të Legalizimit pranë Drejtorisë Qendrore të ALUIZNI-t Tiranë.

➤ Hetimi i kryer

Organi procedues rezulton se ka kryer një sërë veprimesh hetimore nëpërmjet këqyrjes së praktikës së legalizimit, administrimit të dokumenteve shkresore të institucioneve të ndryshme dhe marrjes së deklarimeve të personave që kanë dijeni për rrethanat e hetimit mbi bazën e kallëzimit të shtetasit I. S. .

Organi procedues, në kuadër të hetimeve paraprake, ka konkluduar se hetimi penal kundër shtetasit E. P. duhet pushuar, pasi në veprimet e këtij shtetasi në funksion të detyrës së tij nuk vërehen elementë të veprës penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Organi procedues ka çmuar se me nënshkrimin e shtetasit E. P. nuk vërehen elementë të veprës penale të shpërdorimit të detyrës, pasi leja e legalizimit është nxjerrë pas gjithë procedurës së ndjekur nga të gjithë sektorët përgjegjës të ALUIZNI-t.

Në këto kushte ka vendosur pushimin e procedimit penal sipas germës “dh”, të nenit 328, të Kodit të Procedurës Penale.

➤ Procedurat gjyqësore

Ankuesi I. S. i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesën “ankim ndaj vendimit të pushimit të procedimit penal nr. *** të vitit 2011” dhe pas shqyrtimit të kësaj kërkesë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. *** akti, datë 25.9.2013, ka vendosur:

- *Rrëzimin e kërkesës penale nr. ***regj. themeltar, datë 18.4.2012.*

Ankuesi i është drejtuar Gjykatës së Apelit Tiranë duke kundërshtuar këtë vendimmarrje të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe pas shqyrtimit të ankimit, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. *** datë 28.3.2014, ka vendosur si më poshtë:

*Ndryshimin e vendimit nr. *** akti, datë 25.9.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*

- *Pranimin e kërkesës.*

- *Prishjen e vendimit të pushimi të procedimit penal nr***, datë 5.10.2011, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dërgimin e akteve atij organi për vazhdimin e hetimit të çështjes.*

Në arsyetimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë citohet: *Gjykata e Apelit Tiranë çmon se në rastin e ankimit ndaj vendimit të pushimit të çështjes, detyrimi i gjykatës është të verifikojë nëse organi i akuzës ka zhvilluar hetime të plota dhe të gjithanshme, pa marrë attribute mbi të drejtën e ndjekjes penale, e cila mbetet e drejtë ekskluzive e prokurorisë.*

Në këtë kuptim, Gjykata e Apelit Tiranë çmon se organi i prokurorisë duhet të hetonte më me imtësi faktin e kallëzuar, sidomos lidhur me përcaktimin e momentit se kur është ndërtuar objekti i kallëzuar, në raport me momentin kur shtetasi i kallëzuar ka fituar pronësinë dhe atë kur ka aplikuar për legalizim.

Organi i prokurorisë duhet gjithashtu të hetojë lidhur me ndërtimin nëse është shtesë apo ndërtim i ri.

Organi i prokurorisë duhet të administrojë praktikën e legalizimit në raport me të dhënat eventuale që do të rezultojnë nga veprimet e sipërcituara hetimore.

Në këto kushte, konstatohet se edhe sipas vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë se hetimi i kryer ka qenë jo i plotë.

Për sa më sipër, është konstatuar se subjektit të rivlerësimit i është kërkuar të japë shpjegime⁵¹, pasi:

- Dukej se hetimi i kryer nga organi procedues deri në vendimin e pushimit të datës 22.3.2012 nuk ka qenë i plotë, konstatim ky i dalë edhe nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. ***, datë 28.3.2014, e cila e ktheu për rihetim procedimin penal nr. *** të vitit 2011.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka parashtruar se:

- Pas urdhërimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, si prokuror i çështjes, ka kryer veprimet hetimore të urdhëruar nga gjykata dhe në datën 9.4.2015 është vendosur pushimi i procedimit penal nr. ***.

⁵¹ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

- Ky vendim është ankimuar nga ankuesi I. S. dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. ***regj., datë 10.3.2016, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuarit I. S. për ankimin e tij kundër vendimit të pushimit të procedimit penal nr. *** datë 9.4.2015.
- Kundër këtij vendimi ankuesi I. S. ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë. Kjo gjykatë, me vendimin nr. ***, datë 16.3.2018, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim me një tjetër trup gjykues me urdhërimin për thirrjen nga gjykata të personave të kallëzuar për të marrë pjesë në gjykim.
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pas rigjykimit të çështjes me vendimin nr. ***akti, datë 14.6.2018, ka vendosur rrëzimin e kërkesës ankimore të ankuesit I.S. .
- Kundër këtij vendimi në Gjykatën e Apelit Tiranë ka paraqitur ankim shtetasi I. S. dhe kjo gjykatë, me vendimin nr. ***, datë 10.10.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me nr. ***, datë 14.6.2018.
- Po ashtu, subjekti ka parashtruar se kundër vendimit të pushimit të procedimit penal nr. ***, datë 9.4.2015, ka paraqitur ankim dhe shtetasi I.C. (i kallëzuar nga I. S.), duke i kërkuar gjykatës ndryshimin e formulimit të vendimit të pushimit me një parashikim më favorizues për këtë shtetas.
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. ***akti, datë 2.2.2018, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuarit I. C., si të pabazuar në prova dhe në ligj, dhe lënien në fuqi të vendimit të pushimit të procedimit nr. ***të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ky vendim ka marrë formë të prerë.

Vlerësimi i Komisionit

Trupi gjykues, në analizë të përmbajtjes së denoncimit, provave të administruara, si dhe parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit, vëren se subjekti, në tërësi përgjatë shpjegimeve, vë theksin kryesisht në vendimmarrjet e marra prej tij pas prishjes së vendimit të parë të pushimit, të datës 22.3.2012, për të cilin edhe Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. *** datë 28.3.2014, kishte konstatuar të njëjtat mangësi sikurse gjykata e shkallës së parë dhe për pasojë kishte kthyer për rihetim procedimin penal nr. *** të vitit 2011. Pra, vendimmarrjet e mëpasme të lëna në fuqi kanë ardhur si pasojë e kryerjes së detyrave të lëna nga gjykata me arsyetimin se hetimi i kryer nuk ka qenë i plotë.

Trupi gjykues, nisur nga fakti se subjekti i rivlerësimit nuk ka argumentuar mbi prishjen e vendimit të parë të pushimit të çështjes dhënë prej tij, nisur nga fakti që më tej vendimmarrja e radhës e marrë nga subjekti është lënë në fuqi nga organi gjyqësor, duke lënë të kuptueshëm kryerjen e një hetimi të plotë prej subjektit, ose thënë ndryshe, përmbushjen e detyrave të lëna më parë, çmon se subjekti me veprimet apo mosveprimet e tij në vendimin e pushimit të procedimit penal, në datën 22.3.2012, ka vepruar në kundërshtim me pikën 2 dhe 3, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, si dhe rregulloren⁵² për “Sistemin e vlerësimit të punës dhe të aftësive profesionale e morale të prokurorëve”, miratuar me urdhrin nr. ***, datë 11.12.2012, të Prokurorit të Përgjithshëm.

Gjithashtu, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit nëse do të kishte thelluar hetimet e kryera do të kishte përmbushur një ndër elementët që përfshihet në aftësitë profesionale juridike dhe teknike, konkretisht aftësinë për të kryer ndjekje penale në hetim dhe në gjyq dhe për të

⁵² Ndër të tjera, në këtë akt është parashikuar edhe neni 16/ “Zgjidhje të gabuara ligjore” pika 1/1.1/ Kërkesa e prokurorit në diskutim përfundimtarë është në kundërshtim me ligjin dhe provat dhe i paraprin vendimit gjyqësor të pafajësisë, pushimit të çështjeve/akuzave dhe kthimit të akteve prokurorit.

krijuar dhe administruar procedimin penal në kohë, si dhe për të realizuar një procedim penal efektiv me qëllim edhe garantimin e të drejtave dhe lirive të shtetasve.

- Komisioni, nisur nga informacioni publik mediatik, por edhe nga denoncimi i shtetasit F.D., ka trajtuar ashtu sikurse edhe KLP-ja në raportin e saj shtesë mbi denoncimet, rastin e bërë publik nga emisioni investigativ “Stop” dhënë në televizionin “Klan”. (2) Vendimi datë 13.6.2017, për “pushimin e procedimit penal nr. *** i vitit 2017”).

Për këtë çështje Komisioni kërkoi dhe administroi fashikullin penal⁵³ nr. ***, në ngarkim të shtetasit shtetasit F. Ç., me të cilin Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin datë 13.6.2017, ka vendosur “Pushimin e procedimit penal nr. ***”.

- Rrethanat e çështjes

Në datën 15.3.2017 Drejtoria e Policisë së Shtetit ka referuar pranë prokurorisë se është vënë në dijeni për veprën penale “korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal.

Ndër të tjera, në referim thuhet se janë informuar se në datën 1.3.2017 në emisionin investigativ “Stop” në TV Klan janë shfaqur pamje filmike në të cilat dalin në pah veprime korruptive të kryera nga mjeku F. Ç., shef i kirurgjisë torakale në Spitalin Universitar “Sh. N.” Tiranë. Në pamje filmike shfaqet mjeku, i cili merr një shumë parash nga familjari i një pacienti që i ishte nënshtruar një ndërhyrjeje kirurgjikale. Nga kërkimi në faqen *online* të TV Klan (thuhet) në referim është vërejtur i publikuar artikulli me titullin “Stop/shëndetësia falas kushton 60.000 mijë lekë të reja” (për më tepër referojuni fashikullit penal). Nga i gjithë hetimi i kryer në këtë procedim penal ka rezultuar se organit procedues i është vënë në dispozicion nga TV Klan një DVD me pamjet filmike të shfaqura në emisionin e datës 1.3.2017, ndërsa gjeneralitetet e personit që ka kryer filmimin nuk i kanë vënë në dispozicion, pasi bëhet fjalë për gazetarë investigativë të programit, identitetin e të cilit nuk mund ta publikojnë për shkak të profilit të punës dhe dekonspirimin e gazetarëve.

Në datën 2 mars 2017, OPGJ-ja ka mbajtur procesverbal mbi “këqyrjen, marrjen e provës materiale”, sipas të cilit janë marrë dokumente për interes të hetimit që i përkasin mjekut F. Ç.

Në datën 2 mars 2017 është mbajtur procesverbal për transkriptimin e bisedave të transmetuara në emisionin investigativ.

Në datën 2 dhe 10 mars janë mbajtur procesverbale për kërkimin e shtetasit/mjekut F.Ç. .

Në datën 10 mars është mbajtur procesverbal për deklarime nga persona që tregojnë rrethana të hetimit, më konkretisht, nga shtetasja F. K. (vajza e pacientit), e cila është shprehur se nuk ka dijeni për rastin.

Drejtori i programit “Stop” i është drejtuar në datën 13.3.2017 Drejtorisë së Policisë së Shtetit nëpërmjet të cilës bën me dije se vendos në dispozicion pamjet bruto të transmetuara në datën 1.3.2017 në Spitalin Universitar “Sh. N.”, Tiranë. Ndërsa, në përgjigje thuhet se *për sa i përket gjeneraliteteve të personit, e kemi ta pamundur, pasi bëhet fjalë për gazetarë investigativë të programit, identitetin e të cilëve nuk mund ta publikojmë për shkak të profilit të punës dhe dekonspirimit të gazetarëve.*

⁵³ Referojuni shkresës nr***prot., datë 9.7.2019, bashkëngjitur saj fashikulli përkatës.

Në datën 28.3.2017 subjekti i rivlerësimit, me cilësinë e prokurorit, ka regjistruar procedimin penal të sipërcituar, pas depozitimit nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë të materialit, lidhur me veprën penale të korrupsionit aktiv të personave që ushtrojnë funksione publike, parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal.

Në datën 1.4.2017 subjekti i rivlerësimit ka urdhëruar kryerjen e disa veprimeve hetimore nga OPGJ-ja M. SH., më konkretisht është urdhëruar:

- kryerja e transkriptimit të plotë të bisedave sipas përmbajtjes së CD-së së dërguar nga emisioni “Stop”;
- të hetohet dhe të identifikohet personi që ka kryer ndërhyrjen tek spitali “Sh.N.” dhe të pyetet;
- në rast se konstatohen elementë të vetëinkriminimit të zbatohet dispozita e nenit 37 të Kodit të Procedurës Penale;
- të administrohet kartela klinike e personit që ka bërë ndërhyrjen;
- të pyeten anëtarë të tij të familjes lidhur me sa ka rezultuar nga pamjet televizive dhe transkriptimet e bisedave, brenda 40 ditëve.

Në datën 15 maj 2017 prokuroria i ka dërguar për transkriptim DVD Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, me qëllim transkriptimin e pamjeve filmike bruto të transmetuara në emisionin investigativ “Stop” në TV Klan, në datën 1.3.2017.

Në datën 31 maj 2017 është mbajtur procesverbali për transkriptimin e bisedave të regjistruara në DVD me mbishkrimin “verbatim”. Ndër të tjera, në bisedën e kryer pasqyrohet edhe dhënia e një shume të caktuar parash nga një person i paidentifikuar, i cili ka kryer investigimin dhe ka krijuar komunikimin me shtetasin F.Ç., si dhe përgjigja e *falënderimit* nga ana e mjekut për to.

Në datën 5 qershor është mbajtur procesverbal mbi deklaratimet e shtetasit F. Ç., i cili nuk ka pranuar të ketë marrë para për ndërhyrjen kirurgjikale dhe se video e shfaqur është një montim, pasi, është shprehur ai: “... nuk kujtoj që të jem gjendur në ndonjë situatë të tillë me pacientin apo familjarë të tij.”

Në datën 8 qershor OPGJ-ja ka sugjeruar pushimin e procedimit penal, ndër të tjera, edhe për faktin se nga hetimet e kryera ka rezultuar që nga familjarët e pacientit L. K., nuk është shkuar për t’u ankuar në emisionin “Stop”, zëri i shfaqur në filmime nuk është i tyre dhe se prej tyre nuk është dhënë ndonjë shumë parash.

Referenca ligjore e pushimit të kësaj çështjeje është germa “dh”, e nenit 328, e Kodit të Procedurës Penale, e cila ka të bëjë me mungesën e provueshmërisë së kryerjes së kësaj vepre penale dhe kjo referencë ligjore është e duhura në rastin konkret.

Nga rrethanat dhe faktet e parashtruara më sipër, subjektit të rivlerësimit iu kërkua të japë shpjegime pasi:

- i. dukej se nga ana e tij nuk ishin mbledhur prova dhe fakte për të provuar mbi vërtetësinë e bisedave të shfaqura në DVD;
- ii. nuk ishin pyetur në cilësinë e personave që mund të tregonin të tjera rrethana, (qytetarja që prezantohet në cilësinë e nuses së djalit të pacientit), ndërsa ishte pyetur vajza e tij e cila nuk dukej të prezantohej në këto biseda;

- iii. nuk ishte kërkuar të kryhej aktekspertizë lidhur me vërtetësinë e fakteve dhe rrethanave të ekspozuara në DVD, më konkretisht, për të qartësuar nëse zëri i doktorit i përkiste shtetasit F. Ç., apo vajzës së pyetur;
- iv. dukej se në mbështetje të hetimit të plotë dhe të gjithanshëm mund të ishin marrë në cilësinë e personave që kishin dijeni për investigimin edhe drejtuesit e emisionit, sigurisht duke ruajtur anonimitetin/konfidencialitetin.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Ndër të tjera, në parashtrimet e tij subjekti ka sqaruar se lidhur me aktet e procedimit penal nr. *** Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, pas referimit të materialit hetimor në lidhje me rastin e transmetuar në emisionin “Stop” në televizionin “Klan”, ka regjistruar procedimin penal nr. ***për veprën penale të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal.

Pas regjistrimit të procedimit, si prokuror i çështjes i kishte deleguar procedimin penal Oficerit të Policisë Gjyqësore për kryerjen e veprimeve hetimore të nevojshme dhe të domosdoshme për të vërtetuar faktin nëse ishim para një fakti penal dhe nëse po, për identifikimin dhe përgjegjësinë e autorit të këtij fakti penal.

Në përfundim të hetimeve paraprake, Oficeri i Policisë Gjyqësore kishte sugjeruar pushimin e procedimit penal. Pas studimit të dosjes dhe njohjes edhe me relacionin e Oficerit të Policisë Gjyqësore ishte vendosur pushimi i procedimit penal. Kundër këtij vendimi nuk rezultonte të ishte ushtruar ankim. Subjekti është shprehur se hetimet i konsideronte të plota, lidhur me provueshmërinë e faktit, si ishte identifikuar pacienti që kishte bërë ndërhyrjen dhe ishin pyetur edhe disa persona që tregonin rrethana të dobishme për qëllimet e hetimit. Nga hetimi kishte rezultuar se asnjë prej familjarëve të pacientit nuk kishte ndërmarrë iniciativën për të filmuar shtetasin F. Ç. për t'i dhënë shuma parash në këmbim të operacionit të kryer.

Organi procedues kishte kërkuar informacion për identifikimin e personit që kishte kryer përgjimin dhe bisedën, si dhe në pamjet filmike të transmetuara.

Sipas informacionit të datës 13.3.2017, të nënshkruar nga drejtuesi i emisionit, ishin vënë në dijeni se për sa i përket gjeneraliteteve të personit kishin qenë në pamundësi, pasi bëhej fjalë për gazetarë investigativë të programit, identitetin e të cilëve nuk mund ta publikonin për shkak të profilit të punës dhe dekonspirimit të gazetarëve.

Subjekti ka parashtruar se Kodi i Procedurës Penale parashikon ruajtjen e sekretit profesional nga gazetari, duke u mbrojtur nga neni 159 i Kodit Penal.

Gjithashtu subjekti ka sqaruar se kryerja e një ekspertize të zërit nuk ishte konsideruar e nevojshme në kohën e zhvillimit të hetimeve paraprake, për sa kohë që subjekti, si prokuror i çështjes, nuk kishte pasur dyshime se personi i identifikuar në pamjet filmike të mos ishte shtetasi F. C. dhe nga ky i fundit nuk ishte pretenduar një gjë e tillë. Në këto rrethana subjekti është shprehur se kryerja e një akti të tillë ekspertimi do të sillte kosto për dosjen dhe jo një zhvillim me interes.

Për sa i përket pyetjes në kushtet e ruajtjes së anonimatit të drejtuesve të emisionit “Stop” subjekti ka sqaruar se Kodi i Procedurës Penale nuk parashikon pyetje të personave që kanë dijeni për rrethana të hetimit në kushte anonimatit, apo konfidencialiteti për këtë vepër penale.

Subjekti është shprehur se për sa u konsultua me çështjen ka bindjen e tij referuar nenit 259 të Kodit Penal, praktikës së zbatimit të kësaj dispozite dhe ka sqaruar se hetimet kanë qenë

shteruese dhe në mungesë të identifikimit të burimit të kryerjes së filmimit, pasi vetë filmimi i paraqitur nuk merrte fuqinë e provës.

Subjekti është shprehur se si prokuror ka vlerësuar nisur edhe nga praktika e deritanishme se filmime të tilla janë konsideruar dhe do të konsiderohen si prova atipike, të cilat edhe pse në kushtet e administrimit jashtë kriterëve procedurale penale, marrin fuqi provuese kur identifikohet burimi i krijimit të provës dhe kur lidhen me të dhëna të tjera të mbledhura nga hetimet paraprake. Vepra penale e korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike, sipas nenit 259 të Kodit Penal, parashikon kërkimin ose marrjen drejtpërdrejt ose tërthorazi të çdo lloj përfitimi të parregullt ose i një premtimi të tillë për vete ose për persona të tjerë, apo pranimit të një oferte a premtimi që vjen nga përfitimi i parregullt nga personi që ushtron funksione publike për të kryer ose moskryer një veprim.

Subjekti ka cituar shprehimisht se: *“Sipas këtij parashikimi, çmoj se pavarësisht se kur merret përfitimi i parregullt, premtimi i paraprin në çdo rast veprimit ose mosveprimit të funksionarit që ka lidhje me detyrën.”*

Subjekti është shprehur se nga hetimet rreth atij procedimi penal nuk u provua që shtetasi F. Ç., në këmbim të kryerjes së detyrës së tij, të kishte kërkuar apo t'i ish premtuar shuma parash. Vetë familjarët e pacientit kishin deklaruar se nuk kishte pasur asnjë bisedë për pagesë për shtetasin F.Ç. .

Vlerësimi i Komisionit

Trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka kryer disa veprime hetimore, por nuk ka përmbushur detyrën e tij për të zgjeruar rrethin e hetimeve lidhur me mbledhjen e provave dhe fakteve për të provuar mbi vërtetësinë e bisedave të shfaqura në DVD, apo për të pyetur në cilësinë e personave që mund të tregonin të tjera rrethana, ndërsa kishte pyetur vajzën e pacientit e cila nuk ka qenë prezantuar në biseda, si dhe nuk ka përmbushur një detyrë të rëndësishme, atë të kërkimit të kryerjes së aktekspertizës, lidhur me vërtetësinë e fakteve dhe rrethanave të ekspozuara në DVD, për më tepër që në asnjë moment nuk është mohuar se personi i shfaqur në video nuk ishte mjeku i pretenduar si i përfshirë në kryerjen e veprës penale.

Trupi gjykues çmon gjithashtu se arsyet që parashtron subjekti mbi moskryerjen e ekspertizës së zërit në kohën e zhvillimit të hetimeve paraprake, përfshirë këtu edhe koston që do të sillte kryerja e aktit, nuk qëndrojnë, për faktin se, ose kryerja e një akti të tillë është domosdoshmëri sepse realizon zhvillimin e kërkimeve ose marrjen e të dhënave ose të vlerësimeve që kërkojnë njohuri të posaçme teknike, ..ose, për sa kohë pamjet filmike nuk kundërshtohen atëherë duhen zgjeruar hetimet me qëllim vërtetësinë e plotë të të dhënave të ngjarjes.

Trupi gjykues nuk vlerëson bindjet e parashtruara të subjektit të rivlerësimit në raport me faktet e konstatuara të cilat duket se për shkak të një hetimi të mangët nuk kanë marrë zgjidhje, duke cenuar besimin e publikut edhe për vetë faktin se denoncimi ishte bërë mediatik.

Lidhur me kriterin profesional, trupi gjykues, në referim të dispozitave të sipërcituara, çmon se sipas kriterëve të parashikuara në nenin 73 të ligjit nr. 96/2016, për dy dosjet nr. 3 dhe nr. 5, pjesë e dosjeve të përzgjedhura me short mes pesë dosjeve të hetuara nga subjekti i rivlerësimit, subjekti paraqet mangësi në drejtim të kryerjes së veprime hetimore të arsyetuara më sipër. Po ashtu trupi gjykues, në referim të dispozitave të sipërcituara, çmon se sipas kriterëve të parashikuara në nenin 73, të ligjit nr. 96/2016, por edhe të kriterëve të përcaktuara në

rregulloren për sistemin e vlerësimit të punës dhe të aftësive profesionale dhe morale të prokurorëve, miratuar me urdhrin nr. ***, datë 11.12.2012, të Prokurorit të Përgjithshëm, për denoncimet e hetuara të depozituara nga shtetasit E.S., A. R., V.Ç., I.S., si dhe për rastin e denoncimit të bërë publik në media, subjekti paraqet mangësi në drejtim të kryerjes së veprime hetimore të arsyetuara më sipër, si dhe në drejtim të aftësive për të krijuar dhe administruar procedimin penal në kohë dhe për të realizuar një procedim penal efektiv, me qëllim edhe garantimin e të drejtave dhe lirive të shtetasve, sikurse kishte vepruar në çështjet e renditura⁵⁴ nga denoncuesi F.D., për të cilat u konstatua se ishin ndjekur nga subjekti procedurat hetimore dhe ato gjyqësore.

Në përfundim të rivlerësimit profesional, pas propozimit të relatorit, Komisioni krijoi bindjen se mangësitë profesionale të konstatuara nuk mund të çojnë në konkluzionin se subjekti nuk ka arritur nivelin minimal kualifikues të vlerësimit të aftësive profesionale, sipas pikës 1/c, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, por se këto mangësi dëshmojnë për sjellje të subjektit në mospërmbushje të detyrës në pozicionin e prokurorit, duke cenuar në këtë mënyrë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, referuar pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES

Trupi gjykues, lidhur me vlerësimin e pasurisë, çmon:

- Për pasurinë e identifikuar nr. 1, subjekti i rivlerësimit, ka bërë deklaram të pamjaftueshëm lidhur me burimin e krijimit të shumës 2 500 000 lekë, të pretenduar me burim krijimi të ardhura nga avokatia për vitet 2003-2004. Subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm lidhur me diferencën e konstatuar në deklaratën “Vetting” dhe atë para fillimit të detyrës për vitin 2006, për shumën e deklaruar në rubrikën “të ardhurat”, me burim të ardhura nga avokatia. Subjekti është në mungesë burimesh financiare në shumën 673 390 lekë për të paguar këstin e dytë të kësaj pasurie në vitin 2016, blerjen e automjetit po në këtë vit, si dhe për të kryer shpenzimet e tjera familjare.
- Për pasurinë e identifikuar nr. 2, subjekti i rivlerësimit, ka bërë deklaram të pamjaftueshëm pasi nuk ka burime financiare të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie, sikurse është parashikuar në gërmë “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.
- Për pasurinë e identifikuar nr. 7, subjekti i rivlerësimit, ka kryer deklaram të pasaktë lidhur me pakësimin e gjendjes *cash* në vitin 2009 dhe rezulton në balancë negative në shumën 611 044 lekë për blerjen e kësaj pasurie.
- Për pasurinë e identifikuar nr. 9, subjekti i rivlerësimit, ka kryer deklaram të paplotë në koherencë me faktet e konstatuara mbi marrëdhënien e tij në raport me këtë pasuri, si dhe me kontributin e dhënë për të, duke mos provuar vërtetësinë e deklarimeve të tij për masën e kontributit, për të ribërë analizën e mëtejshme financiare.
- Për çështjen e identifikuar nr. 10, subjekti i rivlerësimit, nuk ka bërë deklaram të plotë, në kuptim të pikës 1, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.
- Në tërësi, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në mënyrë të pasaktë burimet e pasurive në deklaratën “Vetting”, si dhe nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të tyre dhe të të ardhurave me burim nga ushtrimi i profesionit të avokatit, sipas pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe ka kryer deklaram të pamjaftueshëm sipas pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, trupi gjykues arrin në përfundimin se

⁵⁴ Cituar në referencën nr. 43 në këtë vendim.

subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të gurmës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

Trupi gjykues, lidhur me vlerësimin e figurës, vlerëson se për subjektin e rivlerësimit, z. Ndini Tavani, nuk u arrit të provohet papërshtatshmëria për vijimin e ushtrimit të detyrës dhe, për rrjedhojë, çmon se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

Trupi gjykues, lidhur me vlerësimin profesional, gjatë analizës së mangësive profesionale të konstatuara për moskryerje të hetimeve të plota, mosadministrimin e procedimeve penale, mosrealizimin e procedimeve penale në mënyrë efektive dhe për të garantuar të drejtat dhe liritë e shtetasve, për sa kohë që jo në pak çështje të adresuara nga një numër i lartë i denoncuesve, u konkludua se vendimmarrjet e subjektit të rivlerësimit ishin prishur nga organet e gjyqësorit, madje edhe në mënyrë të përsëritur, i vlerëson ato si veprime dhe mosveprime të kryera, jo për shkak të paaftësisë profesionale të subjektit, por që dëshmojnë për sjellje të tij në mospërmbushje të detyrës në pozicionin e prokurorit, duke cënuar në këtë mënyrë besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, referuar pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

KONKLuzioni Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, rekomandimet e relatorit të çështjes, pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, mori në shqyrtim pretendimet e parashtruara dhe provat e paraqitura prej tij, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe bindjen e brendshme, mbështetur në pikën 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, arrin në përfundim se subjekti i rivlerësimit, nuk ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas gurmës “a”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, si dhe ka cënuar besimin e publikut sipas pikës 5, të nenit 61 të po këtij ligji.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të gurmës “c”, të pikës 1, të nenit 58, dhe pikave 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Ndini Tavani, me funksion prokuror pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë në datën 11.10.2019.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Alma Faskaj (Vokopola)
Kryesuese

Roland Ilia
Anëtar/ Kundër

Brunilda Bekteshi
Relatore

Sekretare gjyqësore
Denisa Kosta

MENDIM PAKICE

Unë, Roland Ilia, anëtar i trupit gjykues për subjektin e rivlerësimit, z. Ndini Tavani, kam votuar kundër arsytimit të shumicës, i cili ka vendosur të shkarkojë nga detyra subjektin e rivlerësimit me funksion prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Vota kundër qëndrimit të shumicës është e lidhur me disa arsye të cilat argumentojnë të kundërtën e përfundimit të konkluzioneve të arritura nga shumica në kriterin e pasurisë dhe në vlerësimin profesional.

1. Në lidhje me pasurinë apartament banimi, ndodhur në Rr. “****”, p. “****”, kati i II, ap. ***, Q., pranë restorant Fresku, sipas kontratës së premtim-shitje nr. ***, datë 4.12.2015, në vlerën 4 500 000 lekë, paguar deri ditën e paraqitjes së deklaratës, shuma prej 3 000 000 lekë, deklaruar me burim krijimi, nga pagat e deklaruesit dhe të bashkëshortes, si dhe të ardhurat nga avokatia para fillimit të detyrës si prokuror. Diferenca e shumës prej 1 500 000 lekësh do të paguhet ditën e nënshkrimit të kontratës përfundimtare të shitjes, sipas parashikimit në kontratë. Paguar vlera: 3 000 000 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

Subjekti lidhur me një ndër burimet e kësaj pasurie, *të ardhurat nga avokatia para fillimit të detyrës*, ka deklaruar në deklaratën para fillimit nga detyra për vitin 2006, gjendje *cash* në shumën 2 500 000 lekë me burim krijimi *të ardhura nga avokatia për vitin 2003 -2004*.

Gjatë hetimit Komisioni ka konstatuar se të ardhurat e përfituara nga ushtrimi i këtij profesioni pas përmbushjes së detyrimeve tatimore sipas legjislacionit në fuqi kanë qenë në shumën 1 534 000 lekë dhe për pasojë nuk provohej me dokumentacion justifikues shuma 2 500 000 lekë.

Nisur nga ky konstatim edhe analiza financiare ka rezultuar në balancë negative për vitin 2016 dhe për pasojë ka rezultuar se subjekti ka qenë në pamundësi financiare për të paguar këstin e dytë të kësaj pasurie në vitin 2016, blerjen e automjetit (cituar si pasuria 2 në deklaratën “Vetting” dhe në rezultatet e hetimit administrativ), dhe po ashtu edhe për të kryer shpenzimet e tjera.

Pas kalimit të barrës së provës subjekti në prapësimet e tij ka saktësuar se për deklarimin e shumës 2 500 000 lekë ka pasur në vëmendje të gjitha të ardhurat e realizuara dhe të akumuluar, duke filluar nga momenti i parë që ka punuar dhe është paguar dhe deri në ditën e deklarimit, viti 2006.

Subjekti ka deklaruar se kjo shumë përbëhej nga të ardhurat e realizuara si asistent avokat, avokat (ku përfshihej edhe shuma si avokat kryesisht) dhe nga Shkolla e Magjistraturës në vitet 2002 – 2006.

Subjekti, për të provuar me dokumentacion të ardhurat si asistent avokat ka depozituar: vendime gjyqësore ku rezulton si përfaqësues ligjor; vërtetimin, datë 3.2.2019, të Dhomës Kombëtare të Avokatisë Tiranë, për të vërtetuar faktin se subjekti ka qenë asistent avokat pranë avokatit Sh. S., për vitin 2002; vërtetimin, datë 21.2.2019, të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Berat, sipas të cilit avokati Sh.S. ka paguar detyrimet për vitin 2002 në organet tatimore; si dhe deklaratën noteriale nr. ***, datë 14.4.2019, të shtetasit Sh. S., avokat i Dhomës së Avokatisë Berat ku ka kryer punën si asistent avokat dhe ka qëndruar përgjatë gjithë periudhës në ambientet e zyrës së avokatisë (2002 – 2004), pa paguar asnjë detyrim qiraje apo detyrime të tjera.

Nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën lidhur me mosmarrjen në konsideratë të të ardhurave të pretenduara nga ushtrimi i profesionit të asistent avokatit, për sa kohë që subjekti ka depozituar dokumentacioni i cili provon faktin që ai e ka ushtruar këtë pozicion dhe për pasojë ka krijuar edhe të ardhura nga ushtrimi i tij.

Në këtë drejtim, çmoj se provat e depozituara nga subjekti, si vendimet gjyqësore ku ai pasqyrohet në pozicionin e përfaqësuesit të palës ndërgjyqëse, apo edhe dokumentet e tjera janë indicie për të provuar krijimin e të ardhurave. Vlerësoj se marrëdhënia midis avokatit dhe asistent avokatit përveçse krijohet si kusht për t'i dhënë mundësinë këtij të fundit të aplikojë dhe të ushtrojë më tej pozicionin e avokatit, në bazë është edhe një marrëdhënie punësimi që pasohet me të drejta dhe detyrime mes palëve.

Nga ana tjetër, në arsyetimin tim mbaj në konsideratë faktin se të ardhurat janë siguruar përpara se subjekti i rivlerësimit të niste ushtrimin e funksionit të prokurorit, se subjekti i rivlerësimit ka saktësuar në deklaratën “Vetting” të ardhurat e përfituara nga avokacia, se deklarimi i gjendjes *cash* është bërë në deklaratën e plotësuar për herë të parë dhe me shumë mundësi subjekti mund të ketë hasur vështirësi në plotësimin e saktë të saj.

Në të tilla kushte, në vlerësimin tim të ardhurat e pretenduara nga subjekti duhet të përlllogaritshin si shpenzime jetese në favor të subjektit të rivlerësimit dhe për pasojë rillogaritja e tyre në analizën financiare do të çonte subjektin në balancë pozitive, duke u provuar krijimi dhe burimi i ligjshëm i gjendjes *cash* deklaruar në vitin 2006.

Provueshmëria e burimit të ligjshëm të shumës 2 500 000 lekë ndikon, gjithashtu, edhe në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit për vitin 2016, e cila ka rezultuar në balancë negative në vitin 2016, në shumën 673 390 lekë. Kjo shumë është deklaruar nga subjekti se është përdorur për të paguar këstet e pasurisë apartament i përshkruar si pasuria nr. 1, si dhe për të blerë automjetin e përshkruar si pasuria nr. 2, tip “Citroen C5”, sipas kontratës nr. ***, datë 18.10.2016, në vlerën 900 000 lekë.

2. Lidhur me pasurinë automjet tip “Mercedes-Benz”, prodhim i vitit 2000, blerë në vitin 2009, me targa ***, në vlerën 7 000 euro, me burim krijimi; të ardhurat nga paga e subjektit dhe e bashkëshortes, shitur sipas kontratës nr. ***, datë 18.10.2016, në shumën 100 000 lekë, për të cilën subjekti i rivlerësimit nga përlllogaritjet financiare të vitit të blerjes së kësaj pasurie ka rezultuar në balancë negative në shumën 611 044 lekë, nuk merr peshën e duhur në vlerësimin tërësor.

3. Në lidhje me blerjen e pasurisë nr. 7, me përshkrim **automjet tip “Mercedes-Benz”**, prodhim i vitit 2000, blerë në vitin 2009, me targa ***, në vlerën 7 000 euro, me burim krijimi, të ardhurat nga paga e subjektit dhe e bashkëshortes, për të cilën ka rezultuar se subjekti nuk kishte pasur mundësi financiare në shumën 611 044 lekë për blerjen e saj, si dhe të përballonte shpenzimet e tjera familjare, pas dërgimit të prapësimeve nga subjekti nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën.

Më konkretisht, fakti se krijimi i depozitës në shumën 5 200 euro, si dhe burimi i krijimit të saj është deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2009, më krijon bindjen për origjinën dhe ekzistencën e kësaj depozite, çka provon edhe pretendimin e subjektit se depozita në shumën prej 5 200 euro është krijuar në janar të vitit 2009, me të ardhurat e kursyera gjatë vitit 2008. Këtë rezultat e mbështes edhe nisur nga periudha e kushtëzuar e fillim vitit, kur subjekti kurrsesi nuk mund të krijonte një depozitë të tillë.

Në këto kushte ndaj qëndrim ndryshe me shumicën dhe vlerësoj se në përlllogaritjet financiare të vitit 2009 kjo depozitë duhet zbritur si zë ndryshimi (shtesa) i likuiditeteve dhe për pasojë analiza financiare e vitit 2009 do të ndryshonte. Pas rillogaritjeve balanca negative do të rezultonte në një vlerë të papërfillshme, konkretisht 106 556 lekë, vlerë e cila nuk përbën shkak për t'i dhënë çmuarje tërësisë së rivlerësimit të subjektit për kriterin e pasurisë.

4. Gjithashtu, nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën në lidhje me çështjen e trajtuar në pikën nr. 9 të vendimit.

Në lidhje me çështjen e trajtuar në pikën 9 që i përket apartamentit me sip. 65 m², ndodhur në Rr. “***”, të deklaruar nga subjekti në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës, në vlerën 35 000 euro në pjesë takuese 1/3, Komisioni, në rezultatet e hetimit administrativ kishte konstatuar se dukej se subjekti nuk kishte pasur mundësi të paguante shumën 2 190 516 lekë, për 1/3 pjesë takuese për këtë pasuri dhe të përballonte shpenzimet e tjera familjare, si edhe duke përlllogaritur 1/3 pjesë takuese të kësteve të paguara për këtë pasuri, subjekti rezultonte në pamundësi financiare në shumën 2 038 248 lekë; se dukej se subjekti kishte kryer deklaram pasaktë, pasi nuk e kishte deklaruar në deklaratën “Vetting”, kontributin e tij në pjesën takuese sipas deklaramit për vitin 2006; se dukej se subjekti kishte kryer deklaram të pasaktë në lidhje me vlerën e kontratës së këtij apartamenti, pasi në deklaratën para fillimit të detyrës e kishte deklaruar 35 000 euro, ndërkohë nga kontrata rezulton se vlera e apartamentit është në shumën 32 600 euro.

Subjekti në prapësimet e tij ka sqaruar se raporti prind-fëmijë e lejon të ketë në mes një kontribut sado minimal të jetë. Subjekti nuk ka cituar një vlerë të shpenzuar për blerjen e kësaj pasurie. Megjithë prapësimet e subjektit shumica ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të paplotë në koherencë me faktet e konstatuara, mbi marrëdhënien e tij në raport me këtë pasuri, si dhe me kontributin e dhënë për të, duke mosprovuar vërtetësinë e deklarameve të tij për masën e kontributit, për të ribërë analizën e mëtejshme financiare.

Nuk vlerësoj se vetëm fakti i deklaramit të pjesës takuese në deklaratën para fillimit të detyrës lë të nënkuptohet se edhe vlera e shpenzuar për blerjen e saj është në të njëjtin raport, 1/3 dhe aq më pak deklarami i vetëm i pjesës takuese, të detyrojë subjektin të pranojë një shumë të caktuar e cila domosdoshmërisht më pas kërkon provueshmërinë e burimit të ligjshëm të saj.

Çmoj se shpjegimet e subjektit janë bindëse, për sa kohë nuk provohet e kundërta me dokumentacion ligjor. Në prapësime subjekti është shprehur se nuk ka kontribuar në këtë pasuri dhe për pasojë për sa kohë kjo pasuri nuk ka qenë dhe as është e tija, nuk ka pasur detyrimin të deklarojë në vijim deri në deklaratën “Vetting”.

Gjithashtu, çmoj se subjekti ka qenë shterues në provueshmërinë e faktit se nuk ka kontribuar në këtë pasuri në vlerë monetare, për sa kohë ai nuk është pjesë e bashkëpronësisë së kësaj pasurie në kontratën e porosisë, si akti i vetëm i administruar nga Komisioni deri aktualisht, për sa kohë ai vetë ka deklaruar në prapësime se *nuk kam asnjë të drejtë ligjore mbi këtë pasuri, nuk gëzoj asnjë të drejtë reale dhe rrjedhimisht nuk kam asnjë pretendim mbi këtë pasuri. Apartamenti me kontratë porosie është lidhur nga nëna ime dhe sot gëzohet qetësisht, bashkarish, nga të dy prindërit e mi.*

Në këto kushte, nuk vlerësoj se konkluzioni i shumicës në këtë rast merr vlerë provuese në tërësinë e rivlerësimit të subjektit për të vendosur shkarkimin e tij nga detyra.

5. Nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën në lidhje me pikën nr. 10 të vendimit, për sa i përket konstatimeve për personat e tjerë të lidhur, L. T. dhe Ll. T.(prindërit e subjektit), mbi derdhjet e shumave dhe rritjen e tyre në mënyrë të ndjeshme nga viti 2008 deri në vitin 2016.

Çmoj se, për sa kohë nuk u provua kontributi në vlerë monetare i 1/3 pjesë takuese të deklaruar nga subjekti në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2006 në blerjen e pasurisë së prindërve të tij, prindërit e subjektit janë të përbashkët tërësisht nga trajtimi i tyre si persona të lidhur, ku sipas nenit 3, pika 14, të ligjit 84/2016: *“Persona të tjerë të lidhur janë personat fizike ose juridike, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin ose komisionerin publik që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi”*, dhe për pasojë transaksionet bankare të kryera prej tyre nuk gjejnë vend në hetimin e burimit të ligjshëm të krijimit. Subjekti në prapësimet e tij ka depozituar dokumentacion për të provuar se prindërit e tij kanë qenë të punësuar, se babai i tij ka ushtruar një biznes privat prej vitit 1993 – 2016, për të provuar në këtë mënyrë se prindërit e subjektit kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për të provuar burimin e ligjshëm të transaksioneve bankare. Pra, pavarësisht vlerësimit tim se prindërit e subjektit nuk konsiderohen persona të lidhur, gjithsesi subjekti ka vërtetuar me dokumentacion ligjor të ardhurat e përfituara prej punësimeve të tyre, të cilat provojnë jo vetëm mundësinë e blerjes së pasurive të tyre por edhe mundësinë e transaksioneve bankare. Në këto kushte çmoj se konkluzioni i shumicës, se shpjegimet e subjektit mbetën në nivel deklarativ dhe nuk duken bindëse në kuptim të pikës 1, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, në vlerësimin tim nuk qëndron dhe për pasojë nuk merr vlerë provuese në vendimin për shkarkimin e tij nga detyra.

6. Në lidhje me rivlerësimin profesional, për subjektin e rivlerësimit, mbaj në konsideratë konstatimet e raportit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë që në tërësi nuk kanë konstatuar problematika lidhur me aftësitë profesionale dhe angazhimin personal, etikën, si dhe integritetin në ushtrim të detyrës, mbaj në konsideratë eksperiencën e gjatë të subjektit të rivlerësimit, çështjet me natyrë sensitive të cilat u bënë prezent gjatë hetimit administrativ nga denoncimi i shtetasit F. D. dhe që nga hetimi i tyre nuk rezultuan problematika.

- Për çështjet konkrete dhe konkluzionet e arritura nga shumica, nuk ndaj të njëjtin qëndrim lidhur me konkluzionin e arritur nga trajtimi i dosjes nr. 2 që i përket procedimit penal nr. *** (për shtetasin I. K.), si një ndër pesë dosjet e shortuara, për faktin se ndaj vendimit të pushimit të çështjes nuk rezultoi të ishte ushtruar ankimi.

- Gjithashtu, nuk ndaj të njëjtin qëndrim me arsyetimin e bërë për denoncimet e shtetasve A.S., A. R., E. S., V. Ç. dhe I. S., pasi në raport me numrin e lartë (31) të denoncimeve të depozituara, por edhe për nga rëndësia, shkeljet e konstatuara, të cilat kryesisht pasqyrohen të natyrës procedurale, nuk mund të ndikojnë në vendimmarrjen e shkarkimit të subjektit nga detyra. Në këtë konstatim kam parasysh edhe ushtrimin e ankimit nga subjekti i rivlerësimit në të gjithë rastet e prishjes së vendimeve të tij të pushimit dhe kthimit të akteve për hetime të mëtejshme.

- Në vlerësimin tim, lidhur me konstatimet e Komisionit mbi denoncimet e paraqitura, vlerësoj edhe faktin e bërë prezent nga subjekti në prapësimet e tij se pothuajse në të gjithë rastet çështjet vijojnë të jenë në fazën e hetimeve paraprake, pas kthimit nga Gjykata e Apelit Tirane, apo në shqyrtim e sipër nga organi i gjyqësorit dhe për pasojë, bazuar në nenin E të Kushtetutës nuk do të ishte me vend të kisha një ndarje drastike e cila ndikon në shkarkimin e subjektit nga detyra. Në këto kushte nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën, pasi çështjet nuk rezultojnë të përfunduara nga organet ligjzbatuese.

- Edhe për sa i përket arsyetimit të shumicës lidhur me çështjen e bërë publike nga emisioni investigativ “Stop” dhënë në televizionin “Klan”, por edhe nga denoncuesi F. D., që i përkiste shtetasit F. Ç., për të cilën subjekti i rivlerësimit është shprehur me vendimin datë 13.6.2017, për “Pushimin e procedimit penal nr. *** i vitit 2017”, ndaj të njëjtin qëndrim sikurse jam shprehur në dosjen nr. ***më sipër, se, për sa kohë vendimmarrja e subjektit nuk është cenuar, pra, nuk ka sjellë pasoja, shkeljet e konstatuara nuk përbëjnë fakte dhe rrethana për të ndikuar në shkarkimin e subjektit nga detyra.

- Ndërsa, ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën e trupit gjykues në shqyrtimin, arsyetimin dhe konkluzionin e arritur në dosjen nr. 3 (një prej pesë dosjeve të shortuara, e vënë në lëvizje nga kallëzuesi, K.L.), që i përket procedimit penal nr. ***të vitit 2014, për të cilën ka rezultuar se subjekti ka marrë vendimin për pushimin e procedimit penal në datën 11.9.2014. Për këtë çështje, çmoj transferimin pranë organit kompetent, për inspektim të shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore sipas pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

➤ Në lidhje me vendimmarrjen e shumicës së trupit gjykues, duke marrë në konsideratë edhe arsyetimin dhe konkluzionet e mia në lidhje me kriterin e pasurisë dhe me vlerësimin profesional, jap votën time kundër, duke votuar për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Ndini Tavani, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në bazë të të pikës 1, të germës “a”, të nenit 58 ,të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

ANËTAR/KUNDËR

Roland Ilia